

## PËRMBAJTJA



4 Fjalimi i presidentit Barack Obama



10 Intervistë me Fadil Malokun



16 Duhani vret



18 A jemi të aftë të organizojmë...



39 Kosova rrezikon t'i humbë...

Lajme .....	2
<b>Demir Reshiti:</b> Udhë e Madhe e Kombit.....	3-4
Fjalimi i presidentit amerikan Barack Obama në Kajro të Egjiptit.....	4-9
Intervistë me prof. dr. Fadil Malokun .....	10-12
<b>Sead Ukani:</b> Investimet e huaja – nevojë imediate..	13
<b>Avni Avdiu:</b> Maqedoninë e zuri haku im .....	14-15
<b>Mevludë Zejnullahu:</b> Duhani vret .....	15-16
<b>Florije Ademi:</b> Fillon nisma "Mitrovicasit për Mitrovicën" .....	16-17
<b>Sabri Halili:</b> A jemi të aftë të organizojmë dhe menaxhojmë zgjedhjet?.....	18-19
<b>Demir Reshiti:</b> Reflektime ndërkombëtare për Kosovën .....	20-21
<b>Muhamed J. Kajolli:</b> Çlirimi Egjiptit dhe vrasja e Omerit r.a.....	22-24
<b>Agim Fazliu:</b> Zëri fëmijëror i vargjeve të Kur'anit..	24
<b>Fatos Shala:</b> Dhuna në shkollë po merr përmasa shqetësuese.....	25
<b>Ajni Sinani:</b> Ahmed Davutogllu – ideolog i politikës së jashtme turke.....	26-27
<b>Ekrem Avdullahu:</b> Servilët dhe servilizmi .....	28
<b>Osman D. Gashi:</b> Kush po diskriminohet në Kosovë?..	29
<b>Arbër Ahmeti:</b> Mic Sokoli – shëmbëlltyrë e luftës për liri .....	30-31
<b>Flamur Maloku:</b> Teksti i vajit.....	32
<b>Esat Vatovci:</b> Lajme nga kultura.....	33
<b>Jeton Isufi:</b> Promovime librash.....	33
<b>Fitim Veliu:</b> Panairi, sfida dhe suksesi .....	34
<b>Arben Atashi:</b> Profesori në hije i gjeneratës së dytë të gazetarisë .....	35-36
Poezi .....	36
<b>Artan N. Bejta:</b> Migrena.....	37-38
<b>M. Zejnullahu:</b> Trimi i sukseseve dhe shpresave të mëdha.....	38
<b>Alban Bilalli:</b> Kosova rrezikon t'i humbë kualifikimet për Euro 2012 .....	39
Fjalëkryqi .....	40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,  
KULTURË, ARSIM, ETIKË  
Viti IV / Nr. 31-32  
19 qershor - 19 gusht 2009  
Botues  
Zëri Ynë  
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Redjtor  
**Muhamed Jusufi - KAJOLLI**  
kajolli5@hotmail.com  
Redaktor përgjegjës  
**Demir RESHITI**  
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës  
**Flamur MALOKU**  
flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika  
**Osman D. GASHI**  
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore  
**Mimoza SINANI**

e-mail:  
revistapaqja@gmail.com  
revistapaqja@hotmail.com  
http://www.zeri-yne.org

Adresa:  
**Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,**  
**përballë teatrit Dodona,**  
**Prishtinë, Kosovë**

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

## Prishtinë

4 qershor 2009

**Sami Kurteshi ombudspersoni i ri i Kosovës**

Sami Kurteshi është ombudspersoni i ri i Kosovës. Ai ka marrë 65 vota nga deputetet e Kuvendit, katër më shumë sa që i nevojitej për t'u kurorëzuar në këtë post. Kurteshi ka mposhtur dy kundërkandidatët e tij, Besnik Osmanin dhe Veton Vulen.

Menjëherë pas betimit, Kurteshi ka deklaruar për media se do të jetë i përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetareve të vendit.

Zgjedhja e avokatit të popullit, i ka dhënë fund një procesi të filluar para tre vjetësh, dhe është arritur pas 4 dështimeve të mëhershme të Kuvendit që të arrijë këtë gjë.

## Nju Jork

11 qershor 2009

**OBSH shpall pandeminë e gripit të derrave**

Organizata Botërore e Shëndetësisë, pas një takimi urgjent, ka shpallur pandeminë e gripit të derrave, duke e rritur alarmin në nivelin e gjashtë. Kjo do të thotë se virusi i gripit po përhapet në të paktën dy rajone të botës.

Veprimi u bë për shkak të përhapjes në rritje të gripit të derrave, i cili u zbulua në Meksikë dy muaj më parë dhe është përhapur në 74 vende, në Azi, Evropë si dhe në Amerikë. Sipas të dhënave zyrtare në botë ka pasur 30 mijë raste dhe 141 vetë kanë vdekur. Këto shifra po rriten.

Shpallja e pandemisë së gripit të derrave nga komiteti i ekspertëve për emergjencë në OBSH është e para e këtij lloji në 40 vitet e kaluara. E fundit në vitin 1968 shkaktoi vdekjen e rreth 1 milion personave.



## Bruksel

11 qershor 2009

**Reduktohet numri i trupave të NATO-s në Kosovë**

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s kanë vendosur të reduktojnë numrin e trupave ushtarake nga 14 mijë sa ka tash në 10 mijë. Lajmin e ka bërë të ditur sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jap De Hop Schefer, në një konferencë për gazetarë pas mbledhjes së ministrave të mbrojtjes.

“Data nuk është vendosur ende. Do të mbesin rreth 10 mijë trupa në Kosovë, nga 14 mijë sa janë gjithsejtë. Data mund të jetë 1 janari, por dua të theksoj se nuk ka ndonjë vendim zyrtar ende. Por ky vendim është arritur në parim” – ka sqaruar Schefer.

# Udha e Madhe e Kombit

**Demir RESHITI**

**P**asi arrita të hyj njëherë në këtë tunel, edhe në vdeksha nuk më ngelet merak se po mbetet pa u bërë rruga e ëndrrave të mia” - thoshte haxhi Nuhë Hajrullahu nga Prishtina, i entuziazmuar nga puna që po bëhej në hapjen e tunelit më të gjatë në Ballkan...

-Haxhi babë, me kësmet, sot një vit, nëpër këtë tunel do vemi bashkë në Durrës – ia ktheu me një qëndrim shumë bindës Furkani, kryeinxhinier i kompanisë turke “Enka”, i cili të premten e fundit të qershorit të vitit 2008, po na shoqëronte mua, botuesin e revistës “Paqja” z. Muhamed Kajolli dhe vjehrrin e këtij të fundit Nuhë Hajrullahun drejt thellësive të nëntokës, ku po hapej tuneli i ëndrrave shqiptare...

Puna e madhe që po bëhej aty dhe vetëbesimi i kryeinxhinierit Furkan sikur na e thyen pak atë ndjenjën e pesimizmit që po na përcillte gjatë gjithë rrugës nga Prishtina për në Kukës ku temë e pashmangshme bisede ishte rruga Durrës-Kukës-Morinë...

Dhe, një vit prapa, derisa po e përcillja në transmetim të drejtpërdrejtë nëpërmjet televizionit ceremoninë e shembjes simbolike të centimetra të fundit të shkëmbit në tunel, më shfaqej përpara fytyra e qeshur e Furkanit dhe më rikujtoheshin fjalët e tij drejtuar haxhi Nuhës se nëpërmjet këtij tuneli një vit më pas do të shkonim për në Durrës.

\*\*\*

Ditën e fundit të muajit maj, pas shpimit të centimetra të fundit të tunelit të Kalimashit, është hapur zyrtarisht njëri krah i autostradës Durrës-Kukës-Morinë.

Në ceremoninë festive të inaugurimit të hapjes së njëres pjesë të autostradës Durrës-

Morinë, në tunelin e Kalimashit, i gjatë 5.6 kilometra, kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë të të dyja vendeve.

Për ta përcjellë nga afër këtë ngjarje të madhe historike, atë ditë në Kalimash kishin ardhur edhe shumë qytetarë nga Kosova dhe Shqipëria duke krijuar një atmosferë vërtetë festive. Ndër mysafirët e ftuar në këtë ceremoni ishin edhe ish-shefi i misionit verifikues të OSBE-së në Kosovë gjatë vitit 1998-99, ambasadori William Walker, gruaja e ish-Presidentit Amerikan Heizenhouer, ambasadori i SHBA-së në Tiranë etj.

Një pllakat i madh, me mbishkrimin “Përgjithmonë”, ishte vënë mbi tunel.

Kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha e ka quajtur ‘tuneli i bashkimit të kombit’. Homologu i tij nga Kosova, Hashim Thaçi, ka thënë se Prishtina dhe Tirana, si kurrë më parë, janë më afër njëra-tjetres. Fjalë të mëdha u thanë në Kalimash. E vërteta është se shqiptarët po afrohen më shumë.

Në fjalimin e tij të mbushur me emocione, kryeministri Berisha, hapjen e tunelit në Kalimash dhe rrugën në tërësi, e ka quajtur realizim të njëres prej ëndrrave më të bukura.

“Përjetuam shembjen jo të një muri, por të një mali. Përjetuam shembjen jo të një muri, por të pamundësisë. Sot, bashkë me kryeministrin e Kosovës, inauguruam tunelin e Kalimashit, një nga kryeveprat në fushën e ndërtimit në Evropë dhe më gjerë” - ka theksuar Berisha, duke shtuar se ky tunel bashkon edhe të gjitha kombet e rajonit, maqedonas, serb apo bullgar.

“Sot, Tirana dhe Prishtina janë si kurrë ndonjëherë më parë pranë njëra-tjetres dhe do të afroheni edhe më tej. Tirana dhe Prishtina janë si kurrë ndonjëherë pranë njëra-tjetres dhe kështu do të jemi përgjithmonë. Kemi qenë të ndarë me shekuj, por kurrë nuk kemi qenë larg njëri-tjetrit... Na ka ndarë historia, padrejtësia, na ndanin bjeshkët dhe malet. Sot, të gjitha këto pengesa janë zëvendësuar me punë, vullnet, ideal, vizion. Kjo është rruga e bashkimit” - ka thënë kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi.

\*\*\*

Ajo që nisi si një ide në vitin 1996 tashmë është bërë konkrete. Një tjetër ëndërr e shqiptarëve po realizohet! Kosova dhe Shqipëria, janë më pranë në sajë të këtij korridorit që nis në portin e Durrësit e që do të përfundojë në Prishtinë. Rruga do të lidhë më lehtë Shqipërinë me rajonin dhe do t'i japë më shumë rëndësi strategjike kombit shqiptar në Ballkan.

Është ndërtuar në një trajektore krejtësisht të re, pas rreth 28 muajsh që nga nisja e punimeve. Përfundimi i saj po pritët me ankth, nga kompanitë ndërtuese, por edhe nga porositësit e saj, qeveria shqiptare.

Më 27 qershor do të jetë



i gatshëm për qarkullim njëri krah i tunelit 5,5 kilometra i gjatë, sikurse edhe autostrada Fushë-Dukagjin-Rrëshen. Puna më e rëndë ka mbetur të bëhet në segmentin Kukës-Kolsh, pesë kilometra të së cilës kryesisht do të kalojnë mbi shtylla. Pjesa tjetër, Kukës – Morinë do të jetë gati, pos dy-tri urave që mund të vonohen.

\*\*\*

Rruga është një aortë jetike për të lidhur dy pjesë të kombit Shqipërinë dhe Kosovën dhe për të shumëfishuar shkëmbimet njerëzore dhe tregtare mes dy vendeve. Vlerat e jashtëzakonshme që merr kjo rrugë jo vetëm ekonomike, por edhe kulturore janë të mëdha. Autostrada Durrës-Kukës-Morinë do të bashkojë jo vetëm territoret shqiptare por do të jetë një dalje e rajonit të Ballkanit në Detin Adriatik dhe më tutje në Evropë. Kështu me një rëndësi të veçantë cilësohet kryesisht për hapjen dhe rritjen e komunikimit me rajonin dhe me fqinjët.

Nëpërmjet kësaj rruge, po vihet në vend historia e një kombi të ndarë padrejtësisht. Kurrë në historinë e kombit tonë, nuk ka pasur një lidhje kaq vitale e të denjë sa ajo që do të ngjashë përmes saj.

Mbi të gjitha është Udhë e Madhe e Kombit që do të bashkojë realisht zemrat dhe ëndrrat shekullore të gjeneratave shqiptare!

#### Pasaporta e rrugës:

Gjatësia e autostradës Durrës - Prishtinë, 170 km.

Lidh portin e Durrësit me Morinë, në kufi me Kosovën.

Kompania Bechtel & Enka JV është ndërtuesja e segmentit rrugor prej 60.85 km, përfshirë dhe një tunel prej 5.5 km, sipas kontratës së nënshkruar në shtator 2006 me Qeverinë Shqiptare.

Tipi i rrugës është me 4 korsi autostrade, 2 korsi në çdo drejtim.

Shpejtësia e planifikuar: 80 - 100 km në orë.

Ura të këtij segmenti gjithsej 29 copë. Më e gjata është ura e Bisakut 360 m, kurse më e larta ura e Kalimashit mbi 80 m.

Afro 4.5 km rrugë do të jetë mbi ura dhe struktura tejet artistike.

## Obama i zgjat dorën e bashkëpunimit vendeve myslimane në Kajro "Kemi fuqinë të bë"

*"E shkuara duhet hedhur pas për të fituar të ardhmen që duam" - ka theksuar presidenti i SHBA-së Barack Obama, gjatë një fjalimi historik në kryeqytetin egjiptian Kajro. Duke qenë se ky fjalim është në të njëjtën vijë me misionin dhe emrin që mban revista e jonë, po e botojmë në tërësi me shpresën se është me interes për lexuesin e respektuar.*

### Përhëndetja me assalaamu alaykum

Jam i nderuar që ndodhem në qytetin e përjetshëm të Kajros, i ftuar nga dy institucione shumë të famshme. Për rreth 1000 vjet, Al-Azhar konsiderohet si një fanar i dijes islame dhe për rreth 100 vjet Universiteti i Kajros ka qenë burimi i përparimit të Egjiptit. Së bashku, ju përfaqësoni harmoninë mes traditës dhe progresit. Ju jam mirënjohës për mikpritjen e popullit egjiptian. Njëherazi jam krenar t'ju përcjell vullnetin e mirë të popullit amerikan dhe përhëndetjen e paqes nga komunitetet myslimane të vendit tim: assalaamu alaykum.

Po takohemi në një periudhë tensionesh mes Shteteve të Bashkuara dhe myslimanëve kudo në botë. Tension ky me rrënjët në forca historike, që shkojnë përtej çdo debati të politikës aktuale. Marrëdhënia mes Islamit dhe Perëndimit përfshin shekuj të tërë bashkëjetese dhe bashkëpunimi, por edhe konfliktesh dhe luftërash fetare. Së fundmi, tensioni është nxitur nga kolonializmi që u mohoi të drejtat dhe mundësitë shumë myslimanëve, dhe një luftë e ftohtë, në të cilën shumë vende me shumicë myslimane u trajtuan pa iu marrë parasysh aspiratat. Por, edhe ndryshimet rrënjësore që solli moderniteti dhe globalizmi bënë që myslimanët të vazhdonin ta shihnin dhe ta konsideronin Perëndimin si armiqësor ndaj traditave të islamit. Ekstremistët e dhunshëm i shfrytëzuan këto tensione në një komunitet të vogël, por të fuqishëm myslimanësh.

Sulmet e 11 shtatorit 2001 dhe përpjekjet e vazhdueshme të këtyre ekstremistëve për të shkaktuar dhunë kundër civilëve, kanë bërë që disa njerëz në vendin tim ta konsiderojnë Islamit pashmangshmërisht armiqësor e kjo jo vetëm ndaj Amerikës dhe vendeve perëndimore, por edhe ndaj të drejtave të njeriut. Kjo ka gjeneruar shumë frikë dhe mosbesim. Për sa kohë që marrëdhënia jonë do të vazh-

dojë të përcaktohet nga ndryshimet, ne do t'i fuqizojmë ata që në vend të paqes shohin urrejte dhe që promovojnë konfliktin në vend të bashkëpunimit për të ndihmuar njerëzit të arrijnë drejtësi e begati.

Ky cikël dyshimesh dhe mosmarrëveshesh duhet të marrë fund. Kam ardhur këtu në kërkim të një fillimi të ri mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe myslimanëve kudo në botë, një fillimi të bazuar në interesat e përbashkëta dhe respektin e ndërsjellët, një fillim të bazuar mbi të vërtetën që Amerika dhe Islami nuk janë ekskluzive dhe se nuk duhet të jenë në konkurrencë. Përkundrazi, ato ndajnë parime të përbashkëta për drejtësinë dhe progresin, tolerancën dhe dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore. Kësisoj, unë e kuptoj se ndryshimi nuk mund të ndodhë brenda një nate. Një fjalim i vetëm nuk mund të çrrënjosë vite mosbesimi dhe unë nuk mund t'u përgjigjem menjëherë të gjitha pyetjeve të ndërlikuara mbi shkaqet që na sollën në këtë situatë. Por jam i bindur që për të ecur përpara duhet t'i themi haptas gjërat që deri tani i kemi thënë pas dyerve të mbyllura. Duhet të përpiqemi ta dëgjojmë njëri-tjetrin, të mësojmë nga njëri-tjetri, të respektojmë njëri-tjetrin dhe të shohim gjërat e përbashkëta. Siç na mëson edhe Kurani i Shenjtë: "Ndërgjegjësohu për Zotin dhe thuaj gjithmonë të vërtetën". Këtë do të bëj edhe unë, do të përpiqem të them të vërtetën me sa mundem, kokulur para detyrave që kemi përpara dhe i bindur në besimin tim se interesat që ndajmë si qenie njerëzore, janë shumë më të fuqishme se forcat që duan të na ndajnë.



pro të Egjiptit

# "Ejmë botën që ëndërrojmë"


**Unë jam i krishterë, por im atë i përkiste një familjeje keniane që prej brezash të tërë ishte myslimane**

Një pjesë e bindjes sime i ka rrënjët në përvojën personale. Unë jam i krishterë, por im atë i përkiste një familjeje keniane që prej brezash të tërë ishte myslimane. Në fëmijëri kam kaluar disa vite në Indonezi dhe kam dëgjuar shumë shpesh thirrjen azgaan (thirrja myslimane për momentin e lutjes) në agim dhe në mbrëmje. Kur isha i ri, kam punuar në komunitetet e Çikagos, ku shumë njerëz gjenin në besimin e tyre mysliman dinjitetin dhe paqen.

Si student i historisë, e di fort mirë se sa në borxh i është civilizimi ynë Islamit. Ishte Islami në vende të tilla si Universiteti i Al-Azharit, që përcolli nga shekulli në shekull dritën e dijes, duke i hapur rrugën Rilindjes Evropiane dhe periudhës së dritës. Ishin shpikjet në komunitetet myslimane që zhvilluan algjebren, që sollën kompasin, apo na dhanë mjetet e lundrimit, mjeshtrinë e penës dhe shtypjes; të të kuptuarit për shpërndarjen e sëmundjeve dhe shërimin e tyre. Kultura islame na ka dhënë një poezi që i përket çdo kohe dhe muzikë të mrekullueshme, një kaligrafi elegante dhe vende magjepsëse. Përgjatë historisë, Islami ka treguar përmes punës dhe veprave mundësitë e tolerancës fetare dhe barazisë racore. Kjo, gjithashtu, se Islami ka qenë gjithmonë pjesë e historisë së Amerikës. Kombi i parë që njohu vendin tim ishte Maroku. Me nënshkrimin e Traktatit të Tripolit, të vitit 1796, Presidenti ynë i dytë, John Adams, shkroi: "Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë një karakter armiqësor ndaj ligjeve, feve apo qetësisë së myslimanëve". Që nga dita e themelimit të kombit tonë, myslimanët e Amerikës i kanë pasuruar Shtetet e Bashkuara. Ata kanë luftuar në luftërat tona, kanë shërbyer në qeveri, janë përpjekur për të drejtat e njeriut, kanë nisur biznese, kanë mësuar në universitetet tona, kanë shkëlqyer në arenën sportive, fituar çmime "Nobel", kanë ndërtuar ndërtesat më të larta dhe kanë ndriçuar pishtarin olimpik. Kur myslimani i parë u zgjodh së fundmi në Kongresin Amerikan, ai së pari u betua që të mbronte Kushtetutën mbi të njëjtin Kuran të Shenjtë që një nga etërit tanë themelues, Thomas Xhefersoni, mbante në bibliotekën e tij personale.

**Liria në Amerikë është e pandashme nga liria për të praktikuar fenë**

Unë e kam njohur Islamin në tri kontinente, para se të vija në rajonin ku ai lindi. Përvoja që kam, drejton bindjen time, që partneriteti mes Amerikës dhe Islamit duhet të bazohet në atë çka është Islami, jo në atë çka nuk është dhe nuk përfaqëson. Unë e konsideroj pjesë të përgjegjësisë sime si President i Shteteve të Bashkuara të Amerikës luftën kundër stereotipave negativë të Islamit, kudo ku ato shfaqen. Por i njëjti parim duhet të aplikohet edhe për sa i përket perceptimit që duhet të kenë myslimanët për Amerikën. Shtetet e Bashkuara kanë qenë



një nga burimet më të mëdha të progresit që ka njohur bota ndonjëherë. Ne lindëm nga revolucioni kundër një perandorie. Ne u themeluan si komb duke pasur në thelb idealin se të gjithë janë krijuar të barabartë dhe kemi derdhur gjak e luftuar për shekuj me radhë që t'u japim kuptim këtyre fjalëve brenda kufijve tanë dhe kudo në botë. Jemi formësuar nga kultura të ndryshme, nga çdo cep i botës. U fol shumë për faktin se një afriko-amerikan me emrin Barak Husein Obama mund të zgjidhej President i vendit, por historia ime personale nuk është unike. Ëndrra e mundësisë nuk është realizuar për të gjithë në Amerikë, por premtimi për të është një mundësi për këdo që vjen në brigjet tona, që përfshin edhe 7 milionë amerikanë të besimit mysliman në vendin tonë, të cilët kanë mundësi të edukohen dhe të kenë të ar-

dhura të një niveli mbi mesataren. Liria në Amerikë është e pandashme nga liria për të praktikuar fenë. Kjo është arsyeja që në çdo shtet ne kemi edhe xhami dhe numri i tyre brenda kufijve tanë i kalon të 1200-at. Për këtë qëllim, qeveria amerikane ka shkuar në gjykatë për të mbrojtur të drejtat e grave dhe vajzave që veshin hijab dhe dënon ata që e mohojnë një të drejtë të tillë. Për një gjë nuk duhet të ketë asnjë dyshim: Islami është pjesë e Amerikës dhe besoj se Amerika mban brenda vetes të vërtetën që, pavarësisht racës, fesë, apo vendit ku ndodhesh, të gjithë ne ndajmë të njëjtat aspirata: një jetë në paqe dhe siguri, arsimim dhe punë dinjitoze, dashuri për familjet, komunitetin, Zotin. Këto janë gjërat që ne ndajmë.

Kjo është shpresa për gjithë njerëzimin. Sigurisht, njohja e humanizmit që na bashkon është vetëm fillimi i detyrës sonë. Fjalët e pashoqëruara nga veprimet nuk arrijnë asnjë qëllim. Këto nevoja do të plotësohen vetëm nëse ne do të veprojmë me guxim në vitet e ardhshme dhe nëse do të kuptojmë se sfidat që kemi përpara janë sfida të përbashkëta dhe dështimi i kapërcimit të tyre do të na lëndonte të gjithëve. Kjo sepse kemi mësuar nga përvojat e mëparshme, se kur një sistem financiar dobësohet në një vend, begatia zbehet kudo. Kur një virus i ri infekton një qenie njerëzore, të gjithë jemi në rrezik. Kur një komb merrret me prodhimin e armëve bërthamore, rreziku i një sulmi bërthamor shtrihet te të gjitha kombet. Kur një ekstremist i dhunshëm vepron në një segment të caktuar të planetit, rrezikohen të gjithë të tjerët, kudo që ndodhen. Kur një i pafajshëm në Bosnjë apo Darfur vritet, e gjithë ndërgjegjja jonë kolektive lëndohet. Për këtë arsye, ne duhet ta ndajmë botën në këtë shekull dhe të kemi përgjegjësi për njëri-tjetrin si qenie njerëzore. Sigurisht, kjo është një përgjegjësi e madhe dhe e vështirë.

**Çfarëdo që të mendojmë për të shkuarën, nuk duhet të burgosemi tek ajo**

Historia njerëzore shpesh ka qenë historia e kombeve, apo vendeve në luftë me njëri-tjetrin për përmbushjen e interesave të ngushta personale. Në këtë epokë të re, sjellje të tilla janë vetëshkatërruese. Duke qenë se të gjithë ndërvaremi nga njëri-tjetri,

çdo rend botëror që ngre një komb apo grup njerëzish mbi një tjetër, do të dështojë pashmangshmërisht. Kështu që çfarëdo që të mendojmë për të shkuarën, nuk duhet të burgosemi tek ajo. Problemet tona duhet të zgjidhen përmes partneritetit dhe përparimi duhet të ndahet mes të gjithëve. Kjo nuk do të thotë që duhet të injorohet burimet e tensioneve. Përkundrazi, duhet bërë e kundërta: ne duhet t'i përballojmë tensionet të bashkuar. Në këtë frymë, më lejoni të flas sa më pastër dhe qartë në lidhje me disa çështje specifike që mendoj se ka ardhur koha t'i përballojmë së bashku. E para syresh është përballja me ekstremizmin e dhunshëm në të gjitha format e tij. Në Ankara e bëra të qartë që Amerika nuk ka qenë dhe nuk do të jetë në luftë me Islamin. Kjo nuk do të thotë se nuk do t'i kundërvihemi ekstremizmit të dhunshëm që paraqet një kërcënim të madh ndaj sigurisë sonë. Kjo, sepse ne jemi kundër asaj çka janë të gjithë njerëzit: vrasjes së burrave, grave, fëmijëve të pafajshëm. Edhe detyra ime si President është mbrojtja e amerikanëve.

Situata në Afganistan tregon qëllimet e Amerikës dhe nevojën për të punuar së bashku. Rreth 7 vjet më parë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dolën kundër Al-Kaedës dhe talebanëve dhe u mbështetën shumë edhe nga komuniteti ndërkombëtar. Kjo nuk ishte rastësi, por nevojë. Jam i ndërgjegjshëm që ka nga ata që dyshojnë apo justifikojnë ngjarjet e 11 shtatorit, por le të jemi të qartë për diçka: Al-Kaeda vrau atë ditë 3000 vetë. Viktimat ishin gra, burra, fëmijë të pafajshëm nga Amerika dhe vende të ndryshme të botës që nuk kishin dëmtuar askënd. Megjithatë, Al-Kaeda zgjodhi t'i vrasë këta njerëz në mënyrë të pamëshirshme, mori përsipër sulmin e madje edhe tani thekson se është e vendosur që të kryejë vrasje masive. Ata kanë bashkëpunuar në shumë vende dhe po përpiqen që të zgjerohen. Kjo nuk është një çështje e debatueshme, por fakt me të cilin duhet të përballesh. Le të mos gabojmë: ne nuk duam që të mbajmë trupat tona në Afganistan. Ne nuk po kërkojmë baza ushtarake aty. Humbja e grave dhe burrave në luftë është shumë e rëndë për Amerikën. Kjo ka kosto të madhe politike dhe materiale. Do të ishim shumë të lumtur që të kthenim në shtëpi të gjithë trupat tona, nëse do të kishim besim se në Afganistan dhe Pakistan nuk do të kishte ekstremistë të dhunshëm, të vendosur që të vrasin sa më shumë njerëz. Por e vërteta nuk është kështu.

Nuk bëhet fjalë në këtë rast. Për këtë arsye kemi partneritet me 46 vende të ndryshme dhe pavarësisht koston, zotimi i Amerikës nuk do të zbehet për asnjë çast. Në fakt, askush nuk duhet t'i tolerojë këta ekstremistë. Ata kanë marrë jetën e shumë njerëzve në shumë vende të ndryshme të botës. Kanë marrë jetën e njerëzve nga besime të ndryshme fetare dhe mbi të gjitha kanë marrë jetën e myslimanëve. Veprimet e tyre bien në kundërshtim me Kur'anin e Shenjtë, që thotë se ai që vret një të pafajshëm, është njësoj sikur të kishte vrarë gjithë njerëzimin, dhe ai që shpëton një njeri të vetëm, është njësoj si të kishte shpëtuar gjithë njerëzimin. Besimi i kaq shumë njerëzve është shumë më i madh se urrejtja e disave. Islami nuk është pjesë e problemit në luftën kundër ekstremizmit të



dhunshëm. Ai është një pjesë e rëndësishme e promovimit të paqes. Ne dimë, gjithashtu, se fuqia ushtarake e vetme nuk mund ta zgjidhë problemin në Afganistan dhe në Pakistan. Kjo është arsyeja se përse kemi planifikuar që të investojmë 1.5 miliardë dollarë çdo vit, gjatë një periudhe 5-vjeçare në Pakistan, për ndërtimin e shkollave dhe spitaleve, rrugëve dhe bizneseve, si dhe për të ndihmuar miliona vetë që janë zhvendosur për shkak të luftimeve. Le të ndalemi edhe te çështja e Irakut. Ndryshe nga rasti i Afganistanit, lufta në Irak ishte një luftë zgjedhjeje, që provokoi shumë kundërshtime në vendin tim dhe në të gjithë botën mbarë. Megjithatë, unë mendoj se irakianët tani janë më mirë se nën regjimin e Sadam Huseinit dhe besoj se ato çka ndodhën në Irak, i kujtuan Amerikës se sa e rëndësishme është

të përdorësh diplomacinë dhe të marrësh një konsensus ndërkombëtar për zgjidhjen e problemeve. Për këtë, mund të kujtojmë fjalët e Thomas Xhefersonit: "Shpresoj se mençuria jonë do të rritet paralelisht me pushtetin dhe do të na mësojë se sa më pak ta përdorim pushtetin, aq më i madh do të jetë ai". Sot, Amerika ka një përgjegjësi të dyfishtë: të ndihmojë Irakun që të farkëtojë një të ardhme më të mirë dhe ta lërë atë në duart e irakianëve. Ua kam bërë të qartë irakianëve se nuk kemi ndërmend të ngremë baza dhe të pretendojmë pjesë të territorit irakian, apo qofshin këto edhe burime. Sovraniteti i Irakut u takon irakianëve. Për këtë arsye urdhërova largimin e ushtarëve tanë gushtin e ardhshëm. Për këtë arsye do të respektojmë marrëveshjen tonë me qeverinë irakiane, të zgjedhur në mënyrë demokratike për largimin e të gjitha trupave luftuese nga Iraku në korrik dhe largimin e të gjitha trupave në përgjithësi deri në vitin 2012.

Ne do ta ndihmojmë Irakun që të trajtojë forcat e tij dhe të zhvillojë ekonominë, por do të mbështesim një Irak të sigurt dhe të bashkuar si një partner dhe kurrë në pozicionin e një shteti më të fortë. Së fundmi, duke qenë se Amerika nuk mund ta tolerojë kurrë dhunën nga ekstremistët, ne nuk duhet t'i ndryshojmë kurrë parimet tona. 11 shtatori ishte një traumë e madhe për vendin tonë. Frika dhe inati që provokoi kjo ngjarje, ishte e paçmuar, por në disa raste na bëri që të sillemi në kundërshtim me idealet tona. Ne po marrim hapa konkretë për të ndryshuar. Unë kam ndaluar plotësisht përdorimin e torturës nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kam urdhëruar mbylljen e burgut të Guantanamo vitin e ardhshëm. Kësisoj, Amerika do ta mbrojë veten duke pasur respekt për sovranitetin e kombeve dhe ligjin. Këtë do ta bëjmë në partneritet me komunitetet myslimane, të cilat ndodhen gjithashtu të kërcënuara. Sa më shpejt të izolohen ekstremistët, aq më të sigurt do të jemi. Burimi i dytë i madh i tensionit është nevoja për të diskutuar në lidhje me situatën mes Izraelit, palestinezëve dhe botës arabe. Lidhjet e forta të Amerikës me Izraelin janë të njohura. Kjo lidhje është e pathyeshme. Ajo bazohet në marrëdhëniet kulturore dhe historike, si dhe në faktin se aspirata për një shtet hebre i ka rrënjët në një histori tragjike që nuk mund të mohohet. Në të gjithë botën, hebrenjtë janë përndjekur prej shekujsh dhe në Evropë antisemitizmi kulmoi me Holokaustin.

## Amerika nuk do t'ua kthejë kurrizin aspiratave të ligjshme të palestinezëve për dinjtet, mundësi dhe një shtet të vetin

Nesër do të vizitohet Buhenvaldin, që ishte pjesë e një rrjeti kampesh përqendrimi ku hebrenjtë skllavëroheshin, torturoheshin, vriteshin dhe çoheshin në dhomat e gazit nga Rajhu i Tretë. 6 milionë hebrenj u vranë, një numër më i madh se ai i banorëve të Izraelit sot. Të mohosh këtë tragjedi është e pabazë, është injorancë dhe e urryeshme. Të kërcënoh Izraelin me shkatërrim, apo të përdorësh sharje stereotipe ndaj hebrenjve, është thellësisht e gabuar dhe kjo i shërben vetëm risjelljes në vëmendjen e hebrenjve të kujtimeve të dhimbshme, duke ndaluar dhe mohuar njëherazi paqen që kërkojnë njerëzit në këtë rajon. Myslimanë dhe të krishterë kanë vuajtur për një atdhe. Për më se 60 vjet ata kanë duruar dhimbjen e zhvendosjes. Shumë presin në kampet e refugjatëve në Bregun Perëndimor, Gaza dhe vendet fqinje, për një jetë në paqe dhe siguri, një jetë që nuk e kanë pasur kurrë. Ata durojnë poshtërimet e përditshme, të vogla e të mëdha, që janë pjesë e pushtimit. Le të mos kemi më dyshime për një fakt: situata për palestinezët është tashmë e patolerueshme. Amerika nuk do t'ua kthejë kurrizin aspiratave të ligjshme të palestinezëve për dinjtet, mundësi dhe një shtet të vetin. Për ndodhur një krah të tjetër:



dy popuj me aspirate të ligjshme, secili syresh me një histori të dhimbshme. Është e lehtë të tregosh me gisht dhe të gjykojsh: për palestinezët të gjykojnë hebrenjtë, për zhvendosjet që shkaktuan themeluesit e Izraelit dhe për izraelitët të gjykojnë armiqësinë e sulmeve të palestinezëve brenda dhe jashtë kufijve të vendit. Por nëse do ta shihnim këtë konflikt vetëm nga njëra anë e tij, atëherë do të ishim të verbër ndaj të vërtetës. E vetmja zgjidhje për të dyja vendet do të ishte ajo e dyshitetëve, ku izraelitët dhe palestinezët të jetonin në paqe dhe siguri. Kjo është në interesin e Izraelit, interesin e Palestinës, në interesin e Amerikës dhe në interesin e botës mbarë. Ja përse kam qëllim që personalisht ta ndjek këtë rrugë me gjithë durimin që kërkon një detyrë e tillë. Detyrimet mbi të cilat palët kanë rënë dakord në planin për paqe, janë të qarta. Është koha për paqe, në mënyrë që të gjithë ne të mbajmë përgjegjësitë tona. Palestinezët duhet të braktisin dhunën. Rezistenca përmes dhunës dhe vrasjeve është e gabuar dhe e pamsuksesshme. Për shekuj, zezakët në Amerikë kanë vuajtur kamxhikimin dhe përluljen si skllavër që ishin, si dhe turpin e segregacionit. Por ata nuk i fituan të drejtat e tyre përmes dhunës. Ishte këmbëngulja e vazhdueshme për idealet e tyre. E njëjta histori mund të tregohet edhe për njerëzit e Afrikës dhe Azisë Jugore: me dhunë nuk shkohet askund. Dhuna nuk është as shenjë kuraje dhe as pushteti. Nuk është trimëri të vrasësh me raketa foshnjat në gjumë, apo të hedhësh në erë gratë nëpër autobusë. Autoriteti moral nuk fitohet përmes dhunës. Dhuna është dorëzim. Tani palestinezët duhet të fokusohen në ndërtimin, dhe jo shkatërrimin. Autoriteti palestinez duhet të zhvillojë aftësinë e vet qeverisëse me institucione që u shërbejnë nevojave të popullit. Hamaso gjen mbështetjen e disa palestinezëve, por edhe ai ka përgjegjësitë e tij. Luajtja e një roli për përmbushjen e aspiratave të palestinezëve dhe unifikimi i palestinezëve duhet të jetë parësor për Hamasin, i cili nga ana e tij duhet të heqë dorë prej dhunës, të njohë marrëveshjet e së shkuarës dhe mbi të gjitha të drejtën e Izraelit për të ekzistuar. Në të njëjtën kohë, Izraeli duhet të kuptojë që ashtu sikurse ai ka të drejtë të ekzistojë, edhe palestinezët kanë të drejtë për shtetin e tyre. Shtetet e Bashkuara nuk pranojnë

në legjitimitetin e vazhdimin të vendosjes së kolonëve hebrenj në tokat palestineze. Kjo dhuron marrëveshjet e mëparshme dhe prish përpjekjet për arritjen e paqes. Kjo duhet të marrë fund. Izraeli duhet që të përmbushë detyrimet e tij ndaj palestinezëve për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të shoqërisë së tyre. Kriza e vazhdueshme humanitare në Gaza ka shkatërruar familjet palestineze dhe njëherazi kërcënon vazhdimisht edhe vetë sigurinë e Izraelit. Përparimi në jetën e përditshme të palestinezëve duhet të jetë pjesë e rrugës drejt paqes dhe Izraeli duhet të ndër marrë hapa konkretë për të mundësuar një përparim të tillë. Së fundmi, shtetet arabe duhet të kuptojnë se iniciativa arabe për paqen ishte një fillim i rëndësishëm, por jo fundi i përgjegjësive. Konflikti arabo-izraelit nuk duhet të përdoret më për të shmangur vëmendjen e njerëzve nga probleme të tjera. Ai duhet të jetë shkaku për veprim, për të ndihmuar palestinezët që të zhvillojnë institucionet e tyre, që do të mbështesin shtetin e ardhshëm. Për njohjen e legjitimitetit të shtetit të Izraelit dhe zgjedhjen e progresit ndaj frymës vetëshkatërruese të së shkuarës. Amerika do të bëjë bashkë politikat e saj me politikat e atyre që synojnë paqen dhe do t'i thotë para të gjithëve ato që ua thotë privatisht hebrenjve dhe palestinezëve. Ne nuk mund ta imponojmë paqen. Në veten e tyre shumë myslimanë janë të bindur që Izraeli do të ekzistojë, sikundër shumë hebrenj janë të bindur se palestinezët do të kenë një shtet të tyre. Ka ardhur koha të veprojmë e të realizojmë atë që të gjithë e mendojnë si të vërtetë. Shumë lot janë derdhur. Shumë gjak është derdhur. Të gjithë ne kemi përgjegjësi për të punuar për ditën kur nënat e izraelitëve dhe palestinezëve do t'i shohin fëmijët të rriten pa frikë, kur Toka e Shenjtë e tri besimeve më të mëdha të planetit do të jetë vendi i paqes, vendi që Zoti kishte ndërmend të ishte, kur Jerusalemi do të jetë një shtëpi e sigurt për myslimanët, hebrenjtë e të krishterët dhe një vend për të gjithë fëmijët e Abrahamit, një vend ku ata të jetojnë në paqe e së bashku, si në tregimin e Izras, ku Moisiu, Jezusi dhe Muhamedi (paqja qoftë mbi të) luteshin së bashku. Çështja e tretë ka qenë një shkak tensioni mes Shteteve të Bashkuara dhe Republikës Islamike të Iranit. Për shumë vite, Irani e ka përcaktuar qëndrimin e tij pjesërisht përmes opozitës që i ka bërë vendit tim dhe mes të dyja vendeve ka një histori të trazuar. Në mesin e Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës luajtën një rol të caktuar për përmbysjen nga pushteti të një qeverie iraniane të zgjedhur në

mënyrë demokratike. Që nga Revolucioni Iranian, Irani ka luajtur rolin e tij në aktet e dhunës apo pengmarrjeve ndaj qytetarëve amerikanë ushtarakë, apo civilë. Kjo është një histori që të gjithë e dimë. Por në vend që të qëndroja i ngërthyer në të shkuarën, unë ua bëra të qartë liderëve të Iranit dhe popullit të tij se vendi im është i përgatitur që të ecë përpara. Tani çështja është se çfarë të ardhmeje kërkon të ndërtojë Irani? Do të jetë e vështirë që të tejkalohen menjëherë dhjetëvjeçarët e mosbesimit, por ne do të vazhdojmë me kurajë, korrektësi dhe vendosmëri. Ka shumë çështje për të diskutuar mes të dyja vendeve dhe ne jemi të gatshëm që të ecim përpara pa parakushte në bazën e respektit reciprok. Por është e qartë për të gjithë se kur bëhet fjalë për armët bërthamore ne kemi mbërritur në një pikë vendimtare. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me interesat amerikane. Kjo ka të bëjë me parandalimin e një gare të armëve bërthamore në Lindjen e Mesme që do ta çonte rajonin dhe

mbarë botën në një rrugë shumë të rrezikshme. Unë i kuptoj ata që protestojnë në lidhje me faktin që disa vende kanë armë bërthamore e të tjera vende nuk kanë. Asnjë vend i vetëm nuk duhet të vendosë, apo të zgjedhë se cili vend duhet, apo nuk duhet të ketë armë bërthamore. Ja përse unë rikonfirmoj zotimin e Amerikës për një botë në të cilën asnjë vend nuk ka armë bërthamore dhe çdo vend, përfshi Iranin, të ketë të drejtën e aksesit në energjinë bërthamore pa i përdorur ato për shkaqe luftarake. Ky zotim është në thelbin e marrëveshjes dhe jam i bindur që të gjitha vendet në rajon mund ta arrijnë këtë objektiv. Çështja e katërt ka qenë kundërshtia për promovimin e demokracisë gjatë viteve të fundit dhe kundërshtia më e madhe ka të bëjë me luftën në Irak. Më lejoni të jem i qartë për diçka: asnjë sistem qeverisës nuk mund, apo nuk duhet t'i imponohet një tjetri. Kjo nuk e zbeh aspak zotimin tim. Çdo komb i jep jetë këtij parimi në mënyrën e tij origjinale, bazuar në traditën e popullit të tij. Amerika nuk mendon se di gjithçka që është e mirë për të gjithë, por jam i bindur se të gjithë njerëzit, pavarësisht vendit, kanë mall për disa gjëra: aftësinë për t'u folur me mendje dhe për të pasur zërin e tyre në mënyrën e qeverisjes, besimit te ligji dhe administrimit të barabartë të drejtësisë, një qeverie transparente që nuk vjedh nga populli lirinë për të jetuar sipas asaj që zgjedh. Këto nuk janë vetëm ide amerikane, ato quhen

të drejta të njeriut dhe kjo është arsyeja pse ne i mbështesim kudo qofshim.

Qeveritë që mbështesin këto të drejta janë më të stabilizuara, më të suksesshme dhe të sigurta. Shtypja e ideve nuk sjell aspak zhdukjen e tyre. Amerika respekton të drejtën e gjithë zërave të paqtë dhe pro ligjit që të dëgjohen kudo në botë, edhe nëse ne mund të mos jemi dakord me ta. Ne do t'i mirëpresim të gjitha qeveritë e zgjedhura në mënyrë paqësore, me kusht që ato të qeverisin me respekt popujt e tyre. Kjo çështja e fundit është e rëndësishme, sepse ka disa që bëjnë avokatin e demokracisë, vetëm kur nuk janë në pushtet. Sapo vijnë në pushtet shndërrohen në shtypës të pamëshirshëm të të drejtave të të tjerëve.

### Islami ka një traditë krenare tolerance

Çështja tjetër për të cilën dua të flas është liria e besimit. Islami ka një traditë



krenare tolerance. Këtë e shohim në historinë e Andaluzisë dhe Kordobës gjatë periudhës së Inkuizionit. Këtë e kam parë edhe vetë personalisht në Indonezi, aty ku kristianët e devotshëm adhuronin lirshëm Zotin e tyre në një vend mysliman. Ky është shpirti që na duhet sot. Njerëzit në çdo vend duhet të jenë të lirë të zgjedhin dhe të jetojnë besimin e tyre bazuar në atë çka u thotë zemra, mendja e shpirti. Kjo tolerancë është thelbësore për fenë, por sfidohet në mënyra nga më të ndryshmet. Mes disa myslimanëve ka një tendencë shqetësuese për të matur devotshmërinë e një besimi me masën e dënimit të një besimi tjetër. Pasuria e diversitetit të feve duhet të mbetet. Çarjet duhet të mbyllen edhe mes vetë myslimanëve, për shembull ato mes sunitëve dhe shiitëve që kanë shkaktuar dhunë e tragjedi, veçanërisht në Irak. Liria e besimit është qendrore për njerëzit për të jetuar së bashku. Ne duhet gjithmonë të analizojmë mënyrat e mbrojtjes së saj. Për vendet perëndimore

është e rëndësishme që të shmangim pengimin e myslimanëve për të praktikuar fenë ashtu sikundër ata e kanë më për mbarë, për shembull në rastin e veshjes. Nuk duhet të shfaqim armiqësi ndaj asnjë feje në emër të liberalizmit. Në fakt, besimi duhet të na bëjë bashkë. Ja përse po farkëtojmë projekte në Amerikë që bëjnë bashkë të krishterët, myslimanët dhe hebrenjtë. Ja përse mirëpresim përpjekjet e Mbretit Saudit Abdullah për dialogun ndërfeetar dhe lidhshin e Turqisë në Aleancën e Civilizimeve. Në të gjithë botën ne duhet ta shndërrojmë dialogun në një shërbim ndërfeetar, kështu do të vendosen urat mes njerëzve.

Çështja e gjashtë ka të bëjë me të drejtat e grave. E di se ka debat në lidhje me këtë çështje. Unë nuk jam me mendimin e disave në Perëndim, që një grua që zgjedh të mbulojë flokët nuk është e barabartë me një tjetër që nuk e bën këtë zgjedhje, por besoj se një gruaje që i mohohet shkollimi

i është mohuar barazia. Dhe nuk është rastësi që vendet ku gratë janë të shkolluara mirë janë më të begata nga ato ku gratë shtypen. Tani më lejoni të jem i qartë: çështja e barazisë së grave nuk është një çështje vetëm e Islamit. Në Turqi, Pakistan, Bangladesh dhe Indonezi ne kemi parë shumicën myslimane që të zgjedhë një grua si lideren e tij. Ndërkohë lufta për barazitë mes burrit

dhe gruas vazhdon edhe në shumë aspekte të jetës amerikane dhe në vende të ndryshme në të gjithë botën. Bijat tona mund të kontribuojnë në shoqërinë tonë, sikundër edhe bijtë dhe begatia jonë e përbashkët do të avancohej më shumë nëse burrat e gratë do të jepnin gjithë potencialin e fuqisë së tyre pa kufizim. Unë nuk mendoj se gratë duhet të bëjnë të njëjtat zgjedhje si burrat për të qenë të barabarta me ta. Dhe respektoj ato gra që zgjedhin një rol tradite për veten e tyre. Por kjo vetëm në rast se ato janë të lira në zgjedhjen e tyre. Ja përse Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të bëjnë partneritet me çdo vend me shumicë myslimane, që synon shkollimin e femrave dhe do të ndihmojnë gratë e reja të punësohen në projektet e mikro-financës, e mbi të gjitha, do të ndihmojnë njerëzit të bëjnë realitet ëndrrat e tyre. Së fundi, dua të diskutoj zhvillimin ekonomik.

E di se për shumë globalizimi është kontradiktore. Interneti dhe televizioni sjellin

dije dhe informacion, por edhe seksualitet të tepruar dhe shumë dhunë. Tregtia mund të të sjellë pasuri dhe mundësi, por edhe të ndryshojë shumë komunitetet. Në të gjitha kombet, përfshi kombin tim, ky ndryshim mund të sjellë frikë. Frikë se për shkak të modernitetit mund të humbasim kontrollin mbi zgjedhjet tona ekonomike, mbi politikën dhe mbi të gjitha mbi identitetin tonë. Këto gjëra janë vlerat më të mëdha që ndajmë me komunitetet dhe familjet tona. Por unë e di gjithashtu se përparimi njerëzor nuk mund të mohohet. Nuk duhet të ketë kontradiktë mes modernes dhe traditës, sepse vende si Japonia dhe Koreja e Jugut kanë arritur një zhvillim të madh ekonomik, duke ruajtur edhe traditat dhe kulturën e tyre. Kjo është e vërtetë edhe në rastrin e Kuala Lumpurit apo Dubait. Në lashtësi dhe në kohën tonë, komunitetet myslimane kanë qenë në avantgardë të zhvillimit dhe shkollimit. Shumë shtete të Gjirit Persik përjetojnë një pasuri e begati të madhe si pasojë e naftës së nëntokës së tyre dhe disa vende të tjera po përqendrohen në zhvillimin e mëtejshëm. Por të gjithë së bashku duhet të jemi të vetëdijshëm se shkollimi dhe novacioni do të jenë monedha e shekullit të 21-të. Ndërsa në të shkuarën Amerika ka pasur më shumë interes në naftën dhe gazin e vendeve të Gjirit, në të ardhmen interesat do të jenë më të mëdha. Për sa i përket shkollimit, ne do të nisim programet e shkëmbimit dhe shtojmë bursat e studimit, si ato që sollën tim at nga Afrika në Amerikë për të studiuar dhe do të nxisim më shumë amerikanë të studiojnë në vendet myslimane. Do të investojmë te mësuesit on line dhe do të krijojmë një rrjet të ri on line në mënyrë që adoleshentët e Kansasit të mund të komunikojnë në moment me atë të Kajros. Për sa i përket shkencës dhe teknologjisë do të lansojmë një fond të ri për të mbështetur zhvillimin teknologjik në vendet me shumicë myslimane dhe do të ndihmojmë në

transferimin e ideve të tyre në tregun punës, në mënyrë që të krijohen vende pune. Do të hapim qendra shkencore në Afrikë, Lindjen e Mesme dhe Azinë Juglindore dhe do të caktojnë të dërguar të posaçëm për çështjet shkencore që të bashkëpunojnë në programet që zhvillojnë burime të reja energjetike, që krijojnë vende pune ekologjike etj. Sot po njoftoj për një përpjekje të re globale me Organizatën e Konferencës Islamike për çrënjosjen e poliomiellit. Dhe do të zgjerojmë edhe partneritetin me komunitetet myslimane për të promovuar shëndetin e nënës dhe fëmijës. Të gjitha këto duhet të bëhen në partneritet. Amerikanët janë të gatshëm që të bashkojnë forcat me qytetarët dhe qeveritë, organizatat e komunitetet, liderët fetarë dhe bizneset e komuniteteve myslimane në të gjithë botën për të ndihmuar njerëzit për një jetë më të mirë.

### **Kemi përgjegjësinë për t'u bërë bashkë në emër të botës që duam**

Çështjet që përshkrova më sipër nuk janë të thjeshta, por ne kemi përgjegjësinë për t'u bërë bashkë në emër të botës që duam, një bote që nuk kërcënohet nga ekstremistët dhe një bote me trupat amerikane në shtëpi, një bote ku hebrenjtë dhe palestinezët janë të sigurt në shtetet e tyre dhe energjia bërthamore përdoret vetëm për qëllime civile, një bote ku qeveritë janë në shërbim të qytetarit dhe ku respektohen të drejtat e të gjithë bijve të Zotit. Këto janë interesat e përbashkëta. Kjo është bota që kërkojmë dhe që mund ta realizojmë vetëm së bashku. E di që janë të shumtë ata, myslimanë ose jo, që e vënë në dyshim këtë fillim të ri. Disa janë të etur për flakët e ndarjes dhe i bëjnë pritë progresit. Disa të tjerë sugjerojnë se nuk ia vlen përpjekja, sepse fati ynë është mosmarrëveshja dhe civilizimet janë të destinuar të përplasen. Të tjerë janë thjesht mosbe-

sues në lidhje me ndryshimet. Ka shumë frikë, shumë mosbesim, por nëse zgjedhim të mbesim të lidhur me të shkuarën nuk do të mund të ecim kurrë përpara. Unë dua veçanërisht të them se ju të rinjtë e çdo feje, në çdo vend, ju mbi të gjitha e keni aftësinë e të bërit të botës. Të gjithë e ndajmë këtë botë së bashku për një periudhë të shkurtër kohe. Çështja është nëse këtë kohë e kalojmë të përqendruar tek ato që na ndajnë, apo tek ato që na bashkojnë, apo te zotimi për gjetjen e të përbashkëtave, tek e ardhmja e fëmijëve tanë dhe respekti për dinjitetin e gjithë qenieve njerëzore. Është më e lehtë të nisësh luftëra se sa t'i përfundosh ato. Është më e lehtë të fajësosh të tjerët se të shohësh brenda vetes, të shohësh atë çka ke të përbashkët me dikë e pastaj këtë ta ndash. Por ne duhet të zgjedhim rrugën e duhur, që shpesh mund të mos jetë më e lehta. Ka gjithashtu një rregull që ndodhet në bazën e çdo feje, ajo që ne duhet t'i bëjmë të tjerëve atë që do të donim të tjerët të bënin për ne. Kjo e vërtetë nuk njihet kufij njerëzish dhe kombesh. Është një besim i vjetër, që nuk është i bardhë, apo i zi, i krishterë, apo mysliman, apo hebre. Është një besim që ka pulsuar që në djepin e civilizimit dhe që rreh ende zemrën e miliona vetëve. Është besimi te të tjerët ai besim që më solli sot këtu. Ne kemi pushtetin të ndërtojmë botën që duam, por vetëm nëse kemi kurajën për të nisur një fillim të ri, duke pasur në mendje atë që është shkruar.

Kurani i Shenjtë na thotë: "O njerëzim! Të kemi krijuar në formën e mashkullit dhe femrës dhe me kombe e fise në mënyrë që të njihni njëri-tjetrin". Bibla na thotë: "Të bekuar janë paqebërësit, sepse ata do të quhen bij të Zotit". Njerëzit e botës mund të jetojnë së bashku në paqe. Ne e dimë se ky është vizioni i Zotit. Tani, kjo duhet të jetë detyra jonë edhe këtu në Tokë.

Ju falënderoj dhe paqja e Zotit qoftë me ju. ■  
(Nëntitujt janë të redaksisë)



Intervistë me prof. dr. Fadil Malokun, sociolog i globalizmit dhe anëtar i Shoqatës së Sociologëve

# Kosova po kalon nëpër një pr

- Kemi obligim të adresojmë diagnoza dhe terapi shkencore e sociologjike;
- Identiteti i Kosovës në procesin e globalizimit;
- Ministria e jashtme duhet të angazhohet më shumë;
- Anëtarësimi i Kosovës në OKB një nga interesat strategjike.

## Intervistoi: Demir RESHITI

Në politikën globale, sot është e padiskutueshme tendenca e procesit të globalizimit, e cila si e tillë, dalëngadalë por sigurt, është duke i mbizotëruar kornizat e zhvillimeve dinamike politike në botë me qëllimin e marginalizimit sa më të mundshëm të formave tradicionale të organizimit dhe të menaxhimit të jetës së qytetarëve, që i dalin asaj si pengesa serioze në galopimin e mëtejshëm të afirmimit. Në këtë kontekst, duket që as trendi i kompetencave të reja që burojnë nga vlera e diskursit të sovranitetit të shtetit, që për globalistët është identifikuar si një "rezervat" i tipit të veçantë, apo siç do të thoshte Aristoteli, një "zoom politikon-i", nuk bëjnë ndonjë përjashtim karakteristik kur është në pyetje procesi i shtimit të interesave globale të tyre. Dilema më e madhe që u sjell sot sociologëve të globalizmit, kur janë në pyetje këto ndryshime marramendëse, pa dyshim që ka të bëjnë me rolin dhe perspektivën e institucionit të shtetit në të ardhmen.

Për të mësuar më për së afërmi lidhur me këto procese globale dhe ndikimin e tyre në Kosovë, zhvilluam një intervistë me sociologun e globalizimit dr. Fadil Malokun, anëtar i Shoqatës së Sociologëve Botërorë.

### Kemi obligim të adresojmë diagnoza dhe terapi shkencore e sociologjike

**PAQJA:** Profesor, ju jeni ndër të paktët, në mos i vetmi sociolog që merreni me tema të nxehta globale, por duke mos i anashkaluar as ato periferike. Na thoni cili është roli i sociologut në shoqërinë tonë?

**MALOKU:** Kosova po kalon nëpër një proces shumë interesant dhe shumë specifik dhe kujtoj që ky është një obligimi i yni jo vetëm profesional (që t'i detektojmë shkaqet dhe pasojat e mundshme) por edhe shkencor që t'i analizojmë këto "fakte" të



**Fadil Maloku** është i lindur më 1958, në Be-sianë. Është profesor i Sociologjisë së Globalizmit në Universitetin e Prishtinës dhe në kolegjin Universitar "Victory". Deri më tani ka shkruar mbi 300 shkrime dhe analiza lidhur me diskutet politike, etnike, demokratike, filozofike, fetare, sociologjike etj. Ka marrë pjesë në shumë konferenca, seminare dhe panele shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është autor i ditarit të luftës të titulluar "Veç Zoti na shpëtoi" botuar nga SHB "Gjurma" në vitin 2008.

Dr. Sci. Fadil Maloku është anëtar i Shoqatës së Sociologëve Botërorë.

gjalla dyrkësi dhe të adresojmë diagnoza dhe terapi shkencore e sociologjike. Kjo duhet bërë në mënyrë që gjeneratat që po vijnë, të paktën në vija të trasha, të kenë informacionin se çfarë ndodhi në të vërtetë me këto dy dekadat e fundit.

Pa modesti e them që shkruajnë edhe kolegët e tjerë, por dikush ka më shumë e dikush më pak kohë. Kujtoj që është në pyetje koha dhe i gjithë procesi nëpër të cilin po kalojmë, edhe si individ, edhe si familje e dhe si komunitet. Studentëve të mi shpesh u them, me qëllim që t'i inkurajoj, që të shkruajnë për këto dukuri dhe fenomene të papërsëritshme, sepse ne, në një farë mënyre, jemi mjekët e kësaj shoqërie. Kurse për kolegët thashë se ata e bëjnë punën e tyre si duhet, megjithëse ka edhe të tillë që janë inkorporuar në politikë dhe natyrisht një pjesë të mirë të kohës ua merr angazhimi në politikë.

**PAQJA:** Ju, me shkrimet tuaja, jeni shumë i pranishëm nëpër media. A planifikoni që këto shkrime t'i përmbledhni në ndonjë libër?

**MALOKU:** Po, po, gjithsesi, por koha nuk po më premtonte edhe gjithaq. Angazhimet e shumta edhe mua po me marrin kohën e duhur për t'i finalizuar dy tekste që që sa kohë po presin ta shohin dritën. Përgatitjet jam duke i bërë dhe shpresoj se së shpejti, me ndihmën e Zotit, do ta shohin dritën e botimit.

**PAQJA:** A mund të na thoni për çfarë botimesh është fjala?

**MALOKU:** Jam duke përgatitur një tekst universitar lidhur me globalizimin dhe identitetin e Kosovës në këtë proces, si edhe një tjetër për fenomenet dhe proceset nëpër të cilat ka kaluar Kosova në dy dekadat e fundit.

### Identiteti i Kosovës në procesin e globalizimit

**PAQJA:** Përmendët globalizimin. Ju e ligjëroni këtë lëndë në Departamentin e Sociologjisë. A mund të na thoni në pika të shkurtra çka është ky fenomen?

**MALOKU:** Po si tu them, fjala është për një koncept të ri në botën akademike

ve Botërorë

# Proces shumë specifik

që kohëve të fundit është bërë objekt i shumë debateve dhe analizave, duke filluar që nga ato ekonomike, politike, ushtarake e sidomos kulturore. Në fakt, që në fillim duhet, sa për informim për lexuesit, të them se duhet bërë një dallim në mes termave globalizëm, globalizim dhe globalitet. Globalizmi, në të vërtetë, nëse nisemi nga analiza e vokacionit që ai asocon ka të bëjë me diskutimet që ndërlihen me ideologjinë dhe tendencën e dominimit botëror. Ai në vetvete ngërthen peshën dhe synimin për t'u ngritur në nivel të një botëkuptimi apo doktrine me përmasa botërore, siç ishin kapitalizmi, fashizmi dhe komunizmi. E themi kështu, për shkak se ai për të mbijetuar sfidën e kohës, sipas përvojave të ideologjive të mësipërme, patjetër i duhet mbulesa doktrinare që sot është bërë një objekt i diskutimeve jo vetëm akademike, por do të thosha (sidomos kohëve të fundit!) edhe i atyre politike, ushtarake e në veçanti ekonomike e kulturore.

Globalizimi konsiston në faktin që njeriu i rëndomtë të fitojë një përshtypje dhe shumë më shumë një perceptim individual se shoqëritë dhe shtetet apo vendet përreth tij jetojnë në një ambient shoqëror, do të thosha me përmasa planetare, pra, në një civilizim dhe kulturë të përbashkët për të gjithë njerëzit e botës, ku asnjë vend, asnjë shtet nuk do të mund të mbijetojë po qe se izolohet dhe pretendon të ruajë veçantitë e veta përmes ekskluzivitetit të izolimit. Korniza e qëndrimit që individi përmes përshtypjes se vetëm ai është zotërues dhe kompetent për të përkufizuar rrethin e vetë ekskluziv, bën që ky qëndrim dhe kjo përshtypje e tij, njëkohësisht personale (e më vonë edhe kolektive), të ndikojë në shtrirjen apo globalitetin e globalizimit.

Pra, nëse e abstraktojmë me dy tri fjali mund të thuhet se karakteristikat kryesore që e adresojnë fenomenin e globalizimit, gjë që edhe shumica e autorëve pajtohen, do të mund të përmbledheshin deri diku në zhvillimin e jashtëzakonshëm të logjikës së kapitalit; llojllojshmërinë e akomodimit në kushte dhe rrethana planetare; zhvillimin ciklik të proceseve dhe në mbijeti-

min e tyre; dualitetin e institucionit të shtetit në rrethanat e reja konkurruese me kompanitë e mëdha transnacionale; gjithë përfshirjen dhe në të njëjtën kohë heterogjenitetin; jo përsosurinë e procesit të identifikuar si demokraci neoliberal; institucionalizimin e skajshëm të konkurrencës; dominimin e rregullave të tregut mbi ato të institucionit të shtetit, etj. Dhe krejt në fund, nëse më lejoni globalizimi, mund të analizohet edhe përmes interaksionit të sistemit të shteteve kombëtare, ekonomisë botërore kapitaliste, ndarjes ndërkombëtare të punës, rendit të ri ushtarak botëror, si edhe globalizimit kulturor dhe atij të komunikimit masiv.

**PAQJA: Çfarë mund të na thoni për vendin e identitetit të Kosovës në këtë proces kundërthënës?**

**MALOKU:** Kur është në pyetje konteksti i debateve mbi diskursin e globalizimit, ende nuk është e qartë se çka është në të vërtetë duke u globalizuar, e çka eventualisht do të duhej të procedohej si nevojë për t'u globalizuar. Kjo lloj dileme që tash së voni ka depërtuar edhe në qarqet akademike botërore, që në start, krijon një lloj paragjykimi për rrezikun që shkakton apo mund të shkaktojë procesi i globalizimit në formën e pretekstit: për gjoja fillimin e humbjes së identitetit kombëtar, fetar, politik, kulturor, etj.

Ndërsa, kur është në pyetje çështja e diskutimit të konceptit mbi identitetin


duhet thënë që ky në rastin tonë nuk është kuptuar dhe përdorur vetëm si trajtim që nënkupton raportin me traditën dhe trashëgiminë biologjike të grupeve të caktuara me prejardhje: etnike, politike, kulturore, etj, por si sistem vleror jo vetëm kulturor, por edhe etnik, kombëtar, shtetëror, politik, etj., pra një pluralizëm i mundësive për vlerat që krijojnë dhe i fuqizojnë grupet e ndryshme me kapacitete dhe me struktura heterogjene.

## Ministria e jashtme duhet të angazhohet më shumë

**PAQJA: Ju jeni anëtar i Shoqatës së Sociologëve Botërorë. Cili është roli juaj në këtë shoqatë dhe sa keni mundësi që të jepni kontributin tuaj përkitazi me procesin e sensibilizimit të botës rreth njohjes së Kosovës?**

**MALOKU:** Kjo shoqatë ka përfaqësinë e vet qendrore në SHBA, por ka një qasje në gjithë globin. Në fakt, aty zhvillohet debat në nivel botëror dhe shtjellohen tema aktuale nga të gjitha meridianët e botes, siç janë: lufta në Irak, Afganistan, të drejtat e njeriut në këto vende, fjalimi i Presidentit Obama, etj. Ajo çka e shquan këtë forum ka të bëjë se këtu debati është i hapur dhe pa paragjykime ideologjike, etnike, racore e as fetare. Unë nëpërmjet shkrimeve të mia angazhohem që kolegët e mi ndërkombëtarë t'i njoftoj me realitetin e ri të krijuar në Kosovë dhe me proceset që po zhvillohen këtu. Ideja është që t'i ndihmohet vendeve të ndryshme të botës që të shkojnë në koherencë me nevojën e njohjes së shtetit të Kosovës.





**PAQJA: Si e shihni me dioptrinë e një sociologu procesin e njohjes së Kosovës, nga këto vende?**

**MALOKU:** Para se gjithash me duhet të them se për t'i diagnostifikuar këto ngjarje me "dioptrinë" e një sociologu siç po theksoni ju, nevojitet një kohë pak a shumë më e gjatë, ngaqë është një rregull në shkencat sociologjike se fenomenit apo dukurisë, që është në zhvillim e sipër me bioritmin e dhe dinamikën e saj shoqërore, i nevojitet të "konsolidohet" në kuptimin e identifikimit të parametrave që e shkaktuan dhe e dominuan atë në tërë këtë proces. Në rastin konkret, gjykoj që atyre u nevojitet kohë pakëz më e gjatë për të analizuar si shkaqet, ashtu edhe pasojat e njohjes, qoftë individuale apo në grup të këtyre shteteve. Jam shumë i bindur që ministria përkatëse ka bërë pak ose të themi aspak për të njoftuar, sensibilizuar, apo të paktën kontaktuar zyrtar diplomatike të këtyre vendeve në

mos për asgjë bile për shkak se Ballkani ka disa milionë njerëz të kësaj përkatësie fetare që nuk mund të anashkalohej në asnjë mënyrë. Në realitet, punën më të madhe, sikurse edhe në vendet e tjera qoftë në perëndim apo qoftë në lindje, është duke e ndihmuar sidomos lideri i AKR-s, Behgjet Pacolli, i cili dorën në zemër është duke bërë një punë të madhe. Gjykoj që është një lloj precedence e paparë kur dihet se çfarë peshe çon edhe një njohje e vetme nga ana e ndonjë shteti, cilido qoftë dhe prej ngado qoftë ai.

### **Anëtarësimi i Kosovës në OKB një nga interesat strategjike**

**PAQJA: Si do ta perceptonit interesin kombëtar të Kosovës në këtë fazë të pas pavarësisë?**

**MALOKU:** Një ndër preokupimet qytetare në këtë fazë të zhvillimit të identiteteve të gjithëmbarshme, përmes të cilit do të mund të identifikoheshin qytetarët e Kosovës, para se të rrumbullakohet identiteti i tyre shtetëror, padyshim që është preokupimi i definimit të asaj që të gjithë popujt e civilizuar e identifikojnë si interes nacional të vetin. Për ne, si shtet i ri, kujtoj që interes vital nacional do të mund të ishin: ndërtimi i kapaciteteve demokratike, proceset integrative rajonale dhe ato evropiane, inkuadrimi i Kosovës në institucionet me rëndësi ndërkombëtare, siç janë aktualisht Kombet e Bashkuara. Ndërsa, në planin e brendshëm afirmimin sa më të madh të drejtave individuale, etnike, racore, e fetare të njerëzve të Kosovës.

**PAQJA: Në fund, cili do të ishte mesazhi i juaj për lexuesit tanë?**

**MALOKU:** Ndjehem i privilegjuar që nëpërmjet kësaj interviste po bashkëkomunikoj me lexuesit e revistës 'Paqja' e cila kujtoj se ka bërë një vend të rëndësishëm në mediet e shkruara në Kosovë. Juve si redaksi, gazetarëve, bashkëpunëtorëve dhe të gjithë lexuesve u uroj shëndet dhe mbarësi. Të punojmë e lexojmë sa më shumë sepse vetëm nëpërmjet arsimimit mund të hapërojmë me trendet e botës bashkëkohore. ■



# Investimet e huaja - nevojë imediate



Sead UJKANI

**Investimet e huaja janë identifikuar si mundësia më e mirë për daljen nga kriza dhe për stabilizimin ekonomik të Republikës së Kosovës.**

**L** gjidhja e statusit të Kosovës, respektivisht shpallja e pavarësisë së saj, si dhe procesi i vazhdueshëm i njohjeve nga shtetet më të fuqishme të globit, kanë ndryshuar agjendën e shtetit tonë në rrugëtimin e tij drejt stabilizimit dhe prosperitetit afatgjatë. Në këtë kontekst, zhvillimi ekonomik, duke marrë parasysh rëndësinë e tij dhe situatën në vend, është identifikuar domosdoshmërisht si preokupimi kryesor i qytetarëve dhe ky preokupim, si i tillë, duhet të jetë pikënisje e prioriteteve të qeverisë së vendit.

Në përgjithësi, me gjithë ngecjet evidente dhe periudhën e tranzicionit të vështirë, e cila ka karakterizuar vendin tonë sidomos në dekadën e fundit, shikuar në tërësi, Republika e Kosovës ka arritur progres të dukshëm në gjithë lëmenjtë edhe pse jo në nivelin e kënaqshëm dhe të duhur.

Përderisa në fillimvitet e pasluftës indikatorët ekonomikë të vendit tregojnë një situatë të

rëndë socio-ekonomike, vitet e fundit ka pasur lëvizje pozitive në këtë drejtim, ndonëse gjendja e rëndë socio-ekonomike vazhdon edhe më tutje.

Dhe duke shikuar zhvillimet dhe avancimet në lëmin e ekonomisë dhe tërë vendit në tërësi, në të gjitha sferat, investimet e huaja janë identifikuar si mundësia më e mirë për daljen nga kriza dhe për stabilizimin ekonomik të vendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një platformë për tërheqjen e investitorëve të jashtëm dhe ky prioritet zë një vend të rëndësishëm në programin qeverisës, mirëpo, duke marrë parasysh gjendjen e tanishme, çdo ngecje në këtë drejtim do të ishte shumë e dëmshme për vendin tonë, duke pasur parasysh nevojat e mëdha për investime të tilla.

Konstituimi i agjencisë për promovimin e investimeve të huaja – element i rëndësishëm

Vazhdimi i procesit të privatizimit, me gjithë të metat dhe debatet që e kanë karakterizuar, vërehet si mundësi shumë e mirë e sjelljes së investitorëve të huaj. Inicimi i ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re”, ndarja e një shume prej rreth 1,3 miliardë eurosh për konstruktimin dhe ndërtimin e hekurudhave të reja, miratimi i ligjit për investime të huaja, reformat në politikën fiskale, janë disa nga hapat e fundit të ndërmarrë që kanë karakterizuar realizimin e projekteve kapitale dhe strategjinë e joshjes së investitorëve të huaj.

Konstituimi i agjencisë për promovimin e investimeve të huaja, në kuadër të Qeverisë së Kosovës, me mision të qartë për tërheqjen dhe sjelljen e investitorëve në vendin tonë, vendosja e saj me përfaqësi edhe në Vjenë dhe promovimi i saj në mënyrë elektronike është një element tjetër që ka karakterizuar procesin e tërheqjes së investimeve të huaja në vendin tonë.

Natyrisht, ndërmarrja e hapave të lartcekur ka rëndësinë e vet, mirëpo

Janë katër fusha si më prioritare në tërë procesin e tërheqjes së investimeve të huaja, në të cilat duhet vënë theksi i vazhdueshëm për përmirësimin e tyre: 1. Stabilizimi i furnizimit me energji elektrike, 2. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore, 3. Sundimi i ligjit dhe zbatimi i duhur i ligjeve të miratuara në Kuvend, dhe 4. Konsolidimi i Sistemit Gjyqësor.

nevoja për një punë kontinuale dhe angazhim të madh në këtë drejtim është edhe shumë më domethënëse meqë realisht nevoja për investime të tilla është e padiskutueshme dhe kryesore për vendin tonë. Hapja e vendeve të reja të punës, avancimi dhe sjellja e teknologjisë moderne janë disa nga përparësitë kryesore të investimeve të huaja.

Sistemi bankar dhe telekomunikacioni – fushat më të preferuara për investitorët e jashtëm

Deri më tani, sistemi bankar dhe telekomunikacioni kanë qenë fushat e preferuara për investitorët e jashtëm. Mirëpo aktualisht vendi ynë ka nevojë më të madhe për investime kapitale në lëmin e prodhimit dhe mbi të gjitha, nga këtu, duhet të jetë pikënisja për joshjen e investimeve të huaja që do të ndikojnë në masë të madhe në përmirësimin e situatës socio-ekonomike në vend.

Janë katër fusha si më prioritare në tërë procesin e tërheqjes së investimeve të huaja, në të cilat duhet vënë theksi i vazhdueshëm për përmirësimin e tyre: 1. Stabilizimi i furnizimit me energji elektrike, 2. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore, 3. Sundimi i ligjit dhe zbatimi i duhur i ligjeve të miratuara në Kuvend, dhe 4. Konsolidimi i Sistemit Gjyqësor.

Elementet e lartcekura gëzojnë “privilegjet” kryesore të preokupimit dhe përmirësimin e tyre dhe nuk është nevoja për shtjellime përcjellëse për të treguar rëndësinë e tyre për faktin që këto si të tilla janë fundamentale edhe për funksionimin e mirëfilltë të vendit tonë, edhe për krijimin e një mjedisi të mirëfilltë për investitorët e jashtëm, në mënyrë që ata mjetet e tyre t’i derdhin në zhvillimin e ekonomisë së Republikës së Kosovës.



Korrespondencë nga Shkupi

# Maqedoninë e zuri haku im



Avni AVDIU

**E**shtë shkruar dhe është folur shumë për qëndrimin pezhorativ të palës maqedonase ndaj shqiptarëve. Bëhet fjalë për një periudhë rreth dy dekadash, pa llogaritur fare atë komuniste. Zaten ajo periudhë here-herë në kujtesën e shumëkujt mund të fanepset edhe si më e ndritur për shqiptarët (gjuha shqipe ishte zyrtare në nivel republikan, flamuri me shqiponjë valonte pa pengesa ligjore, madje edhe kryetari i parlamentit ishte shqiptar etj.). Kur u mëvetësuan maqedonasit nga ish-RSFJ, filluan ta ndiejnë veten si dikushi.

Duke mos dashur t'i përsëris të gjitha ato që i bënë, dua të theksoj vetëm faktin se të gjitha pushtetet paskomuniste maqedonase cungimin e të drejtave të shqiptarëve e llogaritën si prioritet në agjendën e politikës së tyre ditore. Atyre u dukej se sa më pak të drejta t'u jepeshin shqiptarëve, aq më tepër përfitonin ata. Në këtë rrafsh vlen të cekem dy gjëra: 1) Ata njëmend përfitojnë, sepse e përvetësojnë elektoratin maqedonas, tradicionalisht të disponuar kundër shqiptarëve dhe 2) Mbase nuk e them gabimisht se 'sa më pak të drejta u jepeshin shqiptarëve', sepse përfaqësuesit politik vasalë të shqiptarëve, u treguan aq inferiorë sa që nuk ditën t'i fitojnë të drejtat në mënyrë demokratike. Fatkeqësia e tyre, që mjerisht mjerimi i mentalitetit që kishin e konsideronte fat, ishte se avancim të pozitës së shqiptarëve e konsideronin punësimin e aktivistëve të tyre partiakë. Bile çështje më e keqja, duke i bërë ligjërues universitarë edhe njerëzit gjysmanalfabetë me 'dy ditë shkollë'. Kështu e detyruan popullin t'i rrokë armët. Dhe çështje më e keqja edhe kjo s'bëri punë. Betejat e fituara në luftë po humbasin në paqe.

## Ne ashtu e ju kështu...

Për t'i vrarë të drejtat e shqiptarëve, Gruevskit armën ia dhanë dhe po ia mbushin partitë shqiptare. Ato shtyhen me njëra-tjetrën se cila më pak se tjetra ishte qyqare. "Ne ashtu e ju kështu" - është retorika boshe që përumbet në vetëdijet e ulëta politikisht të papjekura të elektoratit, që i harrojnë të bëmat e partive me ose pa vetëdije.

Partitë shqiptare po të dinin të skuqeshin përpara se t'ua kuqin të tjerët, do të duhej të kthjelloshin nga ethet e qeveriomanisë. Top temë e tyre gjithnjë është se cila do ta ndajë kulaçin e qeverisë.

Kolumnisti Branko Gerovski në të përditshmen 'Shpic' thotë se është e pabesueshme se sa e adhurojnë shqiptarët

Ahmeti kërkoi zgjedhje të parakohshme në kohën kur Gruevski ishte në kulmin e rejtingut të tij, duke i siguruar atij shumicën e nevojshme për të mos i përfillur shqiptarët. Ato zgjedhje i kërkoi sepse nuk mund të duronte dy vjet pa hyrë në qeveri. Pas zërave se në qeveri mund të përfshihet edhe DR e Imer Selmanit, ministri i pushtetit lokal Musa Xhaferi u deklarua: "Nuk dua të jem cinik, por në sallën ku i mbajmë mbledhjet, nuk ka mjaft vend, pasi është shumë e vogël". Ndërkaq lideri i tij, Ali Ahmeti, duke u frikësuar se me veprimet e fundit të Gruevskit po lëkundet pozicioni i tij në qeveri, e shfaq krejtësisht jashtë kontekstit simptomën e fobisë së tij me fjalët: "Koalicioni VMRO-BDI funksionon dhe



po punohet në vazhdimësi për të pasur realizime të programeve për të cilat ne i kemi premtuar elektoratit. Nuk mendoj se as zoti Sejdiu, as institucionet e Kosovës, e as ndonjë tjetër mund të pajtohet që BDI të braktisë koalicionin qeverisës dhe nuk do të ishte në leverdi as të Kosovës dhe as të Maqedonisë, por edhe më gjerë". Janë të mjaftueshme këto prononcime për të ilustruar sëkëlldinë për pushtet të politikanëve shqiptarë.

## Pala maqedonase luan me partitë shqiptare si macja me miun

Ata që janë në qeveri kanë siklet si të mbeten ose mos po u hyn ndërmjet ndonjë parashutist i papritur, kurse ata që s'janë mezi mbijetojnë, sepse u ikin deputetët, anëtarësia dhe detyrimisht u imponohet të shtiren më ekstrem, duke bërë përpjekje që të përfitojnë masën në çfarëdo forme qoftë. Në vazhden e këtyre tentativave mund të interpretohet edhe iniciativa e fundit e PDSH-së për të ashtuquajturën marrëveshje të re shqiptaro-maqedonase. Njëmend, Marrëveshja e Ohrit është bërë demode për shkak të zvarritjes së implementimit të saj, mirëpo sado fisnike të jetë kjo orvatje e re politike, shtrohet pyetja a do ta shtronte kjo parti këtë po të ishte

qeverinë. Pas 'triumfit' të parë të PDSH-së në zgjedhjet e vitit të shkruar, në konferencë për gazetarë, lideri Menduh Thaçi u shpreh: "Kjo është fitorja jonë më e ëmbël dhe më e mundimshme", ani pse atë ditë u vra një shqiptar dhe disa u plagosën. Ish-deputeti i PPD-së, Ismet Ramadani, duke e arsyetuar inkuadrimit të partisë së tij në qeverinë Gruevski të 2006, para qytetarëve të Kumanovës theksonte: "Po na akuzojnë se pse kemi hyrë në qeveri, thuajse BDI-ja nuk do të hyjë në qeveri. Edhe BDI-ja dëshiron të hyjë në qeveri, bile lëng goja po ju qet". Kjo ashtu edhe ndodhi. Ali

në qeveri? Tekefundit shqiptarët s'po vuajnë nga mungesa e 'marrëveshjeve' me maqedonasit, sepse 'marrëveshje' ka sa të duash (1. Marrëveshja e Ohrit 2001; 2. Marrëveshja e Majit 2007 Ahmeti-Gruevski dhe 3. Marrëveshja e Marsit 2008 Thaçi-Gruevski), por e keqja është se ato janë shndërruar në mosmarrëveshje. Prej tyre pala maqedonase blen kohë dhe luan me partitë shqiptare si macja me miun. Edhe diçka. Para se të ulemi e të hartojmë marrëveshje eventuale me maqedonasit, do të duhej të ulemi e të merremi vesh në mes vete. E domosdoshme është të arrihet një marrëveshje në mes partive shqiptare, përpara se të shkohet me hapa të mëtutjeshëm. Përderisa secila trembet prej tjetrës se mos po ia fut thikën pas shpine, atëherë përse vallë e mashtrojmë vetveten?!

Edhe prefekti i Gostivarit, Rufi Osmani, ka folur për domosdoshmërinë e ndryshimit të kushtetutës, ndërsa nga ana tjetër BDK e Hisni Shaqirit ka paralajmëruar protesta. Atë e ka mbështetur PPD e Sefedin Harunit dhe kryetari i Republikës së Iliridës

Nevzad Halili. Ata janë të mendimit se duhet të fillohet me këtë formë të shprehjes së pakënaqësisë ndaj padrejtësive të panumërta, si dhe gjendjes së rëndë të shqiptarëve. Sa do të jetë efekti i tyre, mbetet të shihet në të ardhmen, ndonëse edhe optimisti më i madh në këtë rast duhet të jetë pesimist. Ajo që dihet është se qeveria aktuale, gjegjësisht kryeministri Gruevski, e ka drejtuar politikën e tij populiste jo vetëm kundër shqiptarëve përbrenda, por edhe në politikën e jashtme. Rasti më i freskët përbrenda është rasti i Sopotit II, ku u dënuan gjashtë sopotas me 104 vjet burg për shkak të gjoja vënies së një mine në afërsi të fshatit të tyre në mars të vitit 2003, ku gjetën vdekjen dy ushtarë polakë të NATO-s. Të indinjuar me këto dënime drakonike, sopotasit kanë bllokuar selinë e BDI-së, ku kërkojnë prej funksionarëve të kësaj partie të gjejnë ndonjë zgjidhje për ta, ose ta lëshojnë qeverinë. Nga ana tjetër, rasti më i freskët në politikën e jashtme është injorimi i dyfishtë (mosftesa gjatë inaugurimit dhe kthimi i ftesës zyrtare në private) nga ana e presidentit të Re-

publikës së Maqedonisë ndaj homologut kosovar.

Ky sinkronizim i injorimit dhe degradimit të vazhdueshëm të shqiptarëve jashtë e brenda kufijve, tregon mirëfilli se maqedonasit e manifestojnë krizën e tyre të identitetit me frustracione të mekanizmave të projeksionit, sipas stilit: 'mos paç çfarë t'i bësh gomarit, mëshoj samarit'.

Megjithëkëtë, pushteti i Shkupit është gjithnjë e më shumë nën presionin ndërkombëtar për ta ndryshuar emrin. Vonesë mund të ketë, por shpëtim jo. Emri duhet ndryshuar gjithqysh. Kur kthehem pak në retrospektivë, kujtoj se shteti maqedonas u ka ndryshuar shumë shqiptarëve mbiemrat dhe toponimet. Selimi u bë Selimovski, Demiri u bë Demirev, Rrahmani - Rrahmanov, Shkupi u bë edhe shqip Skopje, fshati Çerkez - Çerkesko, e kështu me radhë. Unë sot e kësaj dite në dokumente zyrtare e kam mbiemrin Avdiji. Tashmë kur Shkupi zyrtar gjendet pisk dhe e kuptoj seriozisht rrethanën e vështirë në të cilën ndodhet, me 'keqardhje' më duhet të them: "Maqedoninë e zuri haku im".

Në Kosovë edhe pse ka ligj kundër duhanit, ai mund të pihet kudo

# Duhani vret

Dita Ndërkombëtare Kundër Duhanit e gjen Kosovën me rreth 600 mijë duhanxhinj, apo çdo i pesti person llogaritet të jetë duhanpirës

**N**ë botanikë duhani njihet me emrin *Nicotiana tabacum* L. Është bimë me lule të bukura, prandaj përdoret edhe si bimë zbukuruese. Duhan është fjalë arabe, që do të thotë tym. Fjala cigare rrjedh nga gjuha spanjolle cigarro, me të cilën shënohen fletët e mbështjella të duhanit. Francezët plasuan fjalën cigarette (cigare e vogël) me të cilën kuptohet duhan i grimtuar i mbështjell me letër të hollë. Sot kjo formë e konsumimit të duhanit është më e shpeshta.

Duhani mund të përtypet, nuhatet apo të konsumohet me çibuk (llullë). Të gjitha format janë të rrezikshme për shëndetin. Filtrat e ndryshëm e zvogëlojnë përqindjen e nikotinës dhe të katanit në tymin e cigares, por e rrisin përqindjen e monoksidit të karbonit deri në 30%.

## Çdo vit, në botë, nga konsumimi i duhanit vdesin rreth 5 milionë njerëz

Studimet shkencore dëshmojnë lidhjen e ngushtë mes të pirjes së duhanit dhe disa sëmundjeve. Ata që e pinë duhanin sëmuren më shpesh nga kanceri, sëmundjet e sistemit kardiovaskular, sëmundjet kronike obstruktive të mushkërive e shumë sëmundje të tjera.

"T'i grisim reklamat e duhanit!" – ishte motoja e sivjetme e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në Ditën Ndërkombëtare Kundër Duhanit.



Mevlude ZEJNULLAHU

Lista e pasojave dhe të këqija të duhanit është shumë e gjatë dhe e mjaftueshme për çdo individ apo shoqëri që t'i shpallë luftë pirjes së duhanit.

Sipas hulumtimeve, nga duhani çdo vit, në botë, vdesin rreth 5 milionë njerëz.

Dita Ndërkombëtare Kundër Duhanit e gjen Kosovën me rreth 600 mijë duhanxhinj, apo çdo i pesti person llogaritet të jetë duhanpirës.

Parlamenti i Kosovës e ka miratuar ligjin për duhanin qysh në vitin 2005 dhe ai ka hyrë në fuqi në janar të 2007-s. Mirëpo, pikërisht më 31 maj, ditën kundër duhanit, ministri i shëndetësisë Alush Gashi, kërkoi që ligjit t'i bëhen disa ndryshime të nevojshme në mënyrë që të bëhet më i lehtë zbatimi i tij.

Me disa nisma organizatash joqeveritare në Prishtinë është shënuar Dita Ndërkombëtare Kundër Duhanit. Në



Kosovë duhani shitet kudo dhe ai blihet nga mosha të ndryshme. Përdorimi dhe reklamimi tij bëhet kudo. Është shqetësuese se duhani pihet edhe në shkolla, nëpër institucionet e arsimit, institucionet shëndetësore dhe në institucione të tjera publike.



### Aktivite kundër pirjes së duhanit edhe në Kosovë

Pikërisht në këtë ditë, me qëllim të informimit të popullatës për pasojat e duhanit, Klubi i Rinisë i Kryqit të Kuq të Kosovës ka shpërndarë molla në këmbim të një, dy apo me shumë cigareve nga përdoruesit e duhanit. Ata kanë vendosur që në disa pjesë të kryeqyteti të shpërndajnë molla falas.

Po ashtu, me rastin e 31 majit, ditës ndërkombëtare kundër duhanit, në Bibliotekën Kombëtare Universitare të Prishtinës, organizuar nga Parlamenti Studentor në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Islame, u mbajt një tribunë ku para të pranishmëve folën sociologu Fadil Maloku, teologu Lulzim Esati dhe dr. Ali Iljazi. Nga të gjithë u theksua nevoja që institucionet dhe organizatat e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare të Kosovës të bëjnë më shumë për vetëdijesimin e qytetarëve, e sidomos rinisë tonë, që t'a kuptojnë dëmin që sjell pirja e duhanit.

Jo vetëm ata që e pinë duhanin, por edhe të tjerët përreth tyre janë të rrezikuar. Pirja pasive e duhanit është fenomen shumë i diskutueshëm. Është vërtetuar se kjo mënyrë e pirjes së duhanit rrezikon shëndetin. Tymi i duhanit futet në mushkëritë e duhanxhiut, por nuk mbetet vetëm aty. Një pjesë patjetër e thithin edhe personat që gjenden aty prezent. Pasoja do të kenë edhe joduhanxhinjtë, natyrisht pa asnjë faj, vetëm se janë të obliguar të jetojnë apo të punojnë afër duhanpirësve. Sigurisht, çdokush ka drejtë të zgjedhë mënyrën e vet të sjelljes, por assesi duke e penguar dhe duke dëmtuar tjetrin.

Ne shpresojmë se Kosova, në një të ardhme të afërt, do ta zbatojë ligjin kundër pirjes së duhanit, e po ashtu inspektorët, që do të duhej të mbikëqyrin zbatimin e ligjit, të shihen më shpesh nëpër rrugët e Kosovës, duke mos lejuar reklamimin e tij. Shpresojmë të merret shembulli i qytetit kanadez Toronto, ku dyqanet që shesin cigare i vendosin ato në rafta që nuk bien në sy.

### Mjafton vetëm dëshira dhe guximi për ta lënë duhanin...

Për të lënë duhanin nevojitet vetëm dëshira dhe guximi për t'i bërë hapat e parë. Duhet filluar me zvogëlimin e numrit të cigareve në ditë. Kur personi i "vjen" dëshira ta nderë cigaren, duhet të hajë pemë ose ëmbëlsirë në vend të saj dhe duhet të merret me më shumë aktivitete të ndryshme sportive. Kështu ai do të fillojë të kuptojë se mundet edhe pa diçka që e dëmton dhe e shpenzon.

Me lënien e duhanit, për disa ditë, do të përmirësohet aftësia e nuhatjes dhe shijes. Një vit pas lënies së duhanit ulet dukshëm rreziku nga infarkti i miokardit, kanceri dhe sëmundja obstruktive e mushkërive. Femrat që pushojnë pirjen e duhanit gjatë shtatzënisë, posaçërisht në muajt e parë, zvogëlojnë rrezikun e lindjes së foshnjës me peshë të vogël. Kur duhani ka shkaktuar dëme të pakthyeshme, si tek emfizema e mushkërive, përfitimet janë më të vogla: zvogëlimi i progresionit të sëmundjes. Jeta do të jetë më kualitative dhe më e gjatë dhe përmirësohet buxheti individual dhe familjar. ■

Në Strugë të Maqedonisë është mbajtur

## Fillon nisima

“Mundësitë e barabarta” bashkojnë institucionet, bizneset, OJQ-të dhe mediet nga të dy anët e lumit Ibër



Florije ADEMI

**D**uke konsideruar se deri më tani qyteti i Mitrovicës i ndarë në dysh nga mbarimi i luftës, sa i përket investimeve është anashkaluar si nga institucionet vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare, përfaqësues institucionesh qendrore që vijnë nga ky qytet, përfaqësues të pushteteve lokale në të dyja anët e Mitrovicës, përfaqësues të shoqërisë civile dhe medieve kanë ndërmarrë nismën “Mitrovicasit për Mitrovicën”.

Në kuadër të kësaj nisme, në Strugë të Maqedonisë është mbajtur konferenca me temën “Mundësitë e barabarta”, në të cilën morën pjesë përfaqësues të qeverisë së Kosovës, institucioneve ndërkombëtare, përfaqësues lokalë të Mitrovicës, organizatave joqeveritare, përfaqësues të bizneseve dhe medieve nga të dy anët e lumit “Ibër”.

### Vazhdimësi e Forumit të Bostonit

Kjo konferencë është vazhdim i Forumit të Bostonit që është mbajtur para disa muajve, ku përveç përfaqësuesve të shoqërisë civile kanë marrë pjesë edhe liderë politikë të dy anëve të qytetit të ndarë të Mitrovicës, të cilët kanë diskutuar për rrugët që mund të shpien në një të ardhme më të mirë për këtë qytet.

Në hapjen e konferencës në Strugë, ministri i administrimit të pushtetit lokal, Sadri Ferati ka thënë se deri më tani Mitrovica është anashkaluar si nga vendorët ashtu edhe nga ndërkombëtarët, por që tani ne duhet t'i bindim ata se me mjete të donatorëve dhe mjete të institucioneve ia vlen të investohet këtu. “Përmes institucioneve, shoqërisë civile dhe medieve të provojmë të dëshmojmë se ne, mitrovicasit, kemi ide për përmirësimin e jetës në këtë qytet. Ka kaluar koha kur njerëzit nuk janë takuar, kur nuk kanë mundur të komunikojnë dhe të shfaqin idetë e tyre” - ka theksuar Ferati.

Shefi i UNDP-së, Maurice Dewulf, e ka vlerësuar këtë si një nismë shumë të mirë, duke premtuar përkrahje. Kjo konferencë është financuar nga Qeveria e Norvegjisë, e cila sipas Dewulfit është e gatshme edhe në të ardhmen të financojë takime të tilla.

konferenca me temën “Mundësitë e barabarta”

# “Mitrovicasit për Mitrovicën”

David Sline, shefi i zyrës civile ndërkombëtare në Mitrovicë (ICO), ka thënë se ne jemi të përkushtuar për të ndërtuar një Mitrovicë të re.

“ICO nuk e fsheh faktin se angazhohet për avancimin e pavarësisë së mbikëqyrrur të Kosovës, futjen e standardeve evropiane, etj.”

Ndërkaq nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Ismajl Smakiqi, ka thënë se mundësitë për të punuar në këtë drejtim janë të mëdha, duke dëshiruar që çdonjëri ta shndërrojë energjinë individuale në energji kolektive pozitive për një Mitrovicë më të mirë, një rajon dhe një botë më të mirë.

“Ideja që unë dhe Ferati e kemi diskutuar në Boston ka qenë që të bashkojmë bizneset të cilat mund të japin ide që do të mund të realizohen në Mitrovicë, me qëllim që këto të lehtësojnë jetën e qytetarëve dhe komunitet të afrohen pa prapavijë politike” – ka thënë udhëheqësi i bordit për komunën e Mitrovicës veriore (administrata e Kombeve të Bashkuara), Dragan Spasojeviq.

Edhe Valdete Idrizi e Aleksandër Stojanoviq, nga shoqëria civile që në fillim kanë shprehur dëshirën e tyre që kjo konferencë të jetë praktike e jo politike.

## Financohen projekte me vlerë deri në 400 mijë euro

Pas diskutimeve të shumta që karakterizuan ditën e parë të konferencës, në ditën e dytë, të gjitha grupet kanë prezantuar idetë e tyre përmes të cilave mendohet të ndryshohet për të mirë Mitrovica.

Bizneset kanë prezantuar para donatorëve, UNDP-së, Komisionit Evropian dhe IOM-it, projekte në vlerë prej mbi 40 milionë euro, ndërkaq shoqëria civile dhe mediet kanë paraqitur idetë e tyre për mundësinë e realizimit të projekteve të

shumta me karakter shumetnik në të gjitha fushat e jetës, nga të cilat do të përfitonte Mitrovica dhe të gjithë qytetarët e saj.

Pas prezantimit të ideve, drejtori i UNDP-së ka premtuar sa për fillim 200 mijë euro për projekte të shoqërisë civile dhe medieve. Ndërsa përfaqësuesja e Komisionit Evropian ka thënë se 1 milion e 700 mijë euro janë donacioni i këtij komisioni për projekte në fushën e ambientit, për fëmijët me aftësi të kufizuara, festivale të fëmijëve etj, duke i ftuar të pranishmit të bëjnë projekte në këto fusha. Ajo ka thënë se çdo projekt i mirë i përbashkët do të ketë mundësi të financohet nga 15 mijë deri në 400 mijë euro.

Sa i përket sektorit të bizneseve, që kërkojnë pa dyshim mjete më të mëdha por që ndikojnë më shumë në zhvillimin ekonomik të Mitrovicës, u tha se në të ardhmen do të mbahet edhe një takim tjetër me shpresë se nga shtatori do të ndërmerren hapa konkretë në këtë drejtim.

Më pas është themeluar një grup i përbërë nga dy përfaqësues të katër fushave, institucioneve, bizneseve, OJQ-ve dhe medieve, katër shqiptarë dhe katër serb, të cilët përveç se do të llobojnë që të investohet në Mitrovicë, ata gjithashtu do të angazhohen që të gjitha investimet të kanalizohen ku dhe si duhet.

Tri javë më parë një takim i tillë por me pjesëmarrje më të vogël është mbajtur në Ohër, i cili ka pasur më tepër karakter informues në lidhje me iniciativën në fjalë.

Ministri Ferati është shprehur i kënaqur me klimën, nivelin e diskutimeve, me idetë që janë prezantuar për të cilat është pritur një kohë e gjatë dhe me zotimin e të gjithë pjesëmarrësve se do të jenë aktivë në proces pa dallime, duke vlerësuar se kjo është një mundësi e mirë që duhet të shfrytëzohet.

## Disa nga konkluzionet e konferencës

- Të krijohet një fond që do të mbështesë idetë e mira që tani po lindin në Mitrovicë për krijimin e vendeve të punës, afrimin e bashkëjetesës dhe një mesazh i mirë që Mitrovica mos të jetë një pikë e zezë si deri më tani;
- Të sigurohet një asistencë teknike dhe që në një afat sa më të shkurtër Mitrovica të ketë lajme të mira për buxhet;
- Që të kenë mbështetje të fuqishme projektet pozitive nga shoqëria civile;
- Fuqizimi i mjeteve të informimit dhe mbështetja e tyre në mënyrë që ato të shkojnë përtej lajmit etj...

Tani, sipas tij, mund të realizohet plotësimi i dëshirave të atyre njerëzve që vazhdimisht kanë shprehur dëshirën e tyre që të jenë qytetarë të barabartë në komunën e Mitrovicës, të kenë kontakte me kolegët e tyre, e që pengesë ka qenë klima në qytet, e sidomos presioni i liderëve nga qasja e politikave ekstreme.

Dragan Spasojeviq, e konsideron si shumë të rëndësishëm ekzistimin e vullnetit të mirë të pjesëmarrësve, ku njerëzit do ta kenë një qasje të veçantë për zgjidhjen e problemeve, duke qenë sa më praktik sidomos në çështjet që i mendojnë ata e që janë: qarkullimi i lirë, siguria fizike, siguria ekonomike, etj.

Ndonëse sipas tij dallimet ndërmjet këtyre dy komuniteteve dihen, nëse të gjithë do të jenë të sinqertë në këtë proces, ai është i sigurt se çështjet e trajtuara, si investimet në infrastrukturë, zhvillim ekonomik, etj., kanë mundësi të implementohen në praktikë, duke përmirësuar jetën në këtë qytet.

Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Ismajl Smakiqi, konferencën e ka vlerësuar si një iniciativë shpresë për gjetjen e interesave të përbashkëta të njerëzve që jetojnë në Mitrovicë, sidomos projekteve konkrete të cilat me përkrahjen e të gjithëve do të kenë një kuptim shumë më të madh edhe te donatorët për përkrahje. ■



Sfidat e një procesi zgjedhor

# A jemi të aftë të organizojmë dhe m...



Sabri HALILI

Një kohë të gjatë në media dhe në forume opozita kërkon zgjedhje, konform Pakos së Ahtisarit. Pozita, këtë aktivitet demokratik, e shikon vetëm nga pozita kushtetuese dhe ligjore e Kosovës. Në këtë aspekt, në horizontin politik shihet një partneritet madje gati armiqësor ndërmjet dy blloqeve politike dhe dy perceptimeve lidhur me zgjedhjet. Në këtë partneritet opinionit ata i pasqyrojnë akuza, dyshime dhe mosbesime, gjegjësisht shfaqin drojën, sidomos blloku opozitar, për mundësinë e manipulimit të zgjedhjeve nga partitë në pozitë. Mu për këtë, opozita ka kërkuar që këto zgjedhje të organizohen, të menaxhohen, të monitorohen dhe të certifikohen nga OSBE-ja. Kjo kërkesë të lë të kuptosh se gjendja e përgjithshme që mbretëron në relacionet ndërpartiake, e që afekton edhe në raportet ndërnjerëzore, në konfiguracionin politik të Kosovës, por edhe më gjerë, është mjaftë alarmante, e që në periudhën zgjedhore mund të jetë edhe më e rëndë.

Është për keqardhje ky mosbesim i hapur në aftësitë e vendësve për menaxhimin e procesit zgjedhor, që pasqyrohet nga një bllok politik. Por edhe më dëshpërues është fakti se nga të gjitha blloqet politike u jepet besimi blanko të huajve, në çdo fushë të jetës në Kosovë.

## Kompetencat e qarta të vendorëve...

Çuditërisht, opozita thërret haptas për shkeljen e Kushtetutës së Kosovës dhe të ligjeve, duke kërkuar që të tjerët të menaxhojnë procesin zgjedhor, i cili me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 65.1 dhe me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 59.2 dhe 64, i aprovuar nga qershori i vitit 2008, është ekskluzivisht kompetencë e institucioneve vendore.

Është befasesh edhe një aspekt tjetër në këtë insistim. Kjo arsyetohet me një

zgjidhje apo kërkesë nga Pakoja e Ahtisarit, ku kërkohet që procesi zgjedhor të menaxhohet "nga një mision relevant ndërkombëtar". Të njëjtët e dinë se organizimi i zgjedhjeve lokale bëhet në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për çka të gjitha partitë tashmë janë dakorduar.

Blloku tjetër politik e quan këtë kërkesë të opozitës si servilitet politik, duke rrahur gjoks për ekzistimin e normave vendore, me të cilat përcaktohet kompetenca e qartë e institucioneve vendore për menaxhimin dhe certifikimin e zgjedhjeve. Megjithatë, edhe këta, fjalët dhe veprimet nuk i kanë të njëjta. Pas fjalëve të tyre, fshihet një dukuri që është e përhapur si një virus gati në të gjitha institucionet e Kosovës - dukuria e ser-

vilizmit të fshehur në raport me të huajt, qoftë ata nga Afrika, nga Azia, Evropa...

Mjerisht, këtë dukuri, sidomos përfaqësues të partive politike në KQZ, asnjëherë nuk e kanë shfaqur haptas. Por gjendja në KQZ, në Sekretariatit e KQZ-së dhe qëndrimi nën hije i stafit vendor të OSBE-së dhe kompetencat ekskluzive dhe reale, që ata i kanë për Listën Votuese, edhe pse antikushtetuese dhe antiligjore, tregon se situata në këtë institucion është edhe më e mjegulluar dhe flet për një pasiguri të vendësve për organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve. Pra, kjo gjendje është edhe më serioze se sa që e paraqesin partitë politike në opinion. Nga lista votuese afektojnë edhe shumë operacione të tjera



# Menaxhojmë zgjedhjet?

zgjedhore, si: operacioni i votimit me postë, votimi me nevoja të veçanta, etj., të cilat, ligjërisht, asnjëherë nuk kanë kaluar tek institucionet vendore. Më e keqja është se KQZ asnjëherë nuk është marrë deri tashti më seriozisht me këtë çështje kruciale, përkundër faktit se neni 7 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, e rregullon qartë kompetencën e KQZ-së për këto operacione zgjedhore dhe për këtë proces zgjedhor.

## Pse partitë politike nuk e dinë gjendjen reale në KQZ?

Se sa e njohin partitë politike gjendjen reale në KQZ, nuk është edhe aq e qartë, edhe pse mund të paragjykoher se ato nuk e njohin. Për të dëshmuar këtë do e ilustruam me një shembull shumë të freskët. Kohë më parë, një udhëheqës i lartë i një partie politike të pozitës, deklaroi: "Kosova i ka institucionet e konsoliduara të cilat kanë mundësi të bëjnë organizimin e duhur të zgjedhjeve të sivejme lokale". Por, për të dhënë një konstatim të tillë zyrtarët partiak duhet ditur se OSBE-ja, vetëm për Listën Votuese, në zgjedhjet e vitit 2004 kishte mbi 25 zyrtarë, ndërsa krejt Sekretariati i KQZ-së ka pak më shumë se 20 zyrtarë. Vallë, a e di ky zyrtar dhe të tjerët, se zyrtari që duhet të menaxhojë, azhurnojë dhe organizojë listën votuese, duhet që të trajnohet së paku disa vjet, për të arritur që ta kryejë këtë punë me sukses, në periudhën zgjedhore?

Për këtë partitë politike i kanë anëtarët e tyre në KQZ dhe me siguri se ndonjëherë u kanë treguar se kjo çështje nuk është bërë asnjëherë, sepse ata nuk e kanë bërë punën për interesa të përgjithshme, madje në disa raste as për interesin e partive të tyre, por kanë bërë punën e djallit!

Dhe, po të ishte çdo gjë në rregull në këtë shoqëri, partitë politike duhej t'i pyesin anëtarët e tyre në KQZ, se cili është sukcesi i tyre i deritashëm në KQZ? Së paku një sukses në ngritjen dhe konsolidimin e këtij institucioni shumë të rëndësishëm për demokracinë e brishtë të Kosovës. Për të qenë çdo gjë në rregull me këtë institucion do të duhej që të kishim një KQZ të fuqishme, një KQZ të

konsoliduar, profesional dhe me kompetenca të plota për organizimin e zgjedhjeve. Tashti për këtë nuk mund të themi se është ashtu. Përkundrazi. Megjithatë, eteri dhe letra duron gjithçka, e mund të shkruajmë e të flasim kot, sa për ta mashtruar vetveten dhe opinionin.

Zyrtarët e painformuar partiakë thonë se OSBE-ja duhet të jetë vetëm vëzhguese në këtë proces, sepse "ne i kemi institucionet tona...". Por, ata nuk e dinë se edhe më tej njerëz nga OSBE-ja e udhëheqin, nën hije, KQZ-në dhe Sekretariatin. Kjo e argumenton të kundërtën nga ajo çka flasin zyrtarët e partive politike, të cilët nuk e dinë se ç'kanë as në oborrin e vet, e lëre më larg.

## Lista Votuese dhe refleksionet në procesin zgjedhor

Lista Votuese është boshti kurrizor i çdo procesi zgjedhor. Shihet qartë se partitë politike nuk e dinë se si është gjendja as në këtë segment aq të rëndësishëm, e sigurisht nuk e di as opinioni i gjerë. E vërteta është se Lista Votuese ende mbahet, menaxhohet dhe pas-trohet nga OSBE. Këtë e di Ministria e Punëve të Brendshme, këtë e dinë, ose duhet ta dinë edhe përfaqësuesit e partive politike në KQZ, të cilët deri tashti nuk kanë bërë asgjë që ta përgatisin stafin vendor, të krijojnë kushte për bartjen e kësaj kompetence në stafin vendor, ashtu siç e kërkon edhe ligji, që nga qershori i vitit 2008. OSBE-ja, me listën votuese, i ka në dorë të gjitha operacionet zgjedhore, me përjashtim të koordinimit në terren dhe certifikimin e partive politike.

Nga kjo gjendje aktuale në KQZ është e qartë se ka një mosnjohje totale, apo neglizhencë, së pari të anëtarëve të KQZ-së, sa i përket faktit se çka është në të vërtetë lista votuese. Shumë prej tyre mendojnë se lista votuese është Regjistri Civil. Dhe, pasi që ky është në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, "atë e marrim kur të na duhet". Edhe këtu pasqyrohet neglizhenca dhe injoranca profesionale e anëtarëve të KQZ-së. Por, ua përkujtoj se Lista Votuese është vetëm ekstrakt i Regjistrimit Civil, ndërsa procesi i finalizimit të

**Gjendja në KQZ, në Sekretariatit e KQZ-së dhe qëndrimi nën hije i stafit vendor të OSBE-së dhe kompetencat ekskluzive dhe reale, që ata i kanë për Listën Votuese, edhe pse antikushtetuese dhe antiligjore, tregon se situata në këtë institucion, është mjaft e mjegulluar dhe flet për një pasiguri të vendësve për organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve. Nga lista votuese afektojnë edhe shumë operacione të tjera zgjedhore, si: operacioni i votimit me postë, votimi me nevoja të veçanta, etj**

listës votuese është një proces i gjatë e i mundimshëm, në të cilin ndërtohen njohuri të larta profesionale në lëmin e teknologjisë informative dhe në bazën e të dhënave. Paraprakisht, për këtë proces duhet përgatitur një, ose më shumë persona, të cilët në periudhat operacionale do të jenë të gatshëm të përballen me sfidat që janë të shumta dhe tepër të mëdha.

Ditë më parë, Presidenti i Kosovës tha se do të kërkojë nga partitë politike që të bëjnë pastrimin e listës votuese nga personat e vdekur dhe të tjerë. Edhe këtu shihet se Presidenti i Kosovës ende nuk e ka të qartë situatën në terren, sepse nuk është i informuar në mënyrë të duhur për këtë gjendje vicioze që e ka përcjell këtë segment, që nga zgjedhjet e dyta në Kosovë dhe asnjëherë nuk është vepruar në masë të duhur dhe në mënyrë të duhur, nga zyrtarë të duhur, për ndryshimin e kësaj situatë. Më e keqja është se anëtarët e KQZ-së nuk kanë bërë gjithë të mundurën, për ta zgjidhur këtë lëmsh, të cilin e kanë krijuar pikërisht ata, ndaj të cilëve këta anëtarë të KQZ-së, gjithnjë kanë shprehur në heshtje një servilitet të paparë.

Se në këtë segment nuk është bërë ajo që është dashur të bëhet, flet qartë edhe raporti i OSBE-së me seli në Vjenë, i vitit 2007, ku kritikohet misioni i saj në Kosovë, se ka bërë shumë pak në ngritjen e kapaciteteve vendore për organizimin e zgjedhjeve. Nuk e di nëse këtë raport ua kanë dhënë për ta lexuar padronët e tyre nga OSBE-ja, anëtarëve të KQZ-së, edhe pse është dashur. Edhe kjo e arsyeton gjithë atë që u tha më lart, apo jo? ■

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

# Dy rezoluta dhe dy njohje gjatë muajit maj

Demir RESHITI

**P**ranimi në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka bërë që Kosova të vazhdojë të jetë e pranishme në agjendën e qendrave më të rëndësishme ndërkombëtare të vendimmarrjes. Bordi Ekzekutiv i FMN-së, duke certifikuar votën e bordit të guvernatorëve, i ka ofruar edhe zyrtarisht Kosovës anëtarësimin në këtë organizatë.

Gjatë muajit maj, edhe dy vende të tjera (Unioni i Komoreve dhe Mbretëria e Bahreinit) e kanë bërë publike njohjen e Republikës së Kosovës, duke e çuar në 60 numrin e vendeve që tashmë e kanë njohur pavarësinë e saj.

Një ngjarje e rëndësishme që ka reflektuar pozitivisht për Kosovën, gjatë muajit maj, është miratimi në mënyrë unanime i një rezolute për Kosovën nga 57 vende anëtare të Konferencës Islamike. Kjo rezolutë e hartuar nga qeveria e Shqipërisë, është miratuar në sesionin e 36-të të organizatës së Konferencës Islamike, që është mbajtur në Damask të Libisë...

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit maj 2009.

## (4 maj) Internacionalja Liberale miraton rezolutë për Kosovën

**Vankuver** - Komiteti Ekzekutiv i Internacionales Liberale, i cili ka zhvilluar punimet në Vankuver të Kanadasë, ka aprovuar njëzëri një rezolutë për Kosovën. Nëpërmjet kësaj rezolute, të paraqitur nga PLK-ja, apelohet te vendet të cilat ende hezitojnë ta njohin pavarësinë e Kosovës që ta dinamizojnë këtë proces i cili është legjitim dhe i pakthyeshem si dhe faktor kyç për paqen dhe stabilitetin në rajon.



Miroslav Lajcak

(5 maj) Lajcak: Sllovakia nuk ndryshon qëndrimin ndaj Kosovës

**Bratislavë** - Ministri i jashtëm, Miroslav Lajcak, ka thënë se qëndrimi i Sllovakisë ndaj pavarësisë së Kosovës, nuk do të ndryshojë. "Kjo nuk është çështje e asaj apo e kësaj qeverie. Ekziston qëndrimi i parlamentit, që shpreh mendimin e gjithë spektrit politik, me përjashtim të koalicionit të hungarezëve" - i ka deklaruar ministri Lajcak, gazetës Pravda.



GJND

(6 maj) Kosachev: GJND-ja do të duhej të shpallte të paligjshme pavarësinë e Kosovës

**Bruksel** - Shefi i delegacioni rus në Këshillin e Evropës, Konstantin Kosachev, ka deklaruar se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë do të duhej ta shpallte të paligjshme pavarësinë e Kosovës. Kosachov ka vlerësuar se "ekziston mundësia që Gjykata Ndërkombëtare sërish të fillojë të luajë lojëra politike dhe të sjellë vendime që nuk kanë bazë ligjore"

(7 maj) Sllovenia ka dorëzuar në GJND mendimin në mbështetje të pavarësisë së Kosovës

**Lubjanë** - Sllovenia konfirmoi se i ka dorëzuar Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës (GJND) mendimin për mbështetjen e pavarësisë së Kosovës. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Sllovenisë ka thënë për mediet sllovene se Sllovenia ka vepruar kështu në harmoni me vendimin për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

(9 maj) Fondi Monetar Ndërkombëtar zyrtarizon anëtarësimin e Kosovës

**Uashington** - Fondi Monetar Ndërkombëtar ka njoftuar mbi pranimin e Kosovës në këtë institucion financiar ndërkombëtar, duke i ofruar edhe zyrtarisht anëtarësimin. Këtë e ka konfirmuar



Fondi Monetar Ndërkombëtar

në një kumtesë të dhënë mbrëmë Bordi i Ekzekutiv i Fondit i cili ka certifikuar votën e bordit të guvernatorëve. Kumtesa e FMN-së theksonte më tej se Kosova do të bëhet zyrtarisht anëtare atëherë kur përfaqësuesi i saj do të nënshkruajë nenet e marrëveshjes në Uashington, ku gjendet edhe selia e FMN-së.

(12 maj) Margallo: Në një moment është shqyrtuar edhe mundësia e njohjes së pavarësisë së Kosovës

**Madrid** - Spanja ka investuar në të arriturat në Kosovë dhe do të vazhdojë të kontribuojë për zhvillimin e saj. Këtë do ta bëjë pavarësisht se nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës - ka thënë për radio Kosovën anëtari spanjoll i Parlamentit Evropian, Hose Manuel Garcia Margallo.

(13 maj) Thompson: BE - aleati i domosdoshëm për shtetin e Kosovës

**Prishtinë** - Kosova duhet të shohë si aleat kryesor të saj BE-në, ndërsa SHBA-ja duhet të vazhdojë mbështetjen ushtarake dhe diplomatike për Kosovën shtet. Nuk ka rrezik që Kosova të shndërrohet në shtet të dështuar, por leadershipit të Kosovës i duhet shumë durim dhe angazhim për zgjidhjen e problemeve në vendosjen e autoritetit në pjesën veriore të vendit - ka thënë në një intervistë për Radio Kosovën, eksperti i amerikan për çështje evropiane, Wayne C. Thompson.

(15 maj) Mesiq: Pavarësia e Kosovës është realitet

**Pragë** - Shpallja e pavarësisë së Kosovës është realitet dhe, Serbia nëse nuk do, mund të mos e njohë, "por duhet të mundësojë komunikimin e njerëzve dhe qarkullimin e kapitalit, që edhe kjo pjesë të funksionojë si pjesët e tjera të Evropës" - i ka thënë radios Evropa e Lirë, presidenti i Kroacisë, Stipe Mesiq.



Unioni i Komoreve

### (19 maj) Unioni i Komoreve njeh Republikën e Kosovës

**Moroni** - Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës ka marrë konfirmim zyrtar për njohje nga Unioni i Komoreve. Unioni i Komoreve është vendi i 59 që e ka njohur Kosovën. Është shtet islamik ishullor që gjendet në Oqeanin Indian, dhe kufizohet nga ujërat e Mozambikut dhe Madagaskarit. Kryeqyteti i saj është Moroni, ndërsaq përbëhet prej tre ishujve me sipërfaqe mbi 1.862 kilometra katror dhe popullatë prej 800 mijë banorë.



Mbretëria e Bahreinit

### (20 maj) Mbretëria e Bahreinit njohu shtetin e Kosovës

**Manama** - Është konfirmuar edhe një njohje tjetër e pavarësisë së vendit tonë. Mbretëria e Bahreinit ka bërë publike njohjen e Republikës së Kosovës shtet, duke rritur numrin e vendeve që tashmë e kanë njohur pavarësinë në 60-të. Në një deklaratë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të këtij vendi thuhet se "Mbretëria e Bahreinit njofton se njeh Republikën e Kosovës shtet të pavarur". Mbretëria e Bahreinit, e cila e ka fituar pavarësinë në vitin 1971, është ishull në gjirin Persik. Në përfundim, Mbretëria e Bahreinit kufizohet me Arabinë Saudite, ndërsa në jug me Katarin.

### (21 maj) AFP: Biden është pritur si një hero

**Paris** - Vizita e nënpresidentit ameri-

kan Joseph Biden është përcjellë me interesim edhe nga shumë media botërore. Shumica nga këto media fokus të veçantë i kanë kushtuar pritis madhështore që i është bërë Biden-it në Kosovë. 'Është pritur si një hero' – është vlerësimi i Agjencisë Franceze të Lajmeve – AFP e cila ka theksuar se mijëra qytetarë me flamuj të Kosovës dhe SHBA-së kishin dalë në kolonë për të pritur nënpresidentin amerikan.

### (22 maj) Petersen: Biden ka përcaktuar se si të sillet Serbia ndaj Kosovës

**Londër** – Ish-shefi i misionit të OKB-së në Kosovë, Soren Jessen Petersen ka thënë se nënpresidenti amerikan Joseph Biden ka përcaktuar "një vijë të qartë të kuqe" se si duhet të sillet Serbia në raport me Kosovën. Në një intervistë për BBC-në, Petersen ka thënë se Biden ka lënë të kuptohet se pret nga Serbia që të ndalojë minimin e pavarësisë së Kosovës. Sipas tij, administrata e Obamës e pranon se Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, por në anën tjetër Serbia duhet ta pranojë interesin legjitim të SHBA-së, se ato qëndrojnë fuqishëm prapa pavarësisë së Kosovës.



### (24 maj) Die Welt: Rusia zbut qëndrimin ndaj Kosovës

**Berlin** - Pas një viti bojkot, Rusia është kthyer në ulëset e Grupit të Kontaktit për Ballkanin. Diplomati perëndimorë janë të bindur se rikthimi i Rusisë është tregues se ajo ka ndryshuar qëndrimin ndaj Kosovës. Në shenjë revolte ndaj shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Rusia kishte braktisur ulësen në këtë grup. Diplomati perëndimorë janë të bindur se kthimi i Rusisë tregon se ajo ka hequr dorë nga kundërshtimi i ashpër i politikës së perëndimit për Ballkanin. "Në qarqet e diplomacisë evropiane thuhet se kthimi i Federatës Ruse në ulësen e Grupit të Kontaktit, është një

tregues se ngatërresat që janë paraqitur për Kosovën, Moska dëshiron t'i vendosë në sirtarë dhe të mos merret me to dhe të ndërtojë përsëri bashkëpunim konstruktiv me perëndimin" – thuhet në një artikull të gazetës gjermane Die Welt.

### (25 maj) Konferenca Islamike miraton rezolutën për Kosovën

**Damask** - 57 vende anëtare të Konferencës Islamike në sesionin e 36-të, të mbajtur në Damask të Libisë, kanë miratuar në mënyrë unanime rezolutën për Kosovën, e cila është hartuar nga qeveria e Shqipërisë. Ministri i jashtëm i Shqipërisë, Lulëzim Basha, e cilëson miratimin e saj si lajm të jashtëzakonshëm për Kosovën. Ai ka shprehur bindjen se pas miratimit të kësaj rezolute shumë shpejt pritet një bum i njohjeve të reja.

Për herë të parë në mënyrë të tërthortë, por të qartë, dhe me unanimitet të plotë, Organizata e Konferencës Islamike mbështet Republikën e Kosovës.

### (28 maj) Christopher Dell emërohet ambasador i ri i SHBA-së në Kosovë

**Uashington** - Diplomati amerikan Christopher Dell do të jetë ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë. Lajmi është njoftuar nga Shtëpia e Bardhë në Uashington. Ambasadori Dell do të zëvendësojë ambasadorin e deritashme Tina Kaidanov.

### (29 maj) Miratohet vazhdimi i pranisë së trupave gjermane në Kosovë

**Berlin** – Parlamenti gjerman ka miratuar vazhdimin e pranisë së trupave gjermane në Kosovë për periudhën e ardhshme 12 mujore – njofton agjencia e lajmeve DPA. Deputetët, të cilët votuan për vazhdimin e mandatit, kanë thënë se situata në Kosovë, ndonëse është stabilizuar, është ende shumë e brishtë për të tërhequr trupat.

### (30 maj) Martak: Çekia nuk do t'i reduktojë trupat në Kosovë

**Pragë** - Republika e Çekisë nuk planifikon që vitin e ardhshëm ta zvogëlojë numrin e ushtarëve të vet në Kosovë – ka deklaruar ministri i Mbrojtjes i këtij shteti, Martin Bartak. "Brenda dy javësh ministrat e NATO-s do të takohen dhe do të vendosin për zvogëlimin gradual të njësiteve të KFOR-it" – ka thënë Bartak, duke shtuar se planifikohet që numri i ushtarëve nga 33 vende të reduktohet në 10 mijë trupa. ■

Histori Islame (31)

# Çlirimi Egjiptit dhe vrasja e Omerit r.a.



Muhamed J. KAJOLLI

**S**iç theksuam në numrat e kaluar, prijësi i besimtarëve Omeri r.a., në saje të pjesëmarrjes së tij në shumë beteja, kishte përfituar një përvojë të madhe ushtarake. Njëkohësisht qëndrimi i tij i gjatë me Pejgamberin s.a.v.s dhe me Ebu Bekrin e kishin bërë një politikan të shkëlqyer.

Përveç çlirimit të Kudsit (Jerusalem) dhe Shamit me qendër Damaskun prej territoreve të Bizantit dhe çlirimin e të gjitha tokave të perandorisë perse, përfshirë këtu Armeninë, Azerbajxhanin, Taxhikistanin e Afganistanin, Omeri sikur e pa të nevojshme që të pushonte pak dhe të mos merrte ekspedita për zgjerimin e mëtutjeshëm të territoreve të reja. Shkak i këtij vendimi ishte frika. Ai sikur vërejti një bumerang të mundshëm të këtyre sukseseve.

Pas marrjes së Kudsit – qytetit të shenjtë të krishterëve dhe të çifutëve, ai sikur po ndiente një çlirim të brendshëm, sepse kishte futur në dorë një hapësirë të gjerë të territoreve bizantine, të cilat gjeografikisht e kishin ndarë në dy pjesë perandorinë e stërmadhe të Bizantit. Lidhjet e Aleksandrisë dhe Kostandinopojës tani e tutje do të bëheshin vetëm me anë të detit.

Mirëpo, ndërsa Omeri r.a. gjendej në një takim (në Konferencën e quajtur Konferenca e Xhabijes), ishte takuar atje me Amër Ibn Asin. Ai i ishte lutur gjatë që Kalifi ta aprovonte kërkesën e tij që ushtria e tij të vazhdonte marshimin për në Egjipt. Ai i kishte treguar për çdo detaj të situatës së Egjiptit, dhe vlerësimi i tij ishte se muslimanët do të korrnin fitore të madhe me një ushtri shumë të vogël.

Pas shumë përpjekjeve, Amri kishte arritur që ta bindte Omerin r.a, por, ai i kujtoi atij se kjo leje nuk do të thoshte se ishte përfundimtare: “Do të të dërgoj një letër. Nëse e merr dhe urdhërohesh që të largohesh nga Egjipti para se të kesh hyrë atje kthehu, e po që se je futur, vazhdo përpara dhe lutju All-llahut të

*“O All-llah, jam plakur e dobësuar dhe ata për të cilët duhet të kujdesem janë shtuar, ndaj ma merr shpirtin pa ua humbur të drejtat e pa e tepruar.”*  
(Omeri r.a., Emiri i besimtarëve)

Lartëmadhëruar të të ndihmojë” (Hasan Ejub: f. 136) Amri ishte nisur nga qyteti bregdetar Kajsarije, i cili është larg Kudsit rreth 60 km në veri perëndim. Ushtria e tij nuk numëronte më shumë se 3500 forca.

Nga ky qytet ishte nisur në vitin 18 hixhri, ose 639 gregorian. Rrugëtimi i tij për në Egjipt ishte i tëri bregdetar. Pra, nga Kajsarije kishte shkuar në Jafa, Askalan, Gaza, Rafah dhe Arish. Në lidhje me dërgimin e letrës së Omerit ka spekulime të ndryshme. Thuhet se letra e tij i kishte shkuar derisa ushtria e Amrit paska qenë në Rafah, ndërsa në dorë i paska ra ndërkohë që ushtria e tij paska arritur në Arish. Distanca midis këtyre dy qyteteve është mbi 100 km!? Sido që të kishte ndodhur, Amri ishte futur në Egjipt. Arishi edhe sot është vija ndarëse midis Egjiptit dhe Shamit (Lindjes së Mesme të atëhershme).

Ushtria e Amrit arriti deri në Farma (ose Pelusium sipas gjuhës romake), një qytezë e cila kishte një port detar të vogël. Deri këtu, ushtria e Amrit nuk hasi në asnjë rezistencë. Ndërsa kjo distancë nga Kajsarije mund të ketë rreth 250 kilometra. Prej këtij qyteti, ushtria e Amrit iu drejtua jugut. Mbase strategjia e tij ka qenë që t'i shmangej rezistencës së mundshme të ushtrisë egjiptiane (romake) afër Aleksandrisë. Për herë të parë, pas afro 600 km rrugëtim, ushtria e Amrit tako-

het me ushtrinë e një garnizoni të vogël romak në qytetin Balbis, të cilën e komandonte Arteoni. Nga ky qytet fillon delta e lumit më të gjatë në botë, Nilit. Ky garnizon nuk arriti t'i rezistojë gjatë ushtrisë së Amrit dhe u dorëzua.

Egjipti në këtë kohë ishte shtet vasal romak dhe siç është e njohur për studiuesit fetarë krishterimi ishte ndarë në shumë sekte të mëdha. Disa mendonin se Krishti ishte vetë Zoti, disa mendonin se ishte biri i Zotit, ndërsa të tjerë mendonin se ishte qenie njerëzore sikurse të gjithë të tjerët. Egjiptianët mendonin ndryshe nga qendra për pozitën e Krishtit në shoqëri, prandaj edhe raportet me Kostandinopojën nuk ishin të kënaqshme.

Për këtë arsye Herakli kishte dërguar patriarkun Cyrus-in, për njeriun e parë fetar në Egjipt, origjina e të cilit ishte nga Palestina. Ndërsa ndër egjiptianët, Mukavkisi ishte njeriu i respektuar dhe i dëgjohej fjala. Ai ishte me origjinë nga Dumjati, qytet afër Kajros. Mukavkisi, përveç kredos së tij që gëzonte tek populli kopt, respektohej edhe për shkak të dy vëllezërve të tij fetarë të cilit shërbenin në Aleksandri. Këto të dhëna na bëjnë të mësojmë se Muhammedi s.a.v.s ka pasur informacion të saktë se, cili ishte ose cili do të duhej të ishte i pari i Egjiptit.

Kur ai po ju dërgonte mesazhet e tij mbretërve të botës, popullit të Egjiptit i ishte drejtuar përmes Mukavkisit, të



Xhamia e Amr bin al As-it në Kajro

cilin e kishte quajtur “Të madhit të Koptëve”. E nuk i kishte shkruar të madhit të Egjiptit, sepse në këtë rast në mesazhet e tij do të kishim emrin e Cyrus-it.

Pas futjes së ushtrisë muslimane dhe çlirimit të Egjiptit, Mukavkisi do të bëhej personi i cili do t'i prezantonte kërkesat e popullit, sepse Cyrus-i nuk kishte më vlerë. Kur ushtria arriti në vendin e quajtur Babilon, Amri vërejtë se ushtria e tij ishte shumë më e vogël përballë asaj romake, prandaj dërgoi urgjentisht korrierët e tij për në Medinë tek Kalifi. Ai kërkoi nga Omeri r.a. përforsime dhe Omeri i dërgoi menjëherë katërmijë ushtarë të tjerë. Tani me këtë numër ushtarësh, ai arriti që ta thyente ushtrinë romake edhe pse ata ishin më të shumtë në numër. Thuhet se ata ishin afro njëzetmijë.

Mukavkisi kur e vërejtë se ushtria bizantine në Babilon u thye, u bind se që aty ushtria e Amrit, do të marshonte drejt Aleksandrisë – kryeqyteti i atëhershëm i Egjiptit. Pa humbur kohë, si i zgjuar që ishte ai, kërkoi prej Amrit armëpushim. Prijësi ushtarak i muslimanëve e pranoi ofertën e tij, sepse Mukavkisi kishte thënë se dëshironte të mësonte më shumë për Islamin dhe muslimanët. Mukavkisi e shfrytëzoi këtë armëpushim për të përfituar kohë, sepse ai kërkoi nga Herakli ndihma urgjente ushtarake.

Pas mbarimit të armëpushimit, ushtria e Amrit u drejtua drejt Aleksandrisë. Gjatë rrugës për në kryeqytet, Amri nuk hasi ndonjë rezistencë të madhe, me përjashtim të disa vendeve, të cilat i janë të njohura historisë vendase. Ushtarët e garnizoneve bizantine po i linin qytetet e lira. Ata po grumbulloheshin në Aleksandri. Kur Amri rrethoi qytetin, ndihma nga Kostandinopoja ende nuk kishte arritur. Ushtria muslimane qëndroi përreth mureve të qytetit katër muaj. Omeri po e ndiqte situatën nga Medina. Ai nuk bindej asesi se ushtria e Amrit do të duhej të priste akoma një situatë më të volitshme për të sulmuar. Një ditë, u zemërua në strategjinë e Amrit dhe u dha urdhër nga Medina ushtarëve muslimanë që të sulmohet qyteti. Kur Amri e mori urdhrin, ai caktoi Ibadete bin Samit që ta udhëhiqte këtë sulm. Pas një sulmi të rrufeshëm, ushtria muslimane arriti të futet në qytet, ndërsa Mukavkisi pranoi kushtet e kapitullimit. Kjo ngjarje ka ndodhur në vitin 20 të hixhretit, ose 641. Marrëveshja vlente vetëm njëmbëdhjetë muaj.

Thuhet se, sapo ishte futur ushtria e Ibadetes në qytet, kishte arritur edhe ndihma e trupave bizantine të cilat ishin dërguar nga Herakli. Por edhe ai kontingjent nuk u ndihmoi, sepse u thyen shpejt nga muslimanët. Pas stabilizimit të gjendjes në qytet, Amri u kthye në Babilon. Vendasit këtë vendbanim e quanin Fustat. Shkuarja e Amrit në Fustat ishte me urdhër të Emirit të besimtarëve, Omerit r.a.

Në kohën e sundimit të djalit të Heraklit, Konstandinit, në 23 dhe 25 të hixhretit (643 dhe 645) u bënë disa përpjekje për ta rikthyer Egjiptin, por më kot. Kështu Egjipti filloi të bëhet qendër e muslimanëve. Gjatë kohës së Amrit, ushtria muslimane u vendos deri në tokat më veriore të deltës së lumit Nil.

Kronologji e shkurtër e çlirimeve të qyteteve nga muslimanët dhe ngjarjet më kryesore që nga viti 13 h./ 634 deri në fund të vitit 23 h./ 644 gregorian (periudha e sundimit të Omerit r.a.)			
Nr.	Viti hixhr dhe e.p.s	Ngjarja më e rëndësishme dhe emrat e qyteteve të çliruara	Mënyra e çlirimit
01.	13/634	Vdekja e Ebu Bekrit. Gjatë periudhës së tij janë çliruar shumë qytete të cilat i kemi theksuar në numrat e kaluar	
02.	14/635	Damasku Humusi, Balbeku Basra, Ebla	Pjesërisht me luftë Pa luftë Me luftë
03.	15/636	E tërë Jordania, Jermuku dhe Kadisija me Kufen Taberija – në Jordani Ibn Xheriri thotë: Në këtë vit Omeri r.a. i bëri të detyrueshme obligimet fetare	Me luftë Pa luftë
04.	16/637	Ehvazi dhe Medain (kryeqyteti pers), pas fitores së muslimanëve në vendin Xhelulai dhe humbjes përfundimtare të Jazderxhid. Seadi e fali namazin e parë të xhumasë në pallatin e Kisrasë. Tikritin, Kudsin, Halebin, Antakinë, Karkisija Kanserinin, Seruxhin	Me luftë Pa luftë Me luftë
05.	17/638	Omeri këtë vit më shumë është marrë me rregullimin e brendshëm, ka shkuar në Haxh. Përfundimisht Ehvazi çlirohet	Pa luftë
06.	18/639	Xhundu Jesabur, Riha, Semisat, Nasibin, Një pjesë e ujdhesës Unvete Hilvan, Mosul me rrethinë Këtë vit muslimanët janë përballur me epideminë e njohur me emrin Epidemia e Amvas-it	Pa luftë Me luftë
07.	19/640	Këtë vit është çliruar Kajserije	Me luftë
08.	20/641	Shumica e territoreve të Egjiptit, me përjashtim të Aleksandrisë, janë çliruar pa luftë. Pas goditjeve që e ç'orientuan Bizantin në Sham, pjesa perëndimore e Egjiptit, gjithashtu, konsiderohet një goditje tjetër e rëndë. Aleksandria dhe piramidat ishin krenaria e perandorisë romake. Herakli ishte dorëzuar që herët, por edhe i biri i tij, këtu, i humb shpresat e rikthimit të territoreve të perandorisë.	Pa luftë Me luftë
09.	21 hixhri / janar-mars 642	Çlirohet përfundimisht Aleksandria, Nehavendi, Dinuri, Semrete, Hamadan dhe Asfahan. Me çlirimin e Aleksandrisë dhe Nehavendit, pushtuesit e huaj nuk konsideroheshin më shumicë në shtetin e tyre. Amër bin As filloi ndërtimin e xhamisë në Kajro Omeri e liron nga detyra Seadin. Në vend të tij e emëron Mugire bin Shoubete. Në këtë vit vdes edhe Halid bin Velid	Me luftë
10.	22 h. / janar 643	Rrethimi i Berkas, banorët e tyre kapitullojnë duke pranuar xhizjen Tarabulus (Tripolin), Hirat, Merurez (këtu thyhet Jarzderxhedi. Pastaj Rej (Teherani i sotëm). Azerbejxhani, Asker dhe Kum	Pa luftë Me luftë
11.	23 hixhri / 644	Karaman, Sixhistan, Asbahan me rrethinë. Amri, hapërsirat e tokave midis Nilit dhe Detit të kuq i quajti Territorët e Emirit të besimtarëve Në moshën 63 vjeç, më 26.10.644 vdes Omeri r.a. pas plagëve të mara dy ditë më herët nga robi i Mugires Fejruz, i njohur si Lu'lu. Qëndroi si Kalifi muslimanëve dhjetë vjet, gjashtë muaj e katër ditë.	
Për kronologjinë kam përdorur: ('Tarihul Hixhrije' të Muhtarit dhe 'Tarihul Hulfa' të Sujutit			

## Vrasja e Omerit

Rreth Emirit të besimtarëve, Omerit r.a. është shkruar shumë. Faktin se ai ishte një Kalif shumë i madh e arsyeton edhe koha jonë sepse, edhe sot, studiuues të gjeneratave tona po merren me studimin e periudhës së sundimit të tij dhjetëvjeçar. Sër Tomas Arnold shprehet kështu: "Shkaku i suksesit të shpejtë të arabëve, para së gjithash, është sjellja e mirë e tyre, gjë që u mundësoi pritjen e mirë të të krishterëve, të cilët e urrenin sundimin bizantin që karakterizohej nga pushteti i padrejtë si dhe sjellja e keqe e teologëve të fraksionit Jakubit..."

Fatkeqësisht dhe padrejtësisht disa historianë ia atribuojnë Omerit r.a. djegien e bibliotekës së Aleksandrisë. Meqenëse djegia e kësaj biblioteke nuk është tema jonë, themi se kjo ishte një shpifje e kulluar e atyre që duan ta zbehin rolin dhe kontributin e Omerit brenda shoqërisë muslimane dhe vendosjen e rregullave ndërkombëtare. Ai ishte ithtar i dijes dhe kurrë nuk kishte për ta lejuar një gjë të tillë. Ai vazhdimisht e luste All-llahun e Lartëmadhëruar që të mbante drejtësi për të gjithë dhe, kur fiziku i tij filloi të dobësohej, ndërsa territoret po zgjeroheshin me të shpejtë, i frikësuar se nuk do të mbante drejtësi, filloi ta shpeshkonte lutjen e tij për të vdekur sa më parë. "O All-llah, jam plakur e dobësuar dhe ata për të cilët duhet të kujdesem janë shtuar, ndaj ma merr shpirtin pa ua humbur të drejtat e pa e tepruar." (Hasan Ejub, f 144)

Për shkak se ishte i tillë, shumë qytetarë hipokritë ose ithtarë të feve të tjera mendonin se si ta vrisnin atë. Më së miri këtë smirë, arriti ta realizojë një rob i Mugires (mekëmbësit të Kufes). Ai kishte shkruar tek Omeri për t'u ankuar për zotërinë e tij, ndërsa Omeri i kishte premtuar se do të merrej me rastin e tij dhe kërkoi nga Mugirja që të sqarohet rreth tij. Në pritje të përgjigjes Lu'lujja po shëtiste nëpër rrugët e qytetit të Medinës. Një ditë të namazit të sabahut, kishte hyrë i armatosur në xhami. Me të filluar namazi e goditi atë me thikë të helmuar., në ikje e sipër theri edhe trembëdhjetë të tjerë shumica e të cilëve vdiqën menjëherë. Para se të dilte nga xhamia njëri nga xhemati e hodhi xhyben e vet dhe e ngatërroi nga këmbët. Në këtë moment ai vërejti se nuk kishte nga t'ia mbathte dhe vrau veten. ■

## Hafëzët e rinj të Llapit

# Zëri fëmijëror i vargjeve të Kur'anit



Agim FAZLIU



**F**uad Imeri është krejtësisht i qetë kur e lexon Kuranin. Djaloshi nuk e ndien shumë atë drojën e zakonshme të lexuesve të librit të shenjtë: mos po gaboj diçka, mos po e shtrembëroj tingëllimën e ndonjëres prej fjalëve të All-llahut. Zëri i tij ka ngjyrë. Ka një dridhërimë që duket e shkaktuar nga emocionet, por nuk është e tillë. Nuk ka tremë. Është zë fëmijëror.

Në memorien e djaloshit 14-vjeçar nga Lllapashtica e Ulët e Besianës është regjistruar "programi" më fisnik i kësaj bote. Ai është hafëz, e di përmendësh të gjithë Kur'anin. Këtë dhunti e ka arritur në gusht të vitit 2007, pasi ka mësuar dy vjet në Tetovë, te mësuesi i 220 hafëzëve, Mahmud Asllani.

Fuadi dhe vëllai i tij dy vjet më i ri, Usame, janë hafëzët e vetëm në gjithë rajonin e Llapit. Babai i tyre, Xhevahir Imeri, thotë se kishte ëndërruar gjithmonë që t'ua mundësonte djemve ta fitonin një gradë të tillë. "Është sakrificë sublime të vendosësh të bëhesh hafëz. Duhet shumë punë për ta arritur këtë. Pastaj, duhet përpjekur shumë për ruajtje të kësaj dije, për mos ta harruar gjatë gjithë jetës".


Çdo ditë, hafëzët e rinj u duhet ta lexojnë nga një "xhuz" të Kuranit. Pastaj u duhet ta recitojnë përmendësh atë para

prindërve. Kështu, derisa e lexojnë fund e krye. Është ky ritual heroik. Përpjekje dinjitoze për të ruajtur gradën sublime.

Xhevahiri thotë se ka investuar shpirtërisht dhe materialisht për këto synime. Familja Imeri jeton në Zvicër. Ai ka udhëtuar shpesh për në Tetovë, për ta ndjekur nga afër procesin e të mësuarit. Por, është ndier krenar kur e ka vërejtur se djemtë e tij ishin prej nxënësve më të mirë...

Por, ky investim shpirtëror është reflektuar në Zvicër. Mësuesi i Fuadit, Herr. Erzinger është mahnitur nga sjellja e djaloshit. E ka vërejtur si kishte diçka që nuk e kishin fëmijët e tjerë. Ishte më i vetëpërmbajtur. Nuk lazdrohej. Ishte shumë i moralshëm. "Disa herë më ka thënë mësuesi: A sikur t'i kisha bërë edhe fëmijët e tjerë sikur djali yt" - tregon Xhevahir Imeri.

Ai është krenar që ka arritur t'i bëjë djemtë shëmbëlltyrë për t'ua pasur lakmi. Tash e tutje, është duke menduar për drejtimin arsimor që ata mund të marrin. Nuk mërzhitet shumë për shkolllën laike që ndjekin në Zvicër. E ndien si obligim moral për t'i udhëzuar djemtë që ta ndjekin më tej rrugën e nisur. "Kisha pas qejf që të bëhen muhadithë, komentues të porosive të Muhamedit a. s. Për me u bë hafëzë i kam shty unë, për muhadithë, do të vendosin vetë". ■



# Dhuna në shkolla po merr përmasa shqetësuese

Polica e Kosovës vetëm gjatë tre muajve të këtij viti ka zënë në duart e nxënësve rreth 90 armë, prej të cilave 30 armë zjarri dhe 59 armë të ftohta



Fatos SHALA

Statistikat e Policisë së Kosovës për numrin e armëve të zëna në duart e adoleshenteve, gjegjësit të nxënësve të shkollave, është alarmante. Policia e Kosovës vetëm gjatë tre muajve të këtij viti ka thënë se në duart e nxënësve janë zënë rreth 90 armë, prej tyre 30 armë zjarri dhe 59 armë të ftohta.

Përkundër faktit se që më shumë se një vit ka filluar implementohet një memorandum i nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe Policia e Kosovës, për shtimin e sigurisë nëpër shkolla, situata vazhdon të jetë alarmante.

## Beka: Gjendja është alarmante...

Prej shtatorit të vitit të kaluar e deri në fund të prillit të sivjetmë janë regjistruar 505 denoncime për sjellje sociale, numër ky dukshëm më i lartë se sa në vitin paraprak shkollor, kur ishin raportuara rreth 300 sosh.

“Nga shtatori i këtij viti janë lajmëruar 84 lëndime të lehta e 12 lëndime të rënda trupore, po ashtu janë evidencuar 64 raste të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, 63 incidente nxënës-nxënës, nxënës-profesor, ose nxënësve me qytetarë të tjerë, si dhe 43 vjedhje” - ka thënë Arbër Beka, zyrtar për informim në Policinë e Kosovës. Ai më tej ka shtuar se numri i armëve të zëna në duart e adoleshentëve është alarmante.”

“Statistikat e Policisë së Kosovës për numrin e armëve të zëna në duart e nxënësve flasin për shifra alarmante. Policia e Kosovës vetëm gjatë tre muajve të këtij viti ka zënë në duart e nxënësve rreth 90

armë, prej të cilave 30 armë zjarri dhe 59 armë të ftohta” - është shprehur Beka.

Dhuna në shkolla shihet si problem i madh dhe mjaft shqetësues edhe nga sociologu Shemi Berisha. Ai thotë se shkollat dhe Ministria e Arsimit tash e tutje duhet të mendojnë shumë më tepër, jo vetëm për kualitetin në mësim, por edhe për sigurinë e nxënësve.

“Nëpër shkolla duhet të instalohet një sistem sigurie, qoftë më ndihmën e shkollave, qoftë më ndihma të tjera nga institucionet gjegjëse. Por një siguri duhet të bëhet gjithsesi” - u shpreh Berisha, duke shtuar se edhe prindërit duhet të angazhohen më shumë. “Natyrisht se edhe komuniteti i prindërve duhet ta japë maksimumin e vet në këtë drejtim” - ka përfunduar Berisha.

## Edhe arsimtarët ndihen të rrezikuar

Hajrush Beqiraj, arsimtar në shkollën “28 Nëntori”, tregon se ka qenë edhe vetë pjesë e këtyre ngjarjeve. Ai thotë se disa herë nxënësve të kësaj shkolle u janë zënë armë të ftohta. Po ashtu, ai thotë se policia është vënë në dijeni për këto raste dhe për raste të tjera.

“Shumë herë kemi identifikuar nxënës që kanë bartur armë të ftohta dhe kemi lajmëruar policinë. Madje, kemi qenë edhe vetë të kërcënuar nga nxënësit” - tregon Beqiraj. Ai ju bën thirrje të gjithë organeve kompetente, e në veçanti Policisë së Kosovës, që të ndërmarrin diçka sa më parë sa nuk është bërë tepër vonë.

Tituj si: “Nxënësit shqiptarë me thika në shkolla”, “Nxënësit me kozmetikë në çanta”, “Nxënësi i ngul thikën shokut” - i hasim shpesh nëpër ballinat e gazetave tona. Vërtet, kjo është për t'u shqetësuar. Sikur nuk mjaftojnë problemet e tjera që sot ka arsimit në Kosovë (mungesa e objekteve shkollore dhe kushteve ku mësojnë nxënësit, etj.) por çdo ditë lexojmë se si nxënësit shqiptarë po bëjnë marrëzira në shkolla.

Shkolla është institucion i krijuar nga shoqëria për interesat e vetë shoqërisë. Por, kjo shoqëri, a kontribuon në funksionimin si duhet të këtij institucioni? Këtu e kemi fjalën për arsimtarët dhe prindërit që nuk mund t'i kontrollojnë fëmijët dhe nxënësit e tyre. Dhe, pa dyshim, që shkolla e gjithnjë e më tepër po e humbet kuptimin e një institucioni edukativ. ■



Arbër Beka - zyrtar për informim në Policinë e Kosovës

# Ahmed Davutogllu – ideolog i pol

Në muajin maj, kryeministri Rexhep Tajip Erdogan ka realizuar ndryshimin e pritur në qeverinë turke duke sjellë nëntë emra të rinj në kabinetin qeverisës. Analistët vlerësojnë se ndryshimi më i rëndësishëm në listën e publikuar nga kryeministri Erdogan ka qenë emërimi i kryekëshilltarit të tij, Ahmet Davutogllu, i cili nuk është deputet, në postin më të lartë të politikës së jashtme



Ajni SINANI

Shumë tituj i jepen Ahmed Davutogllu. Ai në korridorët e politikës së jashtme njihet si "eminenca gri", "njeriu në hije", "intelektual sipëror me ndikim të madh", kurse dashamirët e tij e thërresin "hoxha" ose "mësues". Larg titujve, emërimi i Davutogllut për Ministër të Punëve të Jashtme të Turqisë, tërheq vëmendjen jo vetëm se është rast i rrallë në jetën politike turke, që emërohet një ministër jashtë parlamentit, por, çka është më me rëndësi, sepse ai është ideologu i parë për politikën e jashtme turke që ka ndjekur Partia për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP), që ka forcuar rolin rajonal të Turqisë, madje e ka vendosur atë në qendër të ngjarjeve rajonale në Lindjen e Mesme.

Davutogllu ka lindur në 1959, në qytetin Konia. Në vitin 1999 ai ka marrë shkallën "profesor" në shkencat e marrëdhënies ndërkombëtare. Ai ka punuar në shumë universitete në Turqi dhe jashtë saj, më i rëndësishmi është Universiteti islamik në Malajzi. Ai gjithashtu ka kryesuar Departamentin e Marrëdhënies Ndërkombëtare në Universitetin privat turk "Bilkent", para se Erdogan ta zgjidhte këshilltar të politikës së jashtme, për të mbikëqyrur funksionimin dhe për të monitoruar dhe planifikuar procesin e filluar për një politikë të re të jashtme të vendit, pasi AKP fitoi zgjedhjet parlamentare dhe formoi qeverinë turke.

## Parimi i thellësisë strategjike dhe trashëgimia osmane

Pozita prej këshilltari për politikën

e jashtme i ka mundësuar Davutogllut që të ndikojë në mënyrë direkte në politikën e jashtme të Turqisë në nivelin më të lartë, dhe në zbatimin e teorisë së tij për politikën e jashtme nëpërmjet parimit të ashtuquajtur "thellësia strategjike" - "Strategic Depth" që e ka elaboruar në librin e botuar në vitin 2001, me titull "Stratejik Derinlik, Tiirkiye'nin Uluslararası Konumu", (The Strategic Depth: The Turkish International Location).



Ahmed Davutogllu

Davutogllu në librin e tij bën thirrje në domosdoshmërinë e një ripërcaktimi të politikës së jashtme të Turqisë, në përputhje me atë që ai e quan parimi i "thellësisë strategjike", ku ideja kryesore është përqendruar rreth asaj se vlera e çdo shteti në marrëdhëniet ndërkombëtare, rrjedh nga pozita e tij gjeostrategjike dhe nga thellësia e tij historike. Sipas këtij parimi, Turqia shquhet për "thellësinë gjeografike" (geographical

depth) dhe për "thellësinë historike" (historical depth).

Në lidhje me thellësinë gjeografike, Davutogllu e konsideron Turqinë si një vend me pozitë "qendrore" dhe, për këtë arsye, ajo sipas tij "nuk duhet të shihet si një vend urë që lidh vetëm dy pika dhe as si një shtet në kufi, apo si një shtet i rëndomtë që bie në skaj të botës islamike, ose në skaj të botës perëndimore".

Turqia, sipas Davutogllut, është një vend "qendror" për shkak të faktit të

pozitës së saj unike gjeografike, sepse: "Gjeografia i jep Turqisë pozitën e një shteti qendror unik, ndryshe nga shtetet e tjera qendrore të Evropës. Për shembull, thotë ai, Gjermania është një vend qendror në Evropë, por gjeografikisht është larg nga Afrika dhe Azia. Rusia është gjithashtu një vend qendror në Evropë dhe Azi, por gjeografikisht është larg nga Afrika. Edhe Irani është një vend qendror në Azi, por gjeografikisht është larg nga Evropa dhe Afrika. Prandaj, konstaton Davutogllu, me një vështrim më të gjerë, Turqia ruan një pozitë më të mirë se shtetet e përmendura për shkak të të qenit të saj një shtet evropian dhe aziatik në të njëjtën kohë. Ajo, gjithashtu, është afër me Afrikën nëpërmjet Detit Mesdhe. Si rrjedhim, Turqia mban një pozitë unike si vend qendror.

Turqia, sipas tij, sikurse që ka "thellësi gjeografike", ajo ka gjithashtu edhe "thellësi historike", dhe këtë Davutogllu e shpjegon me trashëgiminë osmane të saj, kur Perandoria Osmane ishte një nga qendrat e tërheqjes globale, gjë që reflektohet mbi Turqinë e sotme, e cila ka një përzjerje të elementeve të ndryshme të Ballkanit, të Kaukazit, të Lindjes së Mesme dhe Anadollit, elemente të cilat takohen nën ombrellën e shtetit të sotëm turk.

# itikës së jashtme turke

Si rezultat i kësaj thellësie gjeografike dhe historike të Turqisë, që Davutogllu i përmbledh në "thellësinë strategjike", Turqia, sipas pikëpamjes së Davutogllut, është një shtet me multi-identitete rajonale, identitete që i përkasin rajoneve të ndryshme të tilla si Lindja e Mesme, Ballkani, Kaukazi, Azia Qendrore, Deti Kaspik, Deti Mesdhe dhe Deti i Zi dhe nuk mund të identifikohet me një identitet të vetëm.

Prandaj, vlerëson Davutogllu, "Turqia të qenit e saj si një shtet i rëndomtë periferik duhet ta konsiderojë si pjesë të së kaluarës dhe duhet të nisë një politikë të jashtme të re, në mënyrë që të sigurojë stabilitet jo vetëm për veten e saj, por edhe fqinjët e saj. Ajo për të siguruar sigurinë e saj kombëtare dhe stabilitetin e vet, duhet të luajë një rol më aktiv dhe ndërtues për sigurimin e sistemeve të sigurisë dhe stabilitetit me shtetet që e rrethojnë atë".

Si rezultat i këtij vështrimi të ri, të iniciuar nga Davutogllu, Ankaraja ka vendosur parime të reja për politikën e saj të jashtme ku shquhet zgjidhja e mosmarrëveshjeve me vendet fqinje, duke avancuar bashkëpunimin me to. Parimet e reja kërkojnë gjithashtu një zhvendosje dhe ndryshim të politikës së jashtme të Turqisë drejt Lindjes së Mesme, pas një kohe të gjatë të fokusimit të politikës së saj vetëm në drejtim të Perëndimit.

## Ndryshimi në politikën turke

Ndryshimi në politikën e jashtme turke është rezultat i zbatimit të parimit unik të "thellësisë strategjike" që ka zhvilluar Davutogllu duke përfshirë disa çështje:

### Afrimi me Sirinë

Marrëdhëniet e Turqisë me Sirinë janë përmirësuar nën udhëheqjen e AKP-së, sidomos me vizitën e presidentit sirian Bashar El-Assad në Turqi, në janar 2004, që është pasuar nga një vizitë e presidentit turk, Nexhdet Sezer-it, në të njëjtin vit. Ky ka qenë një shkëmbim i vizitave, i pari i këtij lloji në historinë e marrëdhënieve midis dy vendeve. Të dy palët kanë nënshkruar protokolle të bashkëpunimit në fusha të ekonomisë, turizmit dhe shkëmbimet arsimore. Madje, e gjithë kjo është bërë në kohën kur Siria po i nënshtrohej një izolimi të rëndë ndërkombëtar të imponuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kur Damasku akuzohej nga Uashingtoni se "po pranonte ish-zyrtarët e Irakut, dhe po i lejonte ata të organizonin rezistencën irakiane në territorin sirian, madje edhe duke e financuar atë".

### Afrimi me Iranin

Afrimi i Turqisë me Iranin ka ardhur si rrjedhim i zbatimit të parimit të "thellësisë strategjike", të Davutogllut. Turqia gjatë luftës së ftohtë ka qenë kundër Iranit, madje e ka akuzuar në mënyrë të përsëritur gjatë viteve nëntëdhjetë për mbështetje të PKK-së. Ndërkaq, ajo ka forcuar lidhjet e saj me Teheranin nën sundimin e AKP-së. Në korrik 2004, Erdogan bëri një vizitë në Teheran, gjatë së cilës ai nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi shumëpalësh me zyrtarët iranianë, që përfshiu shumë nga marrëveshjet ekonomike, si shtesë e angazhimit të përbashkët të sig-

urisë të bashkëpunimit në luftën kundër PKK-së.

Edhe presidenti iranian Ahmadinejad ka bërë një vizitë zyrtare në Turqi, në gusht të vitit 2008. Turqia ka mbështetur, gjithashtu, të drejtën e Iranit për të poseduar energji bërthamore për qëllime paqësore. Gjithë ky afrim Turqi-Iran është realizuar gjatë kohës së izolimit ndërkombëtar të imponuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbi Iranin, madje në mes të krizës bërthamore të Iranit.

### Qëndrimi i Turqisë ndaj çështjes palestineze

Qëndrimin i Turqisë ndaj çështjes palestineze ka pasur një avancim të theksuar nën udhëheqjen e AKP-së, e cila gjithmonë lidhjet e saj strategjike dhe ushtarake me Izraelin i kishte si prioritet kryesor në Lindjen e Mesme. Mirëpo një prioritet i tillë ka ndryshuar me zbatimin e parimit të "thellësisë strategjike".

Në një kohë kur Perëndimi vuri një bllokadë financiare ndaj Hamasit, kur ai formoi qeverinë pas fitores në zgjedhjet legislative të vitit 2006, Turqia e ftoi Halid Meshalin, kreun e Hamasit, në Ankara. Ky veprim shkaktoi zemërimin e amerikanëve dhe izraelitëve.

Mbështetja e Turqisë ndaj çështjes palestineze u duk qartë gjatë luftës së fundit në Gazë, kur Erdogan me një gjuhë të ashpër e akuzoi Izraelin për kryerjen e krimeve të luftës në Gazë, madje ai mbrojti edhe lëvizjen Hamas. Ajo që do të kujtohet dhe që është regjistruar në memorien tonë, pa dyshim, është largimi i famshëm i Erdoganit në mënyrë demonstrative në Samitin e Davosit. ■



# Servilët dhe servilizmi



Ekrem AVDULLAHU

Themi për dikë: është servil! E dimë se çka do të thotë kjo? Me siguri se po. Njerëzit bëhen servilë zakonisht ngaqë ia kanë nevojën dikujt. Dhe ai dikushi është i fuqishmi, i pushtetshmi, i pasuri. Dhe mund të jetë i frikshmi. Por njerëzit nuk janë servilë vetëm ndaj njerëzve. Janë edhe ndaj sistemeve, apo edhe ndaj ideologjive. Servilët janë më të shumtë atëherë kur një popull apo ambient shoqëror jeton në skamje, në varfëri, në robëri dhe në frikësim. Servilët nuk kanë besim as në veten e tyre, as tek rrethi i tyre shoqëror, as tek fuqia e popullit të tyre. Servilët janë krejtësisht inferiorë. Prandaj ata edhe përlulën ndaj të fuqishmëve, ndaj funksionarëve, qeveritarëve, ndaj bosëve të ndryshëm. Servilizmi në fakt është nënshtrim.

## Servilëve u mungon Uni personal

Disa bëhen servilë edhe pa pasur arsye të shumta nënshtrimi, pos nga shkak i thjeshtë se kanë shpirt servili e zemër frikacak. Mbi të gjitha, servilëve u mungon uni personal. Nuk kanë besimin as në vetvete, as në rrethin e vet, bile as në kombin e vet. Kështu, në mendjen e servilëve të fuqishmit, të pasurit, sundimtarët, qeveritarët, pushtuesit janë gjigantë dhe, për pasojë, nga ata mund të shpëtohet dhe nga ata mund të përfitosh vetëm duke u shtrirë si zvarranik para tyre, me fjalë të tjera duke u nënshtruar apo duke u vënë në shërbim. Servilizmi ndërkaq është një ves shoqëror dhe një deformim psikologjik që vjen nga thellësitë e historisë dhe ka shtrirje në tërë botën, ndër të gjithë vendet dhe në të gjitha kombet.

Servilizmi njihet disa periudha kur ai lulëzon më shumë apo më pak. Shqiptarët kanë njohur momente të servilizmave të skajshëm, sidomos në kohë pushtimesh apo rrojtjesh nën diktatura. Kështu ne kemi pasur njerëz që kanë qenë servilë ndaj Krlevinës së Serbisë, servilë ndaj pushtetit ushtarak komunist jugosllav të vendosur në Kosovë menjëherë pas

Servilizmi është një ves shoqëror dhe një deformim psikologjik që vjen nga thellësitë e historisë... Servilizmi njihet disa periudha kur ai lulëzon më shumë apo më pak. Shqiptarët kanë njohur momente të servilizmave të skajshëm, sidomos në kohë pushtimesh apo rrojtjesh nën diktatura

Luftës së Dytë Botërore. Servilët janë përgjithësisht njerëz të ligj, prandaj ata edhe pranojnë të bien aq poshtë.

## Servilët janë hyzmeqarë, puthadorë...

Nuk do të harrohen dy momente që njihet historia e Kosovës, kur servilizmi kulmoi në tradhti kombëtare. Një asamble të përzgjedhurish në Prizren, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, pas votimit të parë për bashkim me Shqipërinë, në votimin e dytë pati votuar për bashkimin e Kosovës me Serbinë, gjë që popullit të tyre i kushtoi edhe gjysmë shekulli pushtim të egër. Servilët shqiptarë edhe një herë kaluan në tradhti kombëtare, në mars 1990, kur pavarësisht deklarimit gjithëpopullor KUNDËR, votuan PËR ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. Kështu ata rikthyen vendin e popullin e tyre nën një përfaqim edhe më të hekurit serb. Shembuj të servilizmit apo të servilëve ekstremë dhe të përjetshëm historia e Kosovës njihet tek figurat e politikanëve komunistë të saj, si: Ali Shukria, Kolë Shiroka, Sinan Hasani, Rrahman Morina. Servilizmat e tradhtitë e tyre ishin flagrante. Përndryshe nëpër komuna të Kosovës pushteti serb kishte servilët e vet, të cilët ishin veshur me pushtet si sekretarë komitetesh, kryetarë komunnash, udhëheqës sindikatash, të Lidhjes Socialiste, të Rinisë Socialiste, drejtorë ndërmarrjesh, fabrikash, shkollash... Këta udhëheqës, për shkak të karrizmit të tyre ishin të nënshtruar plotësisht ndaj eminecave gri serbe, sundimtarëve të vërtetë, të cilët në Kosovë me ndihmën e servilëve të tyre shqiptarë zbatonin politikën antishqiptare të Beogradit. Populli këta i quante hyzmeqarë, zagarë, puthadorë deri edhe bythëlëpirës.

## Shumë servilë shqiptarë ikën nga Kosova bashkë me forcat serbe para një dekade

Servilizmat në jetën tonë shoqërore

dhe kombëtare, ndërkaq, janë të përditshme dhe janë të dukshme brenda fushash të ndryshme. Bie fjala, një gazetar i dobët bëhet servil i udhëheqësit të mediumit, duke blerë vendin e punës përmes përgojimit të kolegëve të tij. Servilët me punët e tyre të mbrapshta krijojnë atmosferë pasigurie në komunitete të tilla sa kjo u mundëson "shfave të mëdhenj" që të kenë në dorë jo vetëm njerëzit, po edhe mendjet e tyre. Nga atmosfera të tilla pune gjithmonë janë krijuar kushte të padurueshme orveliane. Gazetarët e tillë u shërbejnë shfave të tyre që nganjëherë të nënshkruhen në tekstet të cilat ata nuk i kanë shkruar, apo që të shkruajnë tekste me porosi të caktuar që në të shumtën e rasteve nënkupton shkrime që kanë për qëllim të nxijnë rivalin mediatic, ekonomik apo politik.

Fati i servilëve, këtyre hyzmeqarëve të zellshëm në punët të këqija, zakonisht është i zi. Ata nuk shkojnë në atë dynja pa u diskredituar nga koha dhe ndryshimet që sjell ajo. Për shembull, sot ke mjaft nga gazetarë që kanë shërbyer me aq zell regjimin titist-stalinist jugosllav, ose tërhiqen në anonimitet të thellë ose bëhen qesharakë duke u "shpërndërruar" në "demokratë" dhe "atdhetarë". Ndërsa, jo pak nga hyzmeqarët, të nënshtruarit dhe servilët shqiptarë në organet e brendshme të shtetit serb-jugosllav, punonjës të prokurorive, të gjykatave, sot sorollaten krejtësisht të humbur për shkak të ndërjegjeve të tyre të vrara dhe për shkak të dështimit në kalkulimet se kungulli do t'u shkojë gjithmonë mbi ujë. Nuk duhet harruar se shumë nga ata janë tërhequr nga Kosova bashkë me tërheqjen e forcave ushtarake dhe policore serbe, ngaqë ata as nuk mund të imagjinonin dot qëndrimin e tyre në Kosovën e lirë, kundër së cilës ishin përpjekur aq shumë me zellin e tyre prej hyzmeqarësh. ■

# Kush po diskriminohet në Kosovë?



Osman D. GASHI

**I**nxitur nga një vlerësim si minus i javës, në një nga gazetatat tona ditore, aktin e ngrirjes së borxheve të KEK-ut të serbëve të Anamoravës, ndërsa në anën tjetër, ndërprerja e plotë e rrymës elektrike si pasojë e mospagimit të borxheve banorëve shqiptarë të Krushës së Madhe e të Vogël, më bëri që të hulumtoj për një diskriminim që po bëhet tash e gati një dekadë, që nga mbarimi i luftës, shumicës shqiptare në Kosovë.

“Kur e vret shyta kapricën vaj halli për shumicën!” ose “Më shumë po zë strajca se thesi!” - janë dy thënie nga thesari i pasur i popullit. Diskriminimi i shumicës, qoftë nga jashtë apo qoftë edhe nga brenda nga pakica (duke u mbështetur nga “i forti”), s’është gjë tjetër pos imponim me dhunë.

Mospërfillja e shumicës shqiptare në Kosovë, që dihet se përbën rreth 95% të popullatës, tregon për një diskriminim absurd dhe të papranueshëm për një person që mendon dhe logjikon në mënyrë të arsyeshme. Kur thuhet diskriminim ndaj shumicës kihet për qëllim jo cenimi i të drejtave të pakicave të tjera që jetojnë në shtetin e Kosovës, por jo edhe të vepruarit negativisht në kurriz të shumicës në emër të “demokracisë dhe respektimit të të drejtave” të komuniteteve.

Ka qenë deri diku e kuptueshme që para luftës, nën pushtimin dhe sundimin e Serbisë, siç thotë populli atëherë kur “s’të ka vet kush kah i ke dajt” edhe pse ke qenë shumicë në Kosovë, por nuk mendoj që tani si shtet i pavarur që jemi ende mos e kemi atë që e meritojmë.

Rasti i ngrirjes së borxheve nga KEK-u për serbët e Anamoravës është më i freskëti që po na kujtohet, por ka edhe raste të tjera që janë edhe më të papranueshme në një vend normal demokratik. Një nga arsyetimet që trumbetohet më së shpeshti është: *jemi në fazën e tranzicionit*.

Në rastin e KEK-ut, nuk mund të evitohen edhe pasojat e mundshme, sepse mund të shkohet edhe deri te çimentimi i bindjes së qytetarëve për mospagesën e rrymës elektrike, sepse s’kanë pse paguajnë kur KEK-u po t’i “falka” borxhet, apo ‘shpenzo rrymë sa të duash, por prapë të falur e ke.’

Qasja e tillë diskriminuese ndaj shumicës shqiptare, në emër të integritetit të pakicave “me zor” e me theks të veçantë asaj serbe, në shoqërinë të cilën para një dekade e kanë përdhosur, luftuar, përdhunuar, djegur e vrarë, është si ajo puna e fëmijëve që paradite zihen, e pasdite ai fëmija më i dobët dhe më i ngratë e fton atë më të fortin dhe i thotë ‘hajde lozim bashkë.’

Kemi edhe mjaft raste të tjera që mund t’i marrim si shembuj për të ilustruar diskriminimin negativ që i bëhet shumicës në Kosovë, e më e keqja është se kjo bëhet në emër të demokracisë dhe emancipimit.

Besoje se është mjaft ilustrativ shembulli i sigurimit të njëzet vendeve për deputetët e komuniteteve të tjera në Ku-

vend ende pa dalë në zgjedhje, në bazë të “Kornizës për Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë”, gjë që po të analizohet hollësisht, i thyen parimet bazë të demokracisë. Edhe ky rast ka pasur pasojat e veta, pasi në të gjitha zgjedhjet që janë mbajtur në Kosovë deri më tani, ka pasur një demotivim të qytetarëve për pjesëmarrje në votim, e një ndër arsytet ka qenë edhe fakti i mësipërm.

Shembulli i tretë i diskriminimit të shumicës ishte edhe përbërja e Komisionit të Pavarur të Mediave që ishte edhe më zemërgjerë: ajo parashihte që në komisionin pesëanëtarësh, dy anëtarë të jenë shqiptarë, një serb, një ndërkombëtar. Nga kjo matematikë, nuk është zor të kuptohet se kush mund të jetë pakicë në këtë komision, si dhe të merret me mend sesi do të hartohen e si do të zbatohen politikat e mediave në këtë vend.

Përfundimisht, sa i përket diskriminimit të shumicës, mund të flasim më shumë duke u mbështetur në fakte të pamohueshme dhe reale, por duhet që të kihet parasysh një gjë: rregulli i shumicës. P.sh. në Kuvend, kur votohet një gjë, votohet me shumicë, që nënkupton se duhet të respektohet vullneti i shumicës për vendosjen e një drafti, në mënyrë që ai të hyjë si procedurë e rregullt ligjore. Shtrohet pyetja: pasi parimi demokratik i rregullit të shumicës, ku duhet të respektohet vullneti i saj, po vlen në teori, pse mos të vlejë edhe në praktikë, në jetën tonë të përditshme?! ■



NO DISCRIMINATION



Në përvjetorin e 128 të rënies heroike të Mic Sokolit

# Mic Sokoli – shëmbëlltyrë e luftës

Arbër AHMETI

**K**ur flasim për historinë e kombit tonë, hasim në figura që tërë veprimtarinë dhe jetën e tyre ia kanë kushtuar atdheut. Populli ynë ka dhënë nga gjiri i tij shumë emra të cilët qëllim të vetëm e kishin çlirimin e atdheut dhe, në këtë drejtim, prej këtyre patriotëve dikush luftonte me pushkë e dikush me penë, sidoqoftë këto dyja plotësojnë njëra-tjetrën dhe kjo gjë na u vërtetua gjatë epokës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Tashmë jemi në 128 vjetorin e betejave të lavdishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kundër forcave osmane dhe po ashtu në 128 vjetorin e rënies së heroit kombëtar Mic Sokolit.

Mic Sokoli, i biri i Sokol Ramës, lindi në vitin 1839 në lagjen Fang të fshatit Bujan, në Malësinë e Madhe. Babai i tij ishte një ndër prijësit e Malësisë, i cili së bashku me xhaxhanë e tij, Binak Alinë, udhëhoqi dhe organizoi kryengritjet kundër reformave të Tanzimatit, që do të thotë se kishte kontribuar edhe në krijimin e Lidhjes së Prizrenit edhe pse u vra disa dekada para se të bëhej ajo. E them këtë sepse kryengritjet dhe revoltat e shumta kundër reformave të Tanzimatit, si kryengritjet e Dibrës (1833, 1836, 1838-39, 1844, 1855, 1860, 1872, 1876-77), të Prishtinës dhe të Vuçitërnes (1834-1835, 1837), kryengritja e Myzeqesë (1837), e Beratit (1839), kryengritjet e Prizrenit (1839, 1843, 1847), ato të Gjakovës (1845, 1862, 1864, 1867-69), kryengritja e Jugut (1833), ajo e nëntë krahinave toske (1834-35), kryengritjet e Mirditës (1862, 1876-77), e Shkodrës (1835, 1862, 1863, 1869, 1871), kryengritjet e Prizrenit, e Pejës (1864, 1869), kryengritja e madhe fshatare e vitit 1847, kryengritja e Matit (1869) si dhe revoltat e Korçës (1850) dhe e Tiranës (1869), krijuan elitat udhëheqëse dhe frymën liridashëse përkrah përvojës ushtarake që ishin themeli i krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Këto kryengritje, krahas luftëtarëve të shumtë, veçuan edhe emra si Tafil Buzi, Hamëz Kazazi e “Sheh Shamia”, Alush Frakulla, Balil Hesho, Dervish Cara, Binak Alia

e Sokol Rama, Zenel Gjoleka e Rrapo Hekali, Hodo Nivica, Hasan Capari dhe prijës dhe luftëtarë të tjerë që u bënë burim frymëzimi për brezat që do vinin.

## U frymëzua që në fëmijëri nga legjendat dhe këngët për kreshnikët

Mic Sokoli u frymëzua që në fëmijëri nga legjendat dhe këngët për kreshnikët, nga bëmat e trimave të ndryshëm, të cilat patën ndikim të madh në krijimin e personalitetit të tij. Një ngjarje tjetër që do ndikonte në jetën e Mic Sokolit ishte vrasja e babait, kur ai ishte vetëm 7 a 8 vjeç. Edukimi sipas dokeve të Malësisë, ku urtësia dhe trimëria rrinin të pandara, i dhanë Micit natyrë të rreptë. Arsyeya se ishte i vetmi burrë në shtëpi e bëri të burrërohej para kohe. Po ashtu, puna që bënte çdo ditë për të siguruar

mbijetesën, zhytjet në lumin e Valbonës për të zënë peshq, ngjitjet në Malin e Hekurave dhe në stanet e larta, bënë që Mici të kishte trup plot muskuj. Ndeshjet e para me armikun Mici i pati qysh në moshë të re. Pritat që u bënte turqve dhe lufta përkrah malësorëve të tjerë kundër agresorëve malazezë, qysh në moshën 16 vjeçare, i dhanë Micit mësimet e para për luftën dhe e veshën atë me trimëri edhe më të madhe. Ai burrërohej çdo ditë dhe përherë e më shumë i shtohej dëshira për të luftuar, përderisa i shihte çetat e Sef Koshares tek bredhin nëpër Malësi dhe nuk i linin turqit të endeshin lirshëm. Në moshën 19 vjeçare, tashmë i përgatitur me trimëri dhe i ushqyer me artin ushtarak popullor, u fut në çetat e komitëve të cilat kryenin sulme kundër postave ushtarake turke, ekspeditave të ndryshme etj.



# ftës për liri

## Në krye të 3 mijë kalorësve nga Malësia e Madhe

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, përkrah shumë trimave që mbledhi rreth vetes, e gjeti Mic Sokolin në krye të 3.000 malësorëve, të cilët Micin dhe Ali Ibrën i kishin zgjedhur si udhëheqës. Mic Sokoli pati një rol shumë të rëndësishëm në këtë organizim mbarëkombëtar. Ai kishte gradën e kapedanit (që është e barabartë me gradën e sotme të gjeneralit) dhe ishte në krye të 3 mijë kalorësve nga Malësia e Madhe, që më vonë u transformua në Gardën e Lidhjes Shqiptare.

Mic Sokoli ishte pjesëmarrës në ngjarjet e 2 shtatorit të vitit 1878, ku u vra Mehmet Ali Pasha, i cili kishte ardhur për të zbatuar vendimet e Konferencës së Berlinit. Ndër udhëheqësit e revoltës së Gjakovës, ku u vranë qindra luftëtarë nga të dy palët, ishin Sylejman Vokshi, Ahmet Koronica, Mic Sokoli, Ali Ibra, Islam Batusha dhe krerë të tjerë popullorë. Këta treguan nivelin e lartë të pjekurisë së tyre politike dhe humanizmin e luftës së tyre të drejtë, duke flakur ndjenjën e hakmarrjes që mund ta zgjonte në të tilla raste vrasja e një numri kaq të madh shokësh a farefisi (Skënder Rizaj - Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1877-1885, f. 152).

Mic Sokoli mori pjesë në luftën e Nokshiqit më 4 dhjetor të vitit 1879, ku forcat shqiptare dërrmuan forcat malazeze, që po përpiqeshin të okuponin Plavën dhe Gucinë. Ai u dallua në luftimet që u zhvilluan tek ura e Lumit Lim, ku forcat e Mark Milanit, të zëna në kurth, u shpartalluan pothuajse krejtësisht. Po ashtu, ai ishte pjesë e shtabit që formoi Ali Pashë Gucia. Ky shtab bëri planin operativ të operacionit të gjerë të forcave të Lidhjes për të mësyre kundër forcave malazeze. Sipas këtij plani, sulmi filloi më 7 janar dhe përfundoi më 8 janar 1880, me shpartallimin e plotë të forcave malazeze. Ishte pjesëmarrës edhe në luftën për mbrojtjen e Hotit dhe të Grudës nga ofensivat malazeze, të cilat përfunduan turpshëm. Pati një rol të rëndësishëm në aksionet ushtarake të lidhjes për çlirimin e Shkupit (4 janar 1881), të Prishtinës (18 janar 1881), të Mitrovicës (25 janar 1881) dhe më vonë



Kulla e Mic Sokolit. Bujan, Tropojë

të Vuçitërnës dhe të Gjilanit (Historia e Popullit Shqiptar II, f. 175). Kur ekspedita e Dervish Pashës kishte mbërritur në Ferizaj dhe po përgatitej të marshonte drejt Prizrenit, Qeveria e Përkohshme e Lidhjes formoi shtabin e mbrojtjes me 25 anëtarë nën udhëheqjen e Sulejman Vokshit. Pjesëtarët e shtabit që njohim janë: Ali Ibra, Mic Sokoli, Binak Alia, Sef Kosharja, Halim Efendiu, Zeqiria aga, Mullah Hyseni, Mustafa aga, Halil efendiu, Xhelil efendiu etj. (Kristo Frashëri - Lidhja Shqiptare e Prizrenit). Për datën e rënies së Mic Sokolit janë 2 dëshmi: njëra që thotë se Dervish Pasha e nisi ekspeditën drejt Slivovës më 22 prill dhe tjetra që thotë se kjo ekspeditë filloi më 20 prill, ndërsa Mici ra po ditën e fillimit të sulmit.

Rrjedha e ngjarjeve filloi me marshimin e njësite të komanduara nga Haxhi Osman Pasha drejt Slivovës. Me t'iu afruar Slivovës, forcat turke u sulmuan befasisht nga luftëtarët e Lidhjes dhe u detyruan të tërhiqen. Pasi bënë përpjekjen e dytë dhe sërish u zunë ngushtë, forcat turke filluan të rrihnin me artileri pozicionet shqiptare. Artileria u bënte dëme të konsiderueshme dhe në këto momente, Mic Sokoli me disa shokë të tij lanë pozicionet mbrojtëse dhe u turë në drejtim të kodrës ku ishte vendosur artileria osmane. Ata kishin për qëllim ta shkatërronin artilerinë e armikut që shkaktonte dëme në radhët e forcave të qeverisë së përkohshme. Të gjithë këta luftëtarë trima u vranë së bashku me komandantin e tyre Mic Sokolin, i cili

ra heroikisht duke i vënë gjoksin topit armik (Kristo Frashëri - Lidhja Shqiptare e Prizrenit, f. 407). Ndërsa rrëfimet e malësorëve, që dëgjohen edhe sot e kësaj dite, thuhet se një i ri nga Bujani, që mbijetoi, tregoi më vonë për trimëritë e Micit dhe të bashkëluftëtarëve të tij.

### Aty ku e la Mici e vazhdoi nipi i tij Tahir Sinani...

Mici ra heroikisht në moshën 42 vjeçare, duke lënë pas gruan dhe 2 fëmijë, një djalë dhe një vajzë. Më shumë se një shekull më pas, një nip i tij e vazhdoi luftën aty ku e la Mici, aty ku e la Lidhja Shqiptare. Ai kishte trashëguar nga gjendet e Micit trimërinë dhe shkathhtësinë ushtarake. Nipi i Mic Sokolit, Tahir Sinani, ra dëshmor duke luftuar në radhët e UÇK-së për Bashkim Kombëtar.

Shumë ngjarje dhe luftëtarë të epokës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u përjetësuan në epikën historike. Vend të rëndësishëm në të zë edhe Mic Sokoli, prijësi i Krasniqes, biri i Sokol Ramës nga Malësia e Madhe. Heroizmi i pashoq i Micit u kthye në legjendë. Këngët për të jehuan nëpër vite dhe arritën deri te ne.

Për Mic Sokolin është shkruar edhe një roman nga Sylejman Krasniqi, i cili ka fituar Çmimin e Republikës për letërsi në vitet '70a.

Shkencëtarët e mirëfilltë duhet të studiojnë dhe të shkruajnë më shumë për jetën dhe veprën e Mic Sokolit. Lufta dhe rënia e tij heroike janë shembull i rrallë që duhet të ndiqet derisa të arrihen qëllimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. ■

## Kritikë letrare



Flamur MALOKU

**Trupi fizik i kësaj bote përkujton ashtu përmallshëm njeriun e dashur, të vdekur, me plot shenja të mëdha pikëlluese. Pikëllimi, i cili bëhet edhe më i fortë, shprehet në dy rrafshë: si prind dhe si bashkëshort**

**A**nton Zako Çajupi do të shkruajë elegjinë e njohur 'Vaje', pikërisht në dhjetëvjetorin e vdekjes së gruas së tij Evgjenisë (zvicerane). Kjo elegji edhe sot lexohet dhe interpretohet nga shumë studiues të letërsisë shqipe. Esenca e lexueshmërisë qëndron në vetë strukturën e ndërtimit, ligjërit, figurshmërisë, muzikalitetit, që ka kjo elegji. Kështu, duke u nisur nga struktura e ndërtimit, elegjia është e përbërë prej katër pjesëve, ku secila pjesë dallon, si për nga metri, rima, ritmi, tematika. Pjesa e parë dhe e fundit janë në varg 12 rrokësh, me rimë të përputhur, ndërsa pjesa e dytë dhe e tretë në vargun 8 rrokësh, me rimë të alternuar. Në të gjitha pjesët e elegjisë, ka gjithashtu degëzime tematike, mirëpo varësisht degëzimeve tematike, këto pjesë duhen lexuar pa një shkoputje të kodit tematik. E tërë kjo mbështetet në faktin se subjekti, që nga fillimi e deri në fund, do të rrëfejë mallin-dhembjen personale, për shkak të gruas së vdekur. Tani trupi fizik i kësaj bote përkujton ashtu përmallshëm njeriun e dashur, të vdekur, me plot shenja të mëdha pikëlluese. Pikëllimi, i cili bëhet edhe më i fortë, shprehet në dy rrafshë: si prind dhe si bashkëshort. Rrafshi prindëror lidhet me djalin, që tani është duke e rritur jetim, pa nënë, i cili quhet Stefan. Kjo e rrit edhe më shumë dramatikën jetësore të subjektit. Ndërsa, rrafshi bashkëshortor shoqërohet me vetminë, dhembjen:

*E ke lënë foshnjën, tani u bë burrë,  
S'arritje ta rritje, s'të ka parë kurrë!  
Për ty shumë herë çoç do të më thotë,  
Po s'mund t'i përgjigjem, se më mbytin lotë!*

Shihet se malli, dhembja, janë të pa-

# Teksti i vajit

shoqe kur humb njeriu i dashur, mirëpo mungesa e njeriut, dhe zbrazëtira e krijuar, duhet të tejkalohet, pavarësisht dhembjes. Një gjë e tillë bëhet paralajmëruese edhe nga paraqitja e figurës së Zotit, me të cilin zhvillon dialog subjekti ligjëruës:

*Pse s'kuvendon mirë, more punëbardhë  
Cili vdiq njëherë dhe prapë ka ardhë?  
Gjith' humbasin gruan, mëmë e babanë  
Po ata që mbeten si ti nuk qanë:*

Këto vargje tekstore ngrihen si gjykim jetësor, të cilat në ide kërkojnë pajtueshmërinë me fatin individual. Mirëpo, varësisht nga ky dialog, dhembja personale që bëhet shumë më e fortë e kalon edhe konventën emocionale, duke ardhur deri te rebelimi individual: "Tani rrojë pa shpresë, andaj s'dua të rrojë". Përdorimi i ligjërit tejet retorik, krijon revoltën subjektive, e cila vjen si shkas i dhembjes-humbjes së njeriut të dashur.

## Pikëllimi

Forma e të shprehurit, me një gjendje tragjike, do të vendoset në pjesën e dytë, ku trajtohet e ndodhura jetësore, pra shpaloset dhembja për gruan e sëmurë. Në këtë pjesë, teksti bëhet me shumë dhembje, njëherësh duke zërtëyer edhe përmasën *tragjike/jetësore*. *Tragjika shpirtërore fuqizohet edhe më shumë, kur autori përkujtimin e kthen në përjetim (Kujtim M. Shala)*. Përkujtimi me këtë rast bëhet përmallshëm dhe jepet përmes pikëllimit. Mirëpo, teksti bëhet më shumë trishtues/mallëngjyes, kur paraqitet figura e gruas. Në këtë mënyrë, filozofia e dialogut është tepër shqetësuese edhe për vetë lexuesit e tekstit:

Perëndi, lemë të gjallë.  
Po lutetë mëm' e mjerë,  
Të mund të rritë këtë djalë  
S'ka një javë që ka lerë.  
Kush do ta marr ta rrisë ?  
Jetim qysh do të rrojë?

Pyetjet e parashtruara, shkallëzojnë dhembjen dhe e rrisin rrafshin emocional të tekstit. Mirëpo, vargjet që do të vijnë zërtëjnë idenë se njeriu në këtë

botë është vetëm kalimtar dhe asgjë më shumë. Një gjë e tillë shprehet edhe në vetë tekstin, përkatësisht në pjesën e tretë:

*Botë moj botë e pabesë  
Nuk ke gjë të vërtetë  
Njeriu po të vdesë  
Dhe nuk vjen më në jetë.*

Kurse në vijimësi, në shtresën e tekstit, do të paraqiten trazimet shpirtërore të përjetimeve, ku jeta-vdekja e funksionalizojnë edhe më shumë gjendjen e trazuar shpirtërore. Edhe pse këtu kemi një përzjerje të përjetimeve, teksti rri tek statusi autorial, ndërsa vdekja-jeta bëhen porosi universale, duke mos qëndruar vetëm përbrenda konventës personale. I gjithë ky universalizim dëfton simbolikën e idesë. Por, dhembja-dëshpërimi mbetin prapë autoriale si:

*Kujto djalërinë një engjell një natë  
T'iku nëpër duar dhe të la me djalë.*

Andaj, kjo elegji përmban brenda vetes një dëshpërim dhe një vuajtje, që vijnë si shkas i njeriut të humbur, ku subjekti e përkujton-përjeton përmallshëm-pikëllueshëm. Një rëndësi të veçantë te ky tekst është muzikaliteti, që A. Z. Çajupi (1902) e ka shkruar me mjaft mjeshtëri në përmbledhjen poetike "Baba Tomori". ■



## Lajme nga kultura

**Mbahet tryeza shkencore "Letërsia jonë për fëmijë dhe kritika letrare"**

**K**arvani i shkrimtarëve për fëmijë "Agim Deva", në kuadër të aktiviteteve që është duke zhvilluar në mjedis të ndryshme të Kosovës, në edicionin e tij të X-të, ka mbajtur në Fakultetin e Filologjisë, në Prishtinë, tryezën shkencore: "Letërsia jonë për fëmijë dhe kritika letrare". Duke veçuar rëndësinë e shkrimeve kritike për letërsinë tonë për fëmijë, studiuesit pjesëmarrës në këtë tryezë, theksuan nevojën e vlerësimit dhe të sistemimit të kësaj letërsie në kuadër të vlerave të përgjithshme të letërsisë sonë. Udhëheqësi i Karvanit të shkrimtarëve për fëmijë "Agim Deva", poeti Xhevat Syla theksoi se letërsia jonë për fëmijë që nga Konstandin Kristoforidhi e deri më sot ka njohur emra të respektuar të letrave, andaj, sipas tij, ekzistojnë mjaft çështje që janë shumë provokative për këtë letërsi. Ndërkaq, studiuesi i letërsisë Flamur Maloku, theksoi se letërsia për fëmijë në Kosovë identifikohet me autorët e saj, në poezi e në kritikë, duke u identifikuar me autorë, ajo njihet edhe modelet e veçanta diskursive. Ndërsa në vazhden e tryezës janë paraqitur me kumtesa gjithashtu edhe poet si Ibrahim Kadriu, Gani Xhafolli, Arif Demolli, Faik Shkodra, Pandeli Koci e të tjerë.

**Mbi 100 botues në Panairin e librit "Prishtina 2009"**

**N**ë Pallatin e Rinisë është mbajtur Edicioni i XI-të i Panairit të librit "Prishtina 2009", në të cilin kanë marrë pjesë mbi 100 botues nga të gjitha trevat ku botohet dhe publikohet libri shqip. Po ashtu, në këtë edicion botimet e tyre i kanë ekspozuar edhe shtëpitë më prestigjioze të botës, si "MacMillan", "Ekspress Publishing", përmes përfaqësuesve të tyre. Në hapjen e panairit kanë marrë pjesë drejtuesit më të lartë të institucioneve të Kosovës, ku vetë presidenti i Republikës së Kosovës Fatmir Sejdiu, e shpalli të hapur panairin. Me këtë rast, ai theksoi se ky panair është një ngjarje e shënuar për librin dhe kulturën tonë në përgjithësi duke shtuar se ka marrë me kënaqësi ftesën nga kryesia e Shoqatës për të marrë pjesë në hapjen e panairit, duke pasur në kujtesë se shumë emra të njohur të kulturës sonë kanë kaluar në dyert e këtij panairi. "Po përmend vetëm dy emrat më të veçantë të kulturës sonë: Ibrahim Rugovën dhe Ismail Kadarenë që kanë pasur fatin të hapin këtë panair, ndërsa ne kemi fatin të jemi bashkëkohës të tyre" – ka thënë presidenti Sejdiu, duke përgëzuar botuesit dhe krijuesit për punën e bërë që libri shqip të jetë në duart e lexuesve, me tituj të rinj nga fusha të ndryshme të dijes. Kryetari i Shoqatës së Botuesve të Kosovës, Nazmi Rrahmani, ka thënë se ky panair, që tubon pjesën më të madhe të botuesve të librit shqip, është edhe një rast i mirë që libri të jetë më afër lexuesit. "Ky panair do të jetë rast i mirë edhe për shënimin e përvjetorëve të rëndësishme të autorëve të njohur, me botimin veprave të tyre dhe me aktivitete të tjera" – theksoi Rrahmani. Edicioni i sivjetmë i Panairit është mbështetur nga Ministria e Kulturës me një shumë prej 3.500 euro, shumë e cila do të shkojë për të paguar qiranë.

*Përgatiti: Esat Vatovci*

**Promovime librash****Libër më sistem të veçantë**

**M**ë 5 qershor 2009, në kuadër të Panairit të Librit që është mbajtur në Prishtinë, është promovuar libri poetik "Lule ajri" i autores tashmë të njohur Hasije Selishta-Kryeziut. Në promovim, për vlerat e librit poetik ka folur kritikë dhe studiuesi i letërsisë Flamur Maloku, i cili ka thënë se poezia e këtij libri formulohet duke krijuar një sistem të veçantë ligjërimi. Sipas tij, struktura e tekstit analizohet nëpërmjet esencave diskursive shënues të cilat reflektohen në këtë poezi. Variantet e shumta personale shtresojnë tema të cilat në poezinë e Hasije Selishtës-Kryeziut artikulojnë nga një gjendje shpirtërore me përplot emocione – është shprehur Maloku. Për poezinë e Hasije Selishtës-Kryeziut ka folur, gjithashtu, edhe poeti Raif Gashi, i cili ka theksuar se një lexues i vëmendshëm, duke lexuar poezinë e kësaj autoreje, do të hasë një stil krejt të veçantë dhe original. Poezia e Hasije Selishtës-Kryeziut, ka vlerën e vërtetë të afirmimit dhe të ruajtjes së identitetit – është



shprehur Gashi. Në fund të promovimit, të pranishmit i ka përshëndetur autorja Selishta, e cila i falënderoi të gjithë ata që kanë kontribuar në daljen në dritë të këtij libri

**Libri "Sëmundja misterioze" i historianit suedez Joran Vasenius**

**M**ë 6 qershor, në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, është bërë promovimi i librit "Sëmundja misterioze", i historianit suedez, Joran Vasenius. Libri "Sëmundja misterioze", sjell fakte të argumentuara për historinë e dhimbshme të vitit 1990, kur në mënyrë misterioze u helmuan 7500 nxënës shqiptarë, në shkolla të ndryshme të Kosovës. Përmes këtij libri, historiani Vasenius sjell fakte të shumta dhe dëshmi të atyre që e përjetuan këtë drejtpërsëdrejti, si dhe deklarata të institucioneve prestigjioze që u morën me zbardhjen e këtij misteri. Të dhënat në librin e tij, Vasenius i mbështet edhe në dokumentet e OKB-së, të cilat i mori në Gjenevë lidhur me zbardhjen e kësaj historie. Duke përshëndetur të pranishmit, historiani Vasenius ka thënë se Kosova duhet të vazhdojë të mbledhë dëshmi rreth kësaj ngjarjeje e cila nuk duhet harruar.

*Përgatiti: Jeton Isufi*

## Opinion

# Panairi, sfida dhe sukcesi



Fitim VELIU

Sivjet, panairi i librit "Prishtina 2009" është konsideruar si më i suksesshmi nga të gjitha panairët e viteve të kaluara, përkundër disa sfidave që po e përcjellin këtë panair gjatë çdo viti si: mungesa e hapësirës për të ekspozuar librat e tyre në raport me kërkesat e blerësve, pastërtia jo në nivelin e duhur etj. Edhe sivjet, shumë shtëpi botuese nga vendi dhe rajoni kishin mësyre në Prishtinë në Panairin e Librit që të ekspozonin librat e rinj para lexuesve kosovarë, mërgimtarë, atyre të rajonit e më gjerë. Botuesit janë shprehur se ishin përpjekur të harmonizonin interesat e tyre dhe të lexuesve që çmimet e librave të ishin më të volitshme. Por dashamirët e librit janë shprehur se çmimet nuk kanë qenë edhe aq të arsyeshme, duke pasur parasysh gjendjen ekonomike në vend. Por, kësaj radhe panairi kishte disa risi të cilat nuk i kishte vitin e kaluar. Sivjet para lexuesve u ekspozuan shumë tituj të rinj të zhanreve dhe tematikave të ndryshme, të cilat i kishin sjellë shtëpitë botuese të rajonit. Brenda panairit ishte një atmosferë plot njerëz, të cilët i mbushnin qeset e tyre me libra dhe tituj të rinj dhe për librat që iu pëlqenin nuk pyetnin shumë për çmimin. Lexuesit ishin të kategorive të ndryshme, por dallonte sidomos interesi i të rinjve, i nxënësve, studentëve, të cilët ishin vërsulur mbi libra për të siguruar secili titullin e librit të dëshiruar. Një nga shtëpitë botuese të rajonit, Logos-A, nga Shkupi edhe sivjet, sikurse edhe gjatë viteve të kaluara, kishte sjellë risi në disa nga titujt mjaft atraktivë dhe të kërkuar për lexuesit e të gjitha kategorive. Titujt ishin të zhanreve të ndryshme si: letërsi për fëmijë, lektura shkollore, etj. Ndër lekturat më të shitura të kësaj shtëpie botuese janë: "Picimuli dhe Pinokio", kurse libri më i kërkuar për të rinjtë ishte: "Kokë më kokë me të rinjtë", një libër i trajtuar nga aspekti i psikologjisë së suksesit. Në të përfshihen disa faktorë që e pengojnë formimin e të riut nga aspekti moral e

Sivjet, para lexuesve, u ekspozuan shumë tituj të rinj të zhanreve dhe tematikave të ndryshme, të cilat i kishin sjellë shtëpitë botuese të rajonit

intelektual, si: identifikimi i shokut të keq, stresi, mospasuria, vetetë lindura dhe ato të trashëguara, pra, ky libër është një ofertë e shkëlqyer për tejkalimin e tyre. Libri më i shitur i zhanrit teologjik dhe, po ashtu, më i kërkuari ishte: "Fuqia e besimit përsosmëri e shpirtit". Përfaqësuesi i shtëpisë botuese Logos-A, nga Shkupi, Nuredin Ahmeti, theksoi se: "Në këtë panair, ne, si shtëpi botuese, jemi mjaft të kënaqur, për faktin se shumë nga titujt të cilët i kemi sjellë këtu nuk kanë mbetur më asnjë, gjë që na shtyn të mendojmë menjëherë për ribotimin e tyre brenda një kohe mjaft të shkurtër". Ne, po ashtu, deshëm të dimë për lexuesit tanë se cilët nga titujt ishin më të kërkuar. Përfaqësuesi i Logosit-A u shpreh: "Për sa u përket librave më të shitur dhe më të kërkuar, do t'i kisha ndarë sipas zhanrit dhe tematikës".

## Librat më të kërkuar

Libri më i kërkuar në fushën e studimeve të kulturave dhe civilizimeve ka qenë Libri i Hantingtonit "Përleshja e Civilizimeve" dhe libri i studiuesit dhe publicistit Dr. Milazim Krasniqit "Dhuna dhe qytetërimi perëndimor", (Islami si fillim i historisë). Libri Dhuna dhe qytetërimi perëndimor është i strukturuar përbrenda në disa kapituj të cilët flasin për ofertën e Islamit si projekt global për tërë njerëzimin, pra, bashkimin e dy civilizimeve nën pranimin e Islamit si fe qiellore për tërë njerëzimin, duke mos i mohuar



të arriturat e Perëndimit në aspektin e shkencës dhe teknologjisë. Pra, studiuesi argumenton faktin se kjo mund të arrihet nëse bota është e gatshme ta pranojë ofertën e Islamit si sistem universal dhe kjo mund të arrihet duke identifikuar gabimet historike, deformimet morale e shpirtërore dhe duke u distancuar nga to. Ky libër, po ashtu, hedh dritë mbi artin e antikitetit si prodhim dhe gjenerator i dhunës. Këtu kërkohet një rrjet kuptimi dhe komunikimi i artit nga antikiteti e deri në kohën moderne, për të prodhuar edhe deformimet historike përmes figurave religjioze si p sh. Jezusin (Isën a. s.). Një kapitull tjetër, mjaft teorizues e argumentues nga studiuesi Milazim Krasniqi, është demantimi i fakteve të Shoqatës së Psikologëve Gjermanë, të cilët dhunën e shohin si pjesë të brendshme të qytetërimit të orientuar drejt suksesit, gjithmonë duke ju referuar gabimit, mëkatit të trashëguar. Deargumentimi i këtij fakti nga studiuesi Milazim Krasniqi është fakti se dhuna buron nga jashtë individit, sepse Zoti e ka lënë njeriun të lirë në veprimet e tij, duke i treguar se cila është rruga e suksesit dhe e shpëtimit. Andaj veprimi i tij bart edhe pasojat, qofshin ato pozitive apo negative. Nga ky studiues ka qenë i kërkuar edhe libri "Fijet e shpirtit", një metaforë e dy popujve të ndarë padrejtësisht, kurse libri "E vërteta e Islamit ndër shqiptarë", kësaj radhe mungonte për shkak se ky libër ishte shitur më herët dhe shpresojmë se ribotimi i tij do të ndodhë në një të ardhme shumë të afërt. Suksesi i parë i këtij panairi është ngritja e vetëdijes se leximi është domosdoshmëri jetësore, andaj ngritja e leximit është e evidente. Suksesi i dytë është nxjerra e titujve të rinj nën prizmin bashkëkohor dhe për problemet bashkëkohore. Dhe si suksesi i tretë konsiderohet fakti se lexuesi nuk blen më libra dogmatikë dhe të padobishëm, libra fallsifikativ, por tani blerësi – lexuesi pyet për brendinë e tij, pa dashur ta shohë jashtësinë e tij. Leximi është ushqim shpirtëror dhe kësaj radhe ky ushqim u konsumua me efikasitet në Panairin e suksesit dhe të traditës. ■

## Recension

**Profesori në hije i gjeneratës së dytë të gazetarisë**

“Libri i Gjeneratës” - monografi për gjeneratën e dytë të Degës së Gazetarisë së UP-së, botoi Universiteti i Prishtinës, 2009



Arben ATASHI

**K**arakteristikë e “Librit të Gjeneratës”, të autorit Demir Reshiti, është në mënyrë të veçantë gërshetimi i elementeve të zhanrit të monografisë me elemente artistike.

Ndonëse sjell informacionet themelore për Degën e Gazetarisë, si numrin e studentëve, të mësimdhënësve, aktivitetet etj., duke e plotësuar kësisoj anën monografike, “Libri i Gjeneratës” i tejkalon kornizat e një monografie të thjeshtë ose një albumi për ndonjë nga gjeneratat e shumta të cilat kanë kaluar nëpër Universitetin e Prishtinës. Kjo është edhe poenta e këtij libri. Elementet që e plotësojnë anën artistike të librit janë pikërisht përshkrimet që autori ua bën kolegëve të tij të gjeneratës, duke u dhënë epitete të ndryshme, jo rrallë edhe me një dozë humori.

Duke qenë më i moshuari i gjeneratës, e besa edhe se një pjesë e profesorëve të tij, Demiri filloi të shihej nga studentët e tjerë si një “profesor në hije”.

Epitetet që ai u jep kolegëve janë të shumta dhe të ndryshme, si për shembull: profesori i ardhshëm, ambasadori i ardhshëm, ylli i Bregasit, dështaku, alternativisti, cigaromani, asistentja, sugari i gjeneratës etj.

Një vend të rëndësishëm zënë edhe karakterizimet që iu bën studentëve, si: studentja e martuar me profesor, presidentja e parë e gjeneratës, sekretarja personale e Barak Obamës, valltarja simpatike e grupit, kryetarja e ardhshme e shtetit etj.

Ndër përshkrimet që hasen janë edhe ato rreth hobeve që kanë studentët, siç janë: syshkruara që e ka hobi qeshjen, goca që urren thashethemet, balerina vetullshpuar që e ka çmendur Armagedonin, dembelja e dashuruar me Adeline Ismailin, etj.

Një pjesë tjetër e përshkrimeve kanë të bëjnë me punën, dëshirat dhe ëndrrat e studentëve, si p.sh dikush: e kalon kohën e lirë duke shikuar TV, ëndërron të jetë menaxher futbollit, dëshiron të udhëtojë në vende të bukura, ëndërron një udhëtim në planetin mars, ëndërron t’i lindin 2 djem binjakë, ëndërron të bëhet pilot i aeroplanëve ushtarakë, urren armiqtë e Shqipërisë natyrale, urren strukturat paralele, urren ndërtimet ilegale etj.

Në monografinë e Demir Reshiti ka edhe studentë të atillë që janë të lindur “n’hava”, por me vendbanim në autobus.

**Tri sfidat...**

“Libri i Gjeneratës” para së gjithash mund të lexohet edhe si një sfidë e trefishtë.

**Sfida e parë** i atribuohet vetë autorit, i cili me përcaktimin për shkrimin e një monografie për gjeneratën, ka rrezikuar të bjerë në deskriptivizëm të nivelit elementar. Mirëpo, konsideroj se ai e ka tejkaluar me sukses këtë sfidë.

**Sfida e dytë** iu atribuohet studentëve, të cilëve në pak rreshta iu është kërkuar të përshkruajnë vetveten. E, siç dihet, pikërisht përshkrimi i vetvetes paraqet një ndër rreziqet e mëdha të rënies

në deklarativizëm. Por, me talentin e tyre për humor dhe me përpunimin e përshkrimeve nga autori i librit, edhe studentët konsideroj se kanë arritur ta tejkalojnë sfidën e tyre.

**Sfida e tretë** ndërkaq iu atribuohet mësimdhënësve të gjeneratës, për të cilët kam dyshime nëse e kanë tejkaluar apo jo sfidën që iu është bërë. Kërkesa për të bërë një vlerësim për gjeneratën të nxjerr në udhëkryq. Natyra e kërkesës, sipas një rregulli të pashkruar, është e atillë që kërkon vlerësim pozitiv. Mirëpo, sipas një rregulli tjetër, po ashtu të pashkruar, e vërteta duhet thënë troç, pavarësisht vendit a kohës, apo kërkesës. Në rastin e dhënies së mendimit për gjeneratën e dytë të gazetarisë, shumica e mësimdhënësve kanë dhënë vlerësime pozitive, edhe pse privatisht mund të mos mendojnë kështu, ndërsa hetohen edhe tendencat për t’iu shmangur objektit konkret.

Vlerësimet janë të llojllojshme, shpesh hasen madje vlerësime në superlativ. Ka të atillë që konsiderojnë se “kjo gjeneratë do të sjellë një imazh post-modern në mediet shqiptare”, apo se “do të jetë kulturë dhe model për gjeneratat që do të vijnë pas”. Disa e konsiderojnë “privilegj për çdo mësimdhënës që të





punojë me këta studentë”, ndërsa disa pohojnë se “do t’iu mbeten në kujtesë si një brez i përkushtuar në studime”. Një tjetër mendon se “nga kjo gjeneratë do të dalin emra të njohur të gazetarisë shqiptare”.

Disa të tjerë përpiqen t’i shmangen vlerësimeve të drejtpërdrejta për gjeneratën, duke bërë vlerësime të përgjithësuar, si “gjeneratë me ambicie të mëdha”, apo “gjeneratë me afinitet më të theksuar në identifikimin e problemeve” etj. Madje, ka edhe të atillë që nuk flasin fare për gjeneratën, duke bërë vlerësime të tilla si “çdo brez e ka shenjën e vet të edukimit”.

Krahas këtyre ka edhe vlerësime që mund të lexohen si negative, ndonëse autorët e tyre kanë bërë përpjekje që vërtet të thonë diçka për këtë gjeneratë, duke qenë të drejtpërdrejtë dhe të sqarë. Përsëritja në këtë kontekst e fjalës së urtë, se “një kirurg i keq e mbyl një njeri, ndërsa një gazetar i keq e helmon një komb”, ndonëse në lexim të parë mund të zgjojë asociacione negative, në esencë ajo ka qëllim pozitiv, dhe si e tillë duhet edhe të lexohet, si një thirrje për vetëdijesim rreth peshës që ka fjala e shkruar.

Po ashtu, edhe vlerësimi se “kjo gjeneratë paraqet një paradoks të llojit të veçantë”, ka këtë qëllim dhe mund të lexohet si një thirrje për ta parë realitetin me sy ashtu si është, apo si një sfidë për t’i emërtuar gjërat me emrin e tyre të vërtetë, që është edhe njëri ndër standardet themelore të gazetarisë profesionale.

Kësisoj, monografia e Demir Reshiti për gjeneratën e dytë të gazetarisë, ia vlen të lexohet, qoftë për studentët, qoftë për mesimdhënësit, qoftë për vetë autorin, duke qenë njëherësh vlerë gazetareske, por edhe vepër arti. ■

Poezi

# Toka pa diagnozë

Rrahim M. SADIKU

FALI SYTË

Atëbotë jo të largët zemërime akorduat  
duke mbyllur sytë me vitet e ikura,  
e unë për pakëz pësova nga buzëqeshjet  
e shpirtit

e dot shpresat si fika.

Ju të molisur nga barra djallëzore  
e mosha e përtypur si plakat me një dhëmbë  
me çka t’ju bindi – kur as vetvetes si besoni  
se dy milion vargje i kam.

Nëpër gishtat tuaj qindra vargje hije s’mbetën  
harruat për vete se kush jeni e kënd e  
keni përpara  
dridhjet në zemër e vargjet u bënë gjethe  
bota e marrë lara-lara.

Mes jush një shpirt i madh mbet sall ofshamë  
lëshoj si ti çelën mijëra plagë  
prej nga u hodhët e muret, mëkate me valë  
së largu më keni lagë.

Shpërblime për të vdekur e hijet e tyre  
symbyllur u kollitët si krimba në fletë  
a shihni, a e njihni çështë e bukura në vargje  
o’ju të pashpirt e jetë.

ODISENË NË KRAHË KOHE

Fluturimthi më nisje tej frymëmarrjes  
zëri i çjerrë bulon si në ndonjë humnerë  
kafsho bishtin e gjarprit po deshe kalimthi  
e bardha s’të vjen shpesh në dorë

Çirresh para pasqyrës thuaje s’sheh  
me sytë e vetmisë duke përtypur faje  
fjalët nuk ruajnë peshë që ti gjithë i mbush  
a e dinë që s’ka vend – sonte për vaje

Akrepat e orës zënë si për hijet  
që dritë thyejnë në nofulla duke dridh  
merri po deshe me vete në vorbullën e fatit  
e mos humb kohë në pasqyrë

Me hirin e jetës ruhen në qivur  
ashti yt e vargu që pikon jetë nëpër hënë  
sërish këndellesh në shkëndija tretur oxhakut  
nuk je i pa këngë.

Odisenë në krahë kohe  
e ruajnë ata që nën çati krahë lëshojnë  
pika e shiut së lag fytyrën e mizës  
e memecët vetën e kafshojnë.

TOKA PA DIAGNOZË

Me fener do ecur në pikë të ditës  
bukuri të rreme të shoh e të dëgjoj  
buzëqeshjet më dalin si në ëndërr lemeri  
për këtë në heshtje vetës i tregoj.

Kam ecur mija km. si kam mundur  
po lisa mali të tillë e të sëmure kurrë s’kam parë  
në mjegulla kohe atëbotë hyra disi i vetmuar  
zog i strukur në kala.

Shoh çdo kohë se si rrjedhin lumenjtë e mëkateve  
net të tëra këtu duke ndenjur njerëzit pa gjumë  
Ç’djallëzi as Sodoma s’ju gjen fijet  
të nesërmen qepohen në punë.

Vasha e gra të reja mbarsën si mizat  
të dashurit e vet i kanë sallë si lule në kapelë  
Këtë sëmundje s’ka barë që ju shëron;  
në shpirt e ruajnë rrënjë thellë.

Po sëmundjen e tokës e kanë njerëzit sipër  
mëkate si fije bari cep, cep e kanë mbush  
botës nuk i duhen njerëz të tillë  
me bisht i bien vetës në gushë.

GJITHCKA ËSHTË  
KALLKAN NË VETE

Hyri në bregore të sheh çka ka  
mori në thua në gurin e shpuar  
dhembe e hiret veç me parë  
plagë mbi plagë e paluar.

Si të dilet nga kjo shkretinë e paanë  
shumë fosile e ca eshtra të verdhë  
kohë e gurit shumë vegla tej shpellë  
syri i verbët do pranverë.

Merr frymë thellë o shpirti i bardhë  
në gjuhë dheu-gjakun së terë  
buzë të zbehura e gojë pa dhëmbë  
zë e fjalë si në erë.

Sjell mendim e përherë kokërenda  
ëndërr e hershme për kallkan  
më thuj jetë...Foli në heshtje  
peshën e fatit kush e mban.

Lëshua një shtegu ku do të dilet  
në dilemë ky udhëtim i gjatë  
me rrobe të shqyera arnuar që moti  
mall për zjarr mall për flakë.

Po ky hi në fund të murit  
paska pasur ndonjë hije oxhaku  
shpresa tretet thonë e fundit  
shpirti zvarrë në pikë të gjakut.



Artan N. BEJTA

# Migrena

**S**humica e njerëzve, në periudha të caktuara të jetës së tyre, ankohen nga dhembja e kokës. Shkaqet e kësaj dhembjeje janë nga më të ndryshme. Ndër ta mund të përmendim faktorët e brendshëm që janë fiziologjikë dhe faktorët e jashtëm natyrorë që janë: të nxehtit, të ftohtit apo era.

Jo të gjitha dhembjet e kokës janë njësoj. Një sëmundje mjaft e shpeshtë që ka shenjë karakteristike dhembjen e kokës është edhe migrena.

## Çka është migrena?

Migrena është formë e veçantë dhe shumë e rëndë e dhembjes së kokës. Karakteristikë tek kjo sëmundje është se dhembja është e lokalizuar në njërën anë të kokës. Dhembja e kokës tek disa njerëz mund të paraqitet në periudha të caktuara të jetës, e te disa të tjerë gjatë tërë jetës. Mund të shfaqet në çdo moshë, por më së tepërmi paraqitet në mes moshave 10-40 vjeç dhe zvogëlohet pas moshës 50 vjeçare.

## Simptomat karakteristike të migrenës

Dhembja fillon në një zonë të caktuar të kokës dhe më pas përhapet duke u shtuar për disa orë dhe më pas gradualisht zvogëlohet, por ajo ndonjëherë mund të zgjatë edhe 24 orë, madje në disa raste mund të zgjasë edhe disa ditë. Po ashtu, mund të jetë e shoqëruar edhe me simptoma të tjerë si: bllokim hundësh, të vjella, ndjeshmëri ndaj dritës, zërave dhe ndaj aromave, këmbët dhe duart ndihen të djersitura e të ftohta.

## Shkaqet e migrenës

Shkaqet që çojnë në shfaqjen e migrenës ende nuk janë të njohura. Megjithatë, shkencëtarët mendojnë se shkaktohet nga probleme kimike dhe elektrike që ndodhin në disa pjesë të trurit.

Element shumë i rëndësishëm



në përcaktimin e migrenës është ndryshimi i rrjedhës së gjakut në tru. Ndryshimet në enët e gjakut karakterizohen me spazmë (ngushtim) të enëve të gjakut që furnizojnë trurin me gjak. Ngushtimi i këtyre arterieve shkakton zvogëlimin e rrjedhjes së gjakut si dhe furnizimin e dobët të trurit me oksigjen, mirëpo më vonë disa arterie të trurit zgjerohen për të përballur nevojat e trurit për energji dhe pikërisht ky zgjerim i arterieve shkakton dhimbjen e kokës.

që mendohet që provokojnë migrenën, si: alkooli (birra, vera e kuqe dhe pijet e forta alkoolike); qumështi, kosi dhe sidomos djathi i vjetër; ushqimet me monosodium glutamat që gjendet në ushqimet kineze, pikante apo në mishrat e përpunuar; kafeina (në kafe çaj, çokolatë); në ushqimet e konservuara (turshitë, konservat e peshkut); në agrumet (portokajtë, limonët); së fundi në ushqimet e shpejta (sandviç, hotdog), etj.

**Gjumi** - Është e rëndësishme që të respektohet një regjim ditor duke iu përmbajtur një orari për gjumë, nga se mungesa ose teprica e gjumit çon në shfaqjen e migrenës.

**Hormonet** - Rreth 75% e njerëzve që vuajnë nga migrena janë femra, në të cilat shfaqet migrena menstruale që zhduket gjatë shtatzënisë. Kjo nuk është e njëjtë në të gjitha pacientet, pasi ka gra, ku migrena zhvillohet gjatë shtatzënisë, kurse në disa të tjera pas menopauzës. Statistikat tregojnë se përdorimi i kontraceptivëve oralë çon në thellimin e simptomave të

Që në momentet e para të dhimbjes së kokës merrni një qetësues, si aspirinë apo paracetamol, edhe kur ju jeni të përgjumur, edhe kur do t'ju duhet të ngriheni nga gjumi në orët e para të mëngjesit.

## Faktorët që provokojnë shfaqjen e migrenës

**Dieta**- Gjatë ekzaminimit të migrenës, pa dyshim, një rol të rëndësishëm luan ushqimi, mirëpo nuk është e domosdoshme mbajtja e një diete të thellë por gjithsesi është më se e domosdoshme zvogëlimi i atyre ushqimeve

Nëse keni dhembje koke çdo ditë ajo nuk është migrenë!

Freskimi i kokës me ujë të ftohtë, si dhe vënia e herëpashershme e kompresave me ujë të ftohtë, e zvogëlojnë dhembjen e migrenës.

→ migrenës. Nga kjo shihet se hormonet luajnë një rol kyç, apo janë një ndër faktorët e shumtë që ndikon në paraqitjen e migrenës.

**Kuroni dhimbjet e dhëmbëve, dhimbjen e syve, sinozitin ose bllokimin e hundëve, pasi ato bëhen shkak për migrenë kronike.**

**Stresi dhe ankthi** - janë ndër faktorët që ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut. Si në çdo sëmundje tjetër, po ashtu, edhe te migrena janë dy faktorë që luajnë një rol negativ. Për këtë ju nevojitet që të gjeni pak kohë të lirë ku mund të relaksoheni, duke i harruar problemet e përditshmërisë.

**Faktorët rrethues** - Këtu përfshihen ndryshimet e motit dhe të temperaturës, drita ndriçuese dhe fluoreshente, ekranit i kompjuterit, aromat e forta, si dhe lartësitë.

### Llojet e migrenës

Ekzistojnë dy lloje (tipa) të migrenës: migrena e thjeshtë dhe ajo klasike.

**Migrena e thjeshtë:** Tek ky lloj futen rreth 75 % e të sëmurëve. Të vjellat janë më të pakta. Dhimbjet nuk shoqërohen me AURA (vegime vizuale para fillimit të dhimbjeve). Mund të shfaqet në një apo ndonjëherë në të dy anët e kokës.

**Migrena klasike:** Në këtë lloj ka aura (vegime vizuale para fillimit të dhimbjeve). Kohëzgjatja e atakut zgjat 2-6 orë. Shoqërohet me të vjella dhe ka defekt në shikim. Ka një boshllëk në fushën e shikimit. Karakteristikë është ngase ndodh në një anë të kokës.

Dhimbjet e migrenës mund të vijnë një herë në muaj apo në javë, apo mund të mos vijnë për një kohë të gjatë, por ajo që dihet

mire është që nëse ndodh çdo ditë ajo nuk është migrenë. Zakonisht personi kërkon një vend të qetë dhe pas atakut të migrenës e ndjen veten mjaft të lodhur.

### Mjekimi


Mjekimi i dhembjeve të kokës, që shkaktohen nga migrena, mund ta lehtësojë dhimbjen dhe simptomat e sulmit të migrenës dhe të parandalojë sulmet e ardhshme të migrenës. Trajtimi i migrenës mund të jetë parandalues ose mjekues.

Në ditët e sotme, përveç ilaçeve antimigrenë (Sandomigran, Avami-gran, Migristen, Cafergot, Ditamin, betablokuesit, antidepressivët, magneziumi, etj.) pacientit i duhet shpjeguar roli i tendosjeve fizike, psikike dhe emocionale gjatë sulmit të migrenës. ■

### Faktorët që ndikojnë në paraqitjen e Migrenës

- ◆ Stresi
- ◆ Ndryshimet hormonale (menstruacionet, shtatzania, ilaçet për pengimin e shtatzanisë)
- ◆ Lodhja
- ◆ Uria
- ◆ Djathi i vjetër, çokollata, alkoli, vera, pijet me kafeinë, kafeja etj.
- ◆ Pagjumësia apo gjumi i tepërt
- ◆ Ndryshimi i gjendjes emocionale
- ◆ Dhimbjet e tjera në trup

## Trimi i sukseseve dhe shpresave të mëdha



**T**rim Maloku ka lindur më 16 gusht 1999, në Prishtinë. Vijon mësimet në klasën e katërt në shkollën fillore "Faik Konica".

Trim Maloku në turneun "Shpresat e Kosovës 2009", të organizuar nga Federata e Karatesë se Kosovës (FKK), ka zënë vendin e tretë.

Trimi, përveç talentit të tij në karate, është nxënës i shkëlqyeshëm e po ashtu ka ambicie për të ardhmen. I vetëdijshëm se ardhmëria e mirë vjen nga shkollimi e dija, Trim, përveç librave shkollorë, lexon edhe libra të ndryshëm, e po ashtu shkruan edhe poezi. Ai për nga natyra është i qetë, inteligjent dhe i dashur me mësuesit, shokët dhe shoqet.

(M. Zejnullahu)



# Kosova rrezikon t'i humbë kualifikimet për Euro 2012

Vonesat për pranimin e Federatës së Futbollit të Kosovës në FIFA dhe UEFA mund t'i kushtojë Përfaqësueses së Kosovës në Futboll humbjen e kualifikimeve për Euro 2012, që zhvillohet në Poloni dhe Ukrainë.



Alban BILALLI

**N**ëse Federata e Futbollit të Kosovës, deri në janar të vitit 2010, nuk pranohet në FIFA dhe UEFA, ajo mund t'i humbë kualifikimet për Euro 2012, që mbahet

në Poloni dhe Ukrainë.

Kualifikimet për Euro 2012 nisin në vjeshtën e vitit 2010, por përfaqësueset pjesëmarrëse caktohen në janar të vitit të ardhshëm. Federata e Futbollit të Kosovës nuk është anëtare e Federatës Evropiane të Futbollit (UEFA) dhe nuk e ka të sigurt pranimin në këtë institucion deri në vitin 2010. Kusht për pjesëmarrje në kualifikime është të jesh anëtare e UEFA-s.

Federata e Futbollit të Kosovës po bën çështje e mundur që të pranohet në Federatat Ndërkombëtare të Futbollit FIFA dhe UEFA. Shumë shkresa me vull të FFK-s dhe të kryetarit të saj janë dërguar në adresë të këtyre dy shtëpive të futbollit që FFK-ja të pranohet në këto institucione. FIFA ka refuzuar aplikacionin e FFK-së me arsyetimin se aplikacioni nuk është në përputhje me artikullin e dhjetë të statutit të FIFA-s. Në këtë artikull thuhet se në FIFA mund të pranohen vetëm federatat e shteteve që janë të pranuar nga komuniteti ndërkombëtar. Për praninë në OKB, Kosovën duhet ta njohin dy të tretat e shteteve anëtare të OKB -s, 124 shtete, kurse OKB-ja ka 190 shtete.

## Pasojat

Mospranimi i FFK-së në FIFA dhe

UEFA, Kosovës i pamundëson pjesëmarrjen në kualifikimet për Euro 2012. Për më tepër FIFA, gjatë verës, FFK-së ia ka ndaluar edhe zhvillimin e ndeshjeve miqësore ndërkombëtare. Ky vendim është ende në fuqi edhe pse FFK-ja ka bërë kërkesë për mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të FIFA-s, që u mbajt në Tokio të Japonisë më 19-20 dhjetor 2008. FFK-ja dërgoi një shkresë ku i kërkoi KE të FIFA-s që Kosovës t'i lejohet së paku të zhvillojë ndeshje miqësore. Siç dihet, muaj më parë, FIFA ia ndaloi Përfaqësueses së Kosovës në Futboll të zhvillojë takime miqësore me Brazilin dhe Beninin. Komiteti Ekzekutiv i FIFA-s, kërkesën e FFK-s ia la për detyrë UEFA-s, që më 30 janar 2009 ta shqyrtojë kërkesën e FFK-s. Më 30 janar, në mbledhjen e mbajtur, UEFA nuk vendosi asgjë për Kosovën, duke e mbajtur kështu peng sportin më të dashur tek ne.

Përveç rrezikut për të humbur kualifikimet për Euro 2012, shtyrja e pranimit ndërkombëtar po lë pasoja në futbollin e Kosovës. Klubet po humbin shumë për mospjesëmarrjen në gara ndërkombëtare. Kjo po ndikon që edhe transferimet e lojtarëve të jenë të pakta dhe që klubet të mos përfitojnë nga ato pak transferime. Edhe lojtarët janë duke humbur shumë, vlera e tyre në treg do të ishte shumë më e madhe në rast se ata do të luanin për Përfaqësuesen e Kosovës.

















Ikja e talenteve është një pasojë tjetër. Shumë futbollistë që kanë gjak shqiptari po pranojnë të luajnë për përfaqësuese të tjera në pamundësi që të luajnë me Përfaqësuesen e Kosovës. Izolimi i futbollit po i detyron shumë futbollistë të luajnë për përfaqësuese të tjera, kështu Kosova po humb shumë futbollistë cilësorë që në të ardhmen do

të bartnin barrën kryesore. Rregulloret e FIFA-s thonë se një futbollist mund të ndërrojë përfaqësuesen vetëm deri në moshën 21 vjeçare, nëse paraprakisht ka luajtur për Përfaqësuesen A të një vendi tjetër. Ndërrimi i përfaqësueses mund të bëhet edhe pas moshës 21 vjeçare nëse futbollisti nuk ka paraqitur në Përfaqësuesen A. Njazi Kuçi dhe Fatos Beqiraj ishin futbollistët e parë që luajtën për një përfaqësuese tjetër, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kuçi luajti për Finlandën kundër Gjermanisë, kurse Beqiraj luajti për Malin e Zi kundër Italisë.

Ahmed Jonuzi e Samir Ujkani janë duke pritur rastin që të luajnë për përfaqësuesen e Shqipërisë. Përparim Hetemaj pret të luaj për Finlandën, Ardian Nikçi pret ftesë për të luajtur nga Përfaqësuesja e Zvicrës.

Për Përfaqësuesen A të vendeve të tjera kanë luajtur edhe: Arian Beqaj, Lorik Cana, Armend Dallku, Debatik Curri, Besart Berisha, Bekim Kastrati, Blerim Rrustemi e Mehmet Dragusha për Shqipërinë, pastaj Valon Behrami për Zvicrën, Shefki e Njazi Kuçi për Finlandën, Ardian Gashi për Norvegjinë etj. ■



Autor: Gazmend Morina - <b>BENI</b>	EPITET PËR AUTO-RRUGËN DURRËS - KUKËS (FOTO)	SHUMË E MADHE, QË ËSHTË PËRTEJ MASE	VARGU NGJITËS OSE ZBRITËS I TETË NOTAVE	RRËTH I VOGËL PËR ARI QË VBIET NË GISHT	SHKRONJA XVII dhe XIII	PËRËMËR PRONOR	AKTORJA AMËRIKANE STRIP								
TE VËNËT NË RREGULL															
E NJËZËSHME															
PJESA E JASHTME E RROTËS SË NJË AUTO- MOBILI					ISMET RAMUZI EMËR YNI MASHKULLI										
						ZANORE SËMUNDJE E TOKËS, EPILEPSI									
SMIRA, REZA EDI MARFI			STREHM POLITIK KRUPË E ACIDIT NITRIK					METAL I HOLLË	STUDIM ME KARAKTER KRITIK OSE PUBLICISTIK (shq.)	PASTROVA (bleed.)	E FILLUAR	FOREIGN TRADE ZONES	ZANORE	KËNGËTARJA ISTREFI	QËNDRUESH- MËRI (arab.)
AKTORJA HOLLVUDIAN AFLEK				ENI LENOKS NATRIUM, YON			MJET KOMUNIKIMI (shq.) AKTORJA AMËRIKANE ZELLUEGER								
ZANORE		ZBAVITËS, TERHEGËS GJELBËRIM NË NATYRË (sh.shq.)											OMANI, TUNZIA KRYEQYTETI I KANADASE		
NJË LLOJ ROSE E MADHE (shq.)					APARAT I POSAÇËM ME SHKRIAN (shq.) BUKUROSHIA VUTHAJ										
LETRA						BASHKËT- INGËLLORE RESHAT ARBANA		JOD, AMPER, SULFUR NGJYRA E LËKURËS SË FYTYRËS					SHKOP I BILARDO'S FUTBOLLISTI LIONEL (Barcelona)		
LEJA PËR TE SHKUAR NGA ODA (krah.)				KËNGËTARJA SHOPI-TARE HETA AKTORJA CAHANI						AKTORJA ME FAME BOTËRORE TURMAN VLEERA, DOBIA (shq.)				ZANORE KRYEQYTETI I TURQISË	
SHTAGA							ZANORE TRANSMETIM (sh.shq.)		SHTRAT PËR TE FJETUR, TEPELENA						
IGLI TARE			NOTË MIZIKORE THEMELI			INSTITUCION (shq.) INDRUM					SANTANA (shq.) DRU, LULET E TË CILIT PËRDORËN PËR ÇAJ				KOPJIMI
TROPOJA		BINDJA FUTBOLLISTI DANIELE (Milan)							SIPËR SHKRONJA XVIII				KUDRET ISAI KRYEQYTETI I FILIPINEVE		
	BIMË E VENDEVE TE NXEHTA GJYQATAR LOJE							AKTORI I SHKUAR GIBSON ZGJOJ/ (bleed.)				"A" në mes si dy "M" GATESE E JONA (sh.shq.)			
AKTORJA SHOPI-TARE ANAGNOSTI					ADRIAN KRASHNIQI	TEFIK DERIMI FAMË, ZULMË			VEÇORJA THELËSË-ORE E NJË SENDI NËNDOARJE E NJË LIGJI (shq.)						
PJATA				JONI ME NGARKESË NEGATIVE MUJET PËR TE RËRSHOITUR MBI BORE							MËRI, ZILJ ALBIN KURTI				
SHENJA KIMIKE PËR ELEMENTIN HEKUR			VARFËRI AGIM SOFI							BABAI INVA MULA				ZANORE INDIA, NAIROBI	
ZOG I EGËR GRABITQAR					BASHKË, TOKE MITROVICA			LYERJE ME NIKEL SHKRONJA XXIV							
HUMORISTI THAQI							GUXIMTAR							NË KËTË MOMENT	